



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme/ Ministarstvo Unutrašnjih Poslova/Ministry of Internal Affairs



REPUBLIKA E KOSOVËS
PROFILI I ZGJERUAR I MIGRIMIT
2018 - 2022

AUTORITETI QEVERTAR PËR MIGRIM

Prishtinë
Dhjetor 2023

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara dhe i takojnë Autoritetit Qeveritar për Migrim - Qeveria e Republikës së Kosovës. Riprodhimi nuk është i lejuar pa autorizim. Në rast të përdorimit të të dhënave nga ky dokument, duhet cituar burimin.

Kontakti:

Autoriteti Qeveritar për Migrim
Qeveria e Republikës së Kosovës
Ministria e Punëve të Brendshme
Tel: + 383 (0) 38 200 76 701 - 76 709
www.mpb.rks-gov.net
Adresa: Rruga "Luan Haradinaj" 14
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

PËRMBAJTJA

LISTA E TABELAVE	6
LISTA E FIGURAVE.....	8
SHKURTESAT	10
PARATHËNIE	12
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	14
STRUKTURA E AQM-SË.....	15
INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR SHTETIN	18
POPULLSIA, MADHËSIA, VENDET FQINJE DHE GJATËSIA E KUFIJVE	18
IMIGRIMI I RREGULLT	20
IMIGRIMI I PARRREGULLT	20
TRAFIKIMI ME QENIE NJERËZORE	21
AZILI DHE PËRCAKTIMI I STATUSIT TË MBROJTJES NDËRKOMBËTARE	21
EMIGRIMI I RREGULLT	21
EMIGRIMI I PARRREGULLT	22
AZILKËRKUESIT KOSOVARË NË SHTETET E BE-SË DHE ZONËS SCHENGEN.....	22
RIPRANIMI DHE RIINTEGRIMI	23
MIGRIMI DHE ZHVILLIMI.....	23
MIGRIMI I BRENDSHËM	23
PERSONAT E ZHVENDOSUR BRENDA VENDIT DHE JASHTË VENDIT (PZHB JV).....	24
A.1. IMIGRIMI	24
A.1.1. IMIGRIMI I RREGULLT	24
A.1.2. POLITIKA / REGJIMI I VIZAVE.....	24
A.1.3. TË HUAJT ME QËNDRIM TË RREGULLT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS.....	26
LEJEQËNDRIMET E PËRKOESHME	27
LEJEQËNDRIMET E PËRHERSHME.....	29
LEJE PUNE AFATSHKURTA.....	30
SHËRBIKIMET E MIGRIMIT PËR ÇËSHTJE TË PUNËSIMIT	30
A.1.4. <i>Fitimi i shtetësisë së Republikës së Kosovës.....</i>	<i>32</i>
MIGRIMI I BRENDSHËM (LËVIZJA E QYTETARËVE BRENDA TERRITORIT).....	34
A.1.5. <i>Imigrimi i parregullt</i>	<i>38</i>
A.1.6. <i>Mbrojtja ndërkombëtare</i>	<i>47</i>
A.2. EMIGRIMI	50
A.2.1. KËRKESAT PËR VIZË NGA SHTETASIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS	50
A.2.2. LEJEQËNDRIMET E LËSHUARA PËR SHTETASIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS	52
A.2.3. LIRIMI I SHTETËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS.....	54
A.2.4. EMIGRIMI I PARRREGULLT	55
<i>Shtetasit kosovarë të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufi ose të zënë në kufi në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen.....</i>	<i>56</i>
<i>Shtetas kosovarë të cilët janë zënë me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen.....</i>	<i>58</i>

<i>Shtetasit kosovarë të urdhëruar të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen</i>	<i>61</i>
<i>Shtetasit e Republikës së Kosovës të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen në bazë të urdhrit për largim</i>	<i>62</i>
A.2.5. AZILKËRKUESIT KOSOVARË NË SHTETET E BE-SË DHE ZONËS SCHENGEN	63
KËRKESAT PËR AZIL NË MBRETERINË E BASHKUAR	67
A.3. RIPRANIMI DHE RIINTEGRIMI I PERSONAVE TË RIPRANUAR	69
<i>A.3.1 Ripranimi me forcë dhe vullnetarë</i>	<i>69</i>
<i>A.3.2 Riintegrimi i personave të riatdhesuar</i>	<i>71</i>
<i>A.3.3 Integrimi i të huajve</i>	<i>73</i>
<i>A.3.4 Personat e zhvendosur brenda vendit dhe jashtë vendit (PZHBJV)</i>	<i>74</i>
B.1. NDIKIMI I MIGRIMIT NË ASPEKTIN DEMOGRAFIK.....	78
<i>B.1.1. TREGUESIT BAZIK DEMOGRAFIK</i>	<i>78</i>
<i>B.1.2. RRJEDHAT DHE STOQET E MIGRIMIT</i>	<i>78</i>
<i> Imigrimi</i>	<i>78</i>
<i> Emigrimi</i>	<i>79</i>
<i> Migrimi neto</i>	<i>79</i>
B.1.2. STOQET E MIGRIMIT.....	80
<i> Stoqet e imigrimit.....</i>	<i>80</i>
<i> Stoqet e emigrimit</i>	<i>80</i>
<i> Stoku i imigrimit neto</i>	<i>81</i>
B.2. NDIKIMI I MIGRIMIT NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË VENDIT.....	81
B.2.1. SISTEMI FINANCIAR	83
<i> Klima e investimeve (politikat fiskale dhe monetare)</i>	<i>83</i>
<i> Skenari makroekonomik afatmesëm.....</i>	<i>83</i>
B.2.2. TREGTIA	84
<i> Importi i mallrave dhe shërbimeve</i>	<i>85</i>
<i> Eksporti i mallrave dhe shërbimeve</i>	<i>85</i>
B.2.3. INVESTIMET E HUAJA DIREKTE.....	85
B.2.4. DËRGESAT E EMIGRANTËVE – REMITENCAT	86
<i> Remitencat sipas kanaleve, shtetet nga vijnë remitencat</i>	<i>86</i>
<i> Shërbimet e udhëtimit të vizitorëve – Turizmi i Diasporës.....</i>	<i>87</i>
B.3. NDIKIMI I MIGRIMIT NË ARSIM DHE ZHVILLIMIN E KAPITALIT NJERËZOR.....	88
B.4. NDIKIMI I MIGRIMIT NË PUNËSIM DHE TREGUN E PUNËS	89
B.5. NDIKIMI I MIGRIMIT NË NGRITJEN E MIRËQENIES SOCIALE	91
B.6. NDIKIMI I MIGRIMIT NË SISTEMIN SHËNDETËSOR.....	92
<i> TRENDI EMIGRIMIT TË PERSONELIT MJEKËSOR</i>	<i>94</i>
<i> NUMRI I SHËRBIMEVE MJEKËSORE TË OFRUAR PËR SHTETASIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS JASHTË VENDIT</i>	<i>95</i>
B.7. NDIKIMI I MIGRIMIT NË FUSHËN E MJEDISIT	95
C.1. KORNIZA E POLITIKAVE.....	97
C.2. KORNIZA LEGJISLATIVE DHE RREGULLATIVE.....	100
C.3. KORNIZA INSTITUCIONALE.....	108
C.4. BASHKËPUNIMI RAJONAL DHE NDËRKOMBËTAR	111
<i> C.4.1. MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE BILATERALE DHE MULTILATERALE</i>	<i>111</i>

C.4.2. INICIATIVAT RAJONALE DHE NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E MIGRIMIT.....	114
C.4.3. PROGRAMET/PROJEKTET NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E MIGRIMIT.....	115
D.1. TË GJETURAT KRYESORE LIDHUR ME TRENDET AKTUALE TË MIGRIMIT, POLITIKAVE TË MIGRIMIT, SI DHE NDIKIMIT TË MIGRIMIT.....	116
D.2. REKOMANDIMET LIDHUR ME KORNIZËN E QEVERISJES SË MIGRIMIT.....	117
D.3. REKOMANDIMET LIDHUR MË NDËRLIDHJEN E MIGRIMIT ME DOKUMENTET STRATEGJIKE ZHVILLIMORE (P.SH., STRATEGJIA KOMBËTARE ZHVILLIMORE).....	117
D.4. REKOMANDIMET LIDHUR ME PËRMIRËSIMIN E STATISTIKAVE NË FUSHËN E MIGRIMIT, SI DHE POLITIKËBËRJEN BAZUAR NË TË DHËNA.....	119
REKOMANDIMET STRATEGJIKE	120
IMIGRIMI.....	122
IMIGRIMI PARREGULLT.....	124
MBROJTJA NDËRKOMBËTARE	125
EMIGRIMI	127
EMIGRIMI I PARREGULLT	129
RIPRANIMI DHE RIINTEGRIMI I PERSONAVE TË RIPRANUAR.....	133
ANEKSI B - EMIGRIMI I SHTETASVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË SHBA, 2008 - 2021.....	134
SHKURTESAT	135
PËRMBAJTJA	136
EMIGRIMI I RREGULLT I SHTETASVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË SHBA, 2008 - 2020 ...	139
LEJEQËNDRIMI I PËRHERSHËM I LËSHUAR PËR SHTETASIT KOSOVARË NË SHBA.....	143
NATYRALIZIMI I SHTETASVE KOSOVARË NË SHBA	152
EMIGRIMI I PARREGULLT I SHTETASVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË SHBA, 2009 - 2021.....	156
AZILKËRKUESIT KOSOVARË NË SHBA, 2009 -2021	159
REFERENCAT E ANEKSTIT A	162
REFERENCAT E ANEKSTIT B.....	162

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Numri i vizave të aprovuara dhe të refuzuara sipas llojit të vizave.....	25
Tabela 2: Numri i personave që kanë lëvizur brenda komunës, Urban-Rural,Rural-Urban, Rural-Rural, 2018 - 2022	37
Tabela 3: Numri i refuzim-hyrjeve në Pikë Kalimet Kufitare, 2018-2022	38
Tabela 4: Numri i rasteve të iniciuara të kontrabandës me migrantë, 2018-2022	44
Tabela 5: Numri i të dyshuarit për kontrabandë me migrantë sipas shteteve, 2018-2022.....	45
Tabela 6: Numri i viktimave të evidentuara të kontrabandimit me migrantë sipas shtetësisë 2022	46
Tabela 7: Numri i viktimave të trafikimit sipas shtetësisë, 2018-2022.....	46
Tabela 8: Numri i vendimeve sipas statusit 2018-2022.....	48
Tabela 9: Shpërndarja sipas moshës dhe gjinisë të shtetasve kosovarë të cilët janë gjetur me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, 2018 – 2022	60
Tabela 10: Numri i të kthyerve vullnetarë brenda dhe jashtë vendit,2018 - 2022.....	75
Tabela 11: Numri i objekteve të ndërtuara/renovuara nga MKK-ja dhe Akterët e Jashtëm, 2018 – 2022	76
Tabela 12: Numri i Qendrave Kolektive në Kosovë.....	76
Tabela 13: Rrjedhat e migrimit: imigrimi, emigrimi dhe migrimi neto për vitet 2018-2022	80
Tabela 14: Stoqet e imigrimit dhe rrjedhat e imigrimit të shprehura në numra absolut dhe relativ, 2018-2022.....	80
Tabela 15: Stoqet e emigrimit dhe rrjedha e emigrimit të shprehura në numra absolut dhe relativ, 2018-2022.....	80
Tabela 16: Stoqet e migrimit neto të shprehura në numra absolut dhe relativ, 2018-2022.....	81
Tabela 17: Numri i bizneseve të regjistruara me pronarë të huaj, 2018-2022	83
Tabela 18: Importet dhe eksportet shprehur në milion, 2018-2022.....	85
Tabela 19: Numri i nxënësve të larguar jashtë vendit, 2018/2022	89
Tabela 20: Numri i nxënësve të riatdhesuar dhe regjistruar në sistemin arsimor, 2018-2022.....	89
Tabela 21: Numri i të Riatdhesuarve përfitues në Masat Aktive të Tregut të Punës (MATP), 2018-2022.....	91
Tabela 22: Statistikat lidhur me numrin e Lejeqëndrimit për Punë dhe Lejet e Punës Afatshkurtër për të Huajt, 2018-2022	91

Tabela 23: Numri i vizave të aprovuara sipas vendit të origjinës, 2018/2022	122
Tabela 24: Numri i vizave të refuzuara sipas vendit të origjinës,2018/2022	122
Tabela 25: Fitimi i shtetësisë sipas shtetësisë 2018-2022.....	123
Tabela 26: Migrantet e parregullt sipas shteteve 2018-2022.....	124
Tabela 27: Numri i personave të akomoduar në QMH 2018-2022.....	124
Tabela 28: Azilkërkuesit në Republikën e Kosovës sipas shteteve, 2018/2022.....	125
Tabela 29: Të huajt që kanë shprehur qëllim për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare (72 orëshi) 2018-2022.....	126
Tabela 30: Numri i lejeqëndrimeve të lëshuara për herë të parë për shtetasit kosovarë nga autoritetet e shteteve anëtare të BE-së dhe në zonën Schengen, 2018 – 2022	127
Tabela 31: Shkalla e punësimit.....	128
Tabela 32: Lirimi nga shtetësia sipas shteteve 2018-2022.....	128
Tabela 33: Refuzimi i hyrjes i shtetasve kosovarë në kufijtë e jashtëm të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, sipas shteteve, 2018 – 2022.....	129
Tabela 34: Shtetasit kosovarë u gjetën të jenë të pranishëm me qëndrim të parregullt në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, 2018 – 2022.....	130
Tabela 35: Shtetasit kosovarë të urdhëruar të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, 2018 – 2022	130
Tabela 36: Shtetasit kosovarë të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen në bazë të urdhrit për largim, 2018 – 2022.....	131
Tabela 37: Numri i shtetasve kosovarë, azilkërkues të regjistruar për herë të parë në vendet e BE-së dhe zonës Schengen, 2018 - 2022.....	132
Tabela 38: Numri i personave të ripranuar me forcë, vullnetarë dhe vullnetarë të asistuar nga IOM, 2018/2022.....	133

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Numri i vizave sipas misioneve diplomatike, 2018 - 2022	26
Figura 2. Lejeqëndrimet e përkohshme, për herë të parë dhe në vazhdim, 2018-2022.....	27
Figura 3. Numri i lejeve të qëndrimit të përkohshëm me qëllim të punësimit sipas lejeqëndrimeve për herë të parë dhe në vazhdim, 2018-2022.....	28
Figura 4. Numri i vendimeve për lejeqëndrim të përkohshëm me Shqipërinë sipas marrëveshjes 2022.....	28
Figura 5. Lejeqëndrimet e përhershme sipas viteve 2018-2022.....	29
Figura 6. Numri i lejeve të punës afatshkurtër sipas vitit 2018-2022.....	30
Figura 7. Numri i personave që kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës 2018-2022	33
Figura 8. Numri i vendimeve pozitive për fitim të shtetësisë së R. Kosovës me dekret presidencial 2018-2022	33
Figura 9. Numri i personave që lëvizin nga komuna në komunën tjetër, 2018-2022.....	37
Figura 10. Numri i imigrantëve që kanë hyrë në Kosovë në mënyrë të paautorizuar, 2018-2022.....	39
Figura 11. Imigrantët që kanë hyrë në Kosovë në mënyrë të paautorizuar sipas grupmoshës, e paraqitur në përqindje 2018-2022	40
Figura 12. Numri i të akomoduarve në Qendrën e Pritjes së Përkohshme	41
Figura 13. Numri i vendimeve për largim vullnetarë, vullnetarë IOM, me forcë dhe me vendim gjykate, 2018-2022.....	43
Figura 14. Azilkërkuesit në Republikën e Kosovës sipas grupmoshës, 2018-2022.....	48
Figura 15. Të huajt që kanë shprehur qëllim për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare (72 orëshi) 2020-2022.....	49
Figura 16. Kërkesat dhe vizat Schengen të lëshuara për shtetasit kosovarë, 2018 – 2022	51
Figura 17. Numri i kërkesave, viza të lëshuara dhe të refuzuara sipas shteteve, 2018-2022	51
Figura 18. Numri i lejeqëndrimit të parë lëshuar për shtetasit kosovrë dhe shpërndarja e tyre sipas arsyes në shtetet anëtare të BE-së dhe në zonën Schengen, 2018-2022.....	53
Figura 19. Shpërndarja në përqindje e lejeve të qëndrimit për herë të parë të lëshuara nga autoritetet e vendeve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, sipas pesë vendeve kryesore, 2018 – 2022	54
Figura 20. Numri i personave që janë liruar nga shtetësia e Republikës së Kosovës, 2018-2022	55
Figura 21. Shtetasit kosovarë, subjekt i autoriteteve të zbatimit të Ligjit të Imigrimit në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen, 2018 – 2022	56

Figura 22. Refuzimi i hyrjes në kufijtë e jashtëm të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, të shtetasve kosovarë, sipas arsyes, krahasim i periudhës 2018-2022 me periudhën e kaluar	57
Figura 23: Shtetasit kosovarë u gjetën të jenë të pranishëm me qëndrim të parregullt, sipas shteteve, 2018 - 2022	59
Figura 24: Shtetasit kosovarë të urdhëruar të largohen nga dhjet shtetet e para të BE-së, krahasim i periudhës 2018-2022	61
Figura 25: Shtetasit kosovarë të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen në bazë të urdhërit për largim, sipas shteteve, 2018-2022.....	63
Figura 26: Numri i kërkesave për azil nga shtetasit kosovarë në vendet e BE-së dhe zonës Schengen, 2018 - 2022	64
Figura 27: Numri i vendimeve të shkallës së parë vendimet pozitive, refuzimet për azilkërkuesit kosovarë, 2018 - 2022	66
Figura 28: Numri i vendimeve përfundimtare pas ankimimit ose shqyrtimit, vendimet pozitive, refuzimet për azilkërkuesit kosovarë, 2013 - 2022.....	67
Figura 29: Vendimet fillestare për azilkërkuesit kosovarë në Mbreterinë e Bashkuar (%), 2020 - 2022	68
Figura 30: Ripranimi vullnetarë dhe me forcë sipas viteve, 2018-2022	70
Figura 31: Ripranimi me forcë dhe vullnetarë sipas shteteve, 2018-2022	71
Figura 32: Ndhimja menjëherë pas arritjes dhe ndihmat emergjente të riadhesimit për periudhën 2018-2022	72
Figura 33: Ndhimja për riintegrim të qëndrueshëm, 2018-2022	73
Figura 34: Numri i personave të cilat kanë përfituar nga skemat e integritimit.....	74
Figura 35: Imigrimi në Kosovë sipas viteve, 2018-2022.....	78
Figura 36: Emigrimi nga Kosova i vlerësuar nga ASK-ja sipas viteve, 2018-2022.....	79
Figura 37: Rritja e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve.....	84
Figura 38: Bilanci tregtar në mallra dhe shërbime dhe si përqindje e BPV, 2018-2022.....	84
Figura 39: Investimet e huaja direkte në Kosovë të shprehura në miliona euro dhe si përqindje e BPV-së, 2018-2022	85
Figura 40: Të hyrat nga remitancat, 2018-2022	86
Figura 41: Shërbimet e udhëtimit të vizitorëve, 2018-2022	87
Figura 42: Të hyrat e përgjithshme nga Diaspora,2018/2022.....	88

Figura 43: Shkalla e mortalitetit në 1000 banorë në rajon në BE, 2019	93
Figura 44: Numri i certifikatave dhe vërtetimeve të lëshuara,2018/2022	94
Figura 45: Numri i aplikimeve për trajtim jashtë vendit,2018/2022	95

SHKURTESAT

Shkurtesat	Përshkrimi
APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
AQM	Autoriteti Qeveritar për Migrim
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ARC	Agjencia e Regjistrimit Civil
AKK	Agjencia e Kadastrale e Kosovës
ADA	Agjencioni Austriak për Zhvillim
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
BQE	Banka Qendrore Evropiane
DMH	Drejtoria për Migrim dhe të Huaj
DRPRIH	Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimi i të Huajve
DSHAM	Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim
DHTQNJ	Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore
DIMAK	Qendra Gjermane e Informacionit për Migrim, Aftësim Profesional dhe Karrierë
EUROSTAT	Zyra e Statistikave të Bashkimit Evropian
EFTA	Shoqata Evropiane për Tregtinë e Lirë
BE	Bashkimi Evropian
EUAA	Agjencia e Unionit Evropian për Azil
EE	Efiqjenca e Energjisë
FRONTEX	Agjencia Evropiane e Rojës Kufitare dhe Bregdetare
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
IT	Teknologjia Informativë
ITP	Parku i Inovacionit dhe Trajnimeve
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
IOM/ ONM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
KKR	Komisioni Kombëtar për Refugjatë
KASH	Korniza afatmeseme e shpenzimeve
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MIMAK	Projekt 'Fuqizimi i Autoriteteve në Kosovë për Menaxhim të Migrimit'
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MM	Memorandum i Mirëkuptimit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
MSH	Ministria e Shëndetësisë
ME	Ministria e Ekonomisë
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MSA	Marrëveshja e Stabilizim - Asocimit
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OSK	Oda e Stomatologëve të Kosovës
OIK	Oda e Infermierëve të Kosovës
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PK	Policia e Kosovës
PKK	Pika e Kalimit Kufitar
PSO	Procedura Standarde Operative
PZM	Profili i Zgjeruar i Migrimit
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
QPPM	Qendra e Pritjes së Përkohshme për Migrantë
QMH	Qendra e Mbajtjes për të Huaj
RKS	Republika e Kosovës
SKZH	Strategjia Kombëtare Zhvillimore
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SIVK	Sistemi Informativ për Viza
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
SISH	Sistemi Informativ Shëndetësor
UNHCR	Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar i Emergjencës për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar
WBIF	Korniza investuese e Ballakanit Perendimor

PARATHËNIE

Profili Zgjeruar i Migrimit 2018 – 2022, pasqyron zhvillimet kryesore në fushën e migrimit me fokus në kornizën ligjore, strategjike dhe institucionale. Në këtë dokument prezentohen të dhëna përmbajtësore sa i përket trendeve migratore, duke përfshirë edhe pjesën analitike mbi ndikimin e tyre në zhvillimin socio-ekonomik, demokratik dhe sektorial. Po ashtu, në kuadër të këtij dokumenti, janë prezentuar edhe rekomandimet për mekanizmat vendimmarrës, me qëllim të ndërlidhjes së politikave sektoriale me migrimin, si shtyllë e fuqishme dhe promotor të zhvillimit.

Profili i Zgjeruar i Migrimit është përgatitur nga Autoriteti Qeveritar për Migrim (AQM), si mekanizëm ndër-institucional i themeluar me Vendim¹ të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Profili i Zgjeruar i Migrimit 2018-2022, është i treti me radhë me qasje analitike dhe gjithpërfshirëse, pas atyre të publikuar për periudhën 2008-2012 dhe 2013-2017, ndërsa komplementon Profilet e Lehta të Migrimit të cilat publikohen në baza vjetore. Në këtë kontekst, analiza e trendeve të migrimit e prezantuar në këtë dokument mbulon periudhën 5-vjeçare nga viti 2018 deri në 2022, e paraqitur përmes figurave dhe tabelave. Në rastet ku ka pasur ndryshim të dukshëm të trendeve migratore, janë përfshirë në analizë krahasimore edhe periudhat paraprake. Të dhënat administrative dhe statistikore të përdorura në këtë dokument, janë burim i sistemeve informative ekzistuese të institucioneve të Republikës së Kosovës, të dhënave të Eurostatit, si dhe burimeve tjera ndërkombëtare.

Struktura dhe metodologjia e hartimit të këtij dokumenti është në përputhje me udhëzimet ndërkombëtare për hartimin e profileve të zgjeruara të migrimit, përkatësisht me Udhëzuesin e Komisionit Evropian² dhe atij të Organizatës Ndërkombëtare për Migrim IOM për Hartimin e Profileve të Migrimit³. Përmbajtja e dokumentit përfshin zhvillimet kryesore përgjatë pesë (5) viteve në zhvillimin e politikave strategjike dhe legjislatonit, zhvillimet institucionale, si dhe analizën e të dhënave statistikore që ndërlidhen me fushën e migrimit dhe ndikimit të tyre në zhvillimin socio-ekonomik, demokratik dhe politika tjera sektoriale. Në këtë kontekst,

¹ Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 14/94, i datës 14 shtator 2022 për themelimin e Autoritetit Qeveritar për Migrim.

² <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM%3A2005%3A0390%3AFIN%3AEN%3APDF>

³ https://publications.iom.int/system/files/pdf/migrationprofileguide2012_1oct2012.pdf

ky dokument ofron të dhëna dhe analiza të rëndësishme për politikëbërësit dhe vendimmarrësit në hartimin e politikave e strategjive koherente në fushën e migrimit.

Profili i Zgjeruar i Migrimit 2018-2022 është i ndarë në katër kapituj, pjesën hyrëse, konkluzionet, rekomandimet dhe ilustrimet përmes tabelave dhe figurave.

Pjesa A e dokumentit trajton trendet e migrimit dhe karakteristikat e migrantëve. Në këtë kapitull paraqiten trendet kryesore të migrimit dhe karakteristikat e migrantëve përkatësisht imigrimin dhe emigrimin, të ndarë sipas formës së migrimit të rregullt dhe të parregullt. Të dhënat e prezentuara janë zbërthyer sipas metodologjisë së aplikuar nga EUROSTAT-i përkatësisht sipas shtetësisë, gjinisë, grupmoshës etj.

Pjesa B përveç të dhënave statistikore përmban pjesën analitike lidhur me ndikimin e migrimit në zhvillimin socio-ekonomik, aspektet demokratike dhe ndikimit në politikat sektoriale të arsimit dhe kapitalit njerëzor, tregut të punës, sistemit shëndetësor, mjedisit etj.

Pjesa C i referohet përshkrimit të kornizës ligjore dhe institucionale, si dhe dokumenteve kryesore të politikave në fushën e qeverisjes së migrimit. Po ashtu, në kuadër të këtij kapitulli paraqitet bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar, marrëveshjet bilaterale në fushën e migrimit, programet dhe iniciativat globale në fushën e migrimit etj.

Pjesa D përmbledh gjithë dokumentin me të gjeturat kryesore lidhur me trendet e migrimit përgjatë periudhës 5 vjeçare, politikave të migrimit dhe ndikimit të migrimit. Po ashtu, në këtë pjesë ofrohen rekomandime specifike në fushën e qeverisjes së migrimit, ndërlidhjen e migrimit me politika zhvillimore sektoriale, si dhe rekomandimet lidhur me përmirësimin e statistikave në fushën e migrimit dhe politikëbërjen e bazuar në të dhëna.


Ndërsa në shtojcë/aneks janë prezentuar tabelat në format të zgjeruar, grafikonet apo informacionet e ndryshme që lidhen me përmbajtjen e tekstit të PZM-së 2018-2022.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Përgjatë periudhës raportuese 2018-2022, Republika e Kosovës ka arritur të konsolidoj dukshëm sistemin për menaxhimin e migracionit, duke fuqizuar mekanizmat përgjegjës institucional. Në këtë kontekst padyshim se ndër rezultatet kryesore ka qenë fuqizimi i Autoritetit Qeveritar për Migrim, si një mekanizëm këshillëdhënës dhe politikëbërës, i cili ka mbështetur institucionet përgjegjëse për menaxhimin e migrimit përmes zhvillimit të politikave strategjike dhe dokumenteve analitike duke u bazuar në të dhëna.

Në muajin Shtator 2022, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Vendimin Nr 14/96 për plotësim-ndryshimin e Vendimit 08/158 për themelimin e AQM-së, duke e konsoliduar kështu baza ligjore për funksionimin e këtij mekanizmi. Sipas Vendimit të Qeverisë për përcaktimin e përgjegjësive dhe detyrave, si dhe Udhëzuesit të Punës të AQM-së, përveç nivelit strategjik dhe sekretariatit, në kuadër të AQM-së janë funksionalizuar edhe gjashtë (6) grupe tematike të cilat adresojnë çështjet si në vijim: migrimin e rregullt dhe mobilitetin, migrimin e parregullt, migrimin e brendshëm, komunikimin, riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve, si dhe të dhënat në fushën e migrimit.

STRUKTURA E AQM-së



Gjatë vitit 2021 është miratuar Rregullorja (QRK)-Nr. 02/2021⁴ (plotësuar/ndryshuar me Rregulloren (QRK)-Nr. 04/2021)⁵, për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive. Me Rregulloren QRK-Nr. 02/2021 është shfuqizuar: Rregullorja (QRK)-Nr. 06/2020, për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK)-Nr. 07/2020.

Në aspektin e zhvillimeve strategjike është hartuar dhe miratuar Strategjia për Migrim 2021-2025 dhe Plani i Veprimit 2021-2023 (e miratuar me Vendimin e Qeverisë 10/39, më datë 13.10.2021). Kjo Strategji përmban katër objektiva strategjike, si dhe masa konkrete lidhur me menaxhimin e migrimit, parandalimin e migrimit të parregullt, avancimin e sistemit të migrimit të brendshëm, si dhe avancimin e qeverisjes së migrimit. Kjo Strategji është në harmoni me objektivat e Paktit Global për Migrim, Paktin Global për Refugjatë, si dhe Paktin e BE-së për Azil dhe Migrim.⁶

⁴ Rregullorja (QRK)-Nr. 02/2021⁴ (plotësuar/ndryshuar me Rregulloren (QRK)-Nr. 04/2021)⁴ për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=39317>

⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=47884->

⁶ <https://mpb.rksgov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/47/STRATEGJIA%20KOMB%C3%8BTARE%20KUND%C3%8BR%20T%20RAFIKIMIT%20ME%20NJER%C3%8BZ%20N%C3%8B%20KOSOV%C3%8B%202015-2019.pdf>

Po ashtu, gjatë periudhës raportuese 2018-2022, janë miratuar disa dokumente të politikave strategjike të cilat ndërlidhën me migrimin, siç janë Strategjia Kundër Trafikimit me Njerëz 2022-2024, Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2020-2025, Strategjia Kundër Krimit të Ogranizuar 2018-2022, Strategjia për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar 2018-2022, Plani i Reagimit për Menaxhimin e Fluksit të Mundshëm të Migrantëve etj. Një përshkrim më i detajuar i të gjitha dokumenteve strategjike ofrohet në Kapitullin C të këtij dokumenti, te pjesa e Qeverisjes së Migrimit.

Një zhvillim tjetër i rëndësishëm ka qenë nënshkrimi i Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për lehtësimin e procedurave dhe kushteve për marrjen e lejeqëndrimit të përkohshëm për shtetasit e Shqipërisë. Kjo marrëveshje ka filluar së zbatuari më datë: 11.02.2022.

Zgjerimi i kapaciteteve akomoduese sipas Planit të Reagimit për Menaxhimin e Fluksit të Mundshëm të Migrantëve, themelimi i Qendrës për Pritjen e Përkohshme, avancimi i praktikave për regjistrimin, profilizimin dhe referimin e migrantëve, janë disa nga të arriturat tjera kryesore përgjatë kësaj periudhe.

Padyshim se përveç rezultateve të arritura, Institucionet e Republikës së Kosovës janë ballafaquar edhe me sfida në menaxhimin e migrimit, të ndikuar nga faktorë të ndryshëm, gjatë periudhës 2018-2022. Ndër faktorët kryesor të cilët kanë ndikuar ka qenë pandemia Covid-19. Masat e ndërmarra nga shtetet e ndryshme, përfshirë edhe mbylljen e kufijve, kanë ndikuar që të kemi një numër të konsiderueshëm të migrantëve të ‘ngujuar’ brenda territorit të Republikës së Kosovës. Institucionet përgjegjëse ndërmorrën masat parandaluese për të mbrojtur migrantët nga pandemia, duke përfshirë kufizimin e lëvizjes dhe karantinën për migrantët dhe aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare në ardhje.⁷ Kjo ka ndikuar në stërngarkimin e sistemit vendor të pritjes dhe akomodimit të migrantëve dhe aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, ku përveç Qendrës së Azilit në Magure, është vënë në funksion edhe Qendra e Pritjes së Përkohshme në Vranidoll.

Po ashtu, situata me pandeminë Covid-19, ka ndikuar edhe në kthimin e organizuar të shtetasve të Kosovës që kanë mbetur të bllokuar në shtetet e ndryshme për arsye të humbjes së vendit të punës, duke përfshirë këtu edhe kategorinë e studentëve dhe të tjerët që kanë

⁷Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2020, faqe 46

udhëtuar për qëllime biznesore apo vizita familjare. Procesi i ripranimit të shtetasve Kosovarë me qëndrim të paligjshëm në vendet e BE-së dhe zonës Schengen, ishte suspenduar për disa muaj gjatë mbylljes së kufijve dhe kjo ka rezultuar me një numër dukshëm më të ulët të ripranuarëve në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019.

Në anën tjetër, gjatë vitit 2020 kemi pasur rënie të vizitave nga diaspora (kategoria e turizmit nga diaspora) për shkak të kufizimeve të lëvizjes si pasojë e pandemisë me Covid-19, por në anën tjetër kjo situatë e krijuar, ka rezultuar me rritjen e remitencave të dërguara përmes kanaleve formale. Në vitet pasuese është shënuar rritje të dërgesave/remitencave, si dhe të hyrave përmes turizmit të diasporës duke kulminuar në vitin 2022. Kjo rritje mund të jetë si rezultat i rritjes së numrit të shtetasve të Republikës së Kosovës, të cilët janë pajisur me lejeqëndrim në shtetet e BE-së dhe zonës Schengen dhe të njëjtit kanë kontribuar në rritjen e kontributit financiar nga diaspora dhe emigrantët e rinj, të cilët kanë emigruar për qëllime punësimi.

INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR SHTETIN

Popullsia, madhësia, vendet fqinje dhe gjatësia e kufijve

Republika e Kosovës është shteti më i ri në Ballkanin Perëndimor me një pozicion gjeografik qendror e rrethuar me Republikën e Shqipërisë, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Republikën e Malit të Zi dhe Republikën e Serbisë.

Republika e Kosovës është shtet i së drejtës me demokraci parlamentare i bazuar mbi parimin e ndarjes së pushteteve në atë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ. Qeveria e Republikës së Kosovës ushtron pushtetin ekzekutiv dhe është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe politikave shtetërore. Shtylla e tretë është pushteti gjyqësor, i cili është i pavarur, unik dhe ushtrohet nga gjykatat. Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit.



Rajoni: Evropa Juglindore

Gjerësia e territorit të Kosovës: 41° 51' 21 dhe 43° 16'

Gjatësia e territorit të Kosovës: 19° 59' dhe 21° 47'

Emri zyrtar: Republika e Kosovës

Kryeqyteti: Prishtina

Gjatësia e kufijve: Me Republikën e Shqipërisë në jugperëndim 113.551 km, me Republikën e Maqedonisë së Veriut në jug 170.772 km, me Republikën e Malit të Zi në veriperëndim 79.165 km, me Republikën e Serbisë në verilindje 380.068 km. Kufiri i Republikës së Kosovës me vendet fqinje kryesisht kalon nëpër male dhe ka karakter natyror, kurse gjatësia e përgjithshme e kufirit është 743.556 km⁸.

Sipërfaqja⁹: 10,908 km².

Vendet fqinje: Republika e Shqipërisë, Republika e Maqedonisë së Veriut, Mali i Zi, Republika e Serbisë.

Popullsia: 1,762,220 (e vlerësuar më 31 Dhjetor 2022)

Dendësia e popullsisë: 162 banorë për 1 km²

Forma e qeverisjes: Republikë Parlamentare

Valuta: Euro (EUR)

Data e pavarësisë: 17 shkurt 2008

Presidente: Znj. Vjosa Osmani

⁸ Strategjia Shtetërore e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2020-2025
<https://mpb.rksgov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/364/Strategjia%202020-2025.pdf>

⁹ Po aty

A: TRENDET E MIGRIMIT DHE KARAKTERISTIKAT E MIGRANTËVE

Në këtë pjesë paraqiten të dhënat statistikore, përfshirë trendet kryesore, si dhe karakteristikat e migrantëve.

Imigrimi i rregullt

Gjatë periudhës referuese, numri i vizave të lëshuara hyrëse në Republikën e Kosovës për shtetasit e huaj, tregon tendenca rritje prej 22.5 %, krahasuar me periudhën e kaluar 2013 - 2017. Rritja e numrit të vizave të lëshuara hyrëse është ndikuar nga lëshimi i vizave të kategorisë D, kurse për ato të kategorisë C, ka patur një trend linear.

Gjatë periudhës 2018 - 2022, gjithsej 24,158, shtetas të huaj kishin lejeqëndrim të përkohshëm në Republikën e Kosovës. Krahasuar me periudhën 2013 - 2017, kishte një numër dukshëm më të lartë dhe përbënte rritje prej 33.8%. Kryesisht lejeqëndrimi i përkohshëm u lëshua për arsye punësimi - 52.4%, bashkim familjar - 40.3%, studim/shkollim - 5.5%. Ndërsa, lejeqëndrimi i përhershëm, gjatë periudhës raportuese u rrit për rreth njëherë e gjysmë, krahasuar me periudhën e kaluar.

Shkalla e dhënies së shtetësisë Kosovare pothuajse është dyfishuar në periudhën e referencës me 81.8%, krahasuar me periudhën e kaluar. Në shumicën e rasteve, shtetësia kosovare iu dha shtetasve të vendeve fqinje, kurse shtetasve të shteteve si Gjermania, Norvegjia, Zvicrra dhe Kroacia, shtetësia kosovare iu dha (kryesisht atyre me origjinë kosovare) me përqindje më të vogël përkatësisht nën 10%.

Imigrimi i parregullt

Numri i imigrimit të parregullt drejt Republikës së Kosovës, gjatë periudhës referuese ka vazhduar të rritet. Numri i përgjithshëm i personave të cilëve iu është refuzuar hyrja në pikat e kalimit kufitar (PKK), krahasuar me periudhën e kaluar, kishte rritje për rreth 60%.

Numri i imigrantëve të parregullt që kanë kaluar kufirin dhe kanë hyrë në territorin e Republikës së Kosovës në mënyrë të paautorizuar, gjatë periudhës 2018 - 2022, u rrit për dhjetë (10) herë krahasuar me periudhën e kaluar.

Numri i shtetasve të huaj të cilët janë zënë me qëndrim të paligjshëm brenda territorit të Republikës së Kosovës u trefishua krahasuar me periudhën e kaluar. Si rrjedhojë, pati rritje të urdhër largimeve vullnetare për rreth 63%, kurse largimet me forcë u zvogluan për rreth -10%, krahasuar me vitin e kaluar. Në këtë zbritje mund të ketë ndikuar shfrytëzimi i kthimit të asistuar vullnetar përmes IOM.

Trafikimi me qenie njerëzore

Numri i rasteve të iniciuara të kontrabandës me migrantë gjatë periudhës referuese u zvoglua për rreth 65%, krahasuar me periudhën e kaluar. Numri më i madh i rasteve të iniciuara të kontrabandës me migrantë është shënuar në vitin 2022.

Gjatë periudhës referuese u identifikuan 11 viktima të TQN, që në krahasim me periudhën e kaluar kishte rënie për rreth -173%. Kryesisht forma më e shpeshtë e TQN, ka qenë shfrytëzimi seksual.

Azili dhe përcaktimi i statusit të mbrojtjes ndërkombëtare

Numri i azilkërkuesve në Republikën e Kosovës ka shënuar rritje për rreth shtatëfishit, krahasuar me periudhën e kaluar. Në periudhën referuese, azilkërkuesit me numër më të madh vinin nga këto shtete: Siria, Iraku dhe Maroku.

Emigrimi i rregullt

Kërkesat e përgjithshme për viza Schengen nga shtetasit kosovarë në misionet diplomatike dhe konsullore të shteteve anëtare të BE-së dhe në zonën Schengen, të akredituara në Republikën e Kosovës dhe vendet e rajonit, gjatë periudhës 2018 - 2022, ka shënuar rritje prej rreth 16.2%, krahasuar me periudhën e kaluar. Nga numri i përgjithshëm i kërkesave për viza Schengen, 84% ishin pozitive, ndërsa 16% u refuzuan.

Gjatë periudhës së referencës, numri i shtetasve kosovarë me lejeqëndrime për herë të parë në vendet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, ka vazhduar të rritej. Krahasuar me periudhën e kaluar, dhënia e lejeqëndrimeve të para u rrit prej rreth 38.3%.

Shumica e lejeqëndrimeve për herë të parë, të lëshuara për shtetasit kosovarë gjatë periudhës referuese kishin të bënin me bashkimin familjar 46% dhe qëllime punësimi 36%. Rreth dy të tretat e shtetasve kosovarë që kanë leje të parë të qëndrimit të vlefshëm në vendet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, qëndrojnë në Gjermani, Slloveni dhe Kroaci .

Shkalla e lirimit nga shtetësia e Republikës së Kosovës gjatë kësaj periudhe është ulur për rreth 13%, krahasuar me periudhën referente. Personat të cilët janë liruar nga shtetësia kosovare në shumicën e rasteve kanë pranuar shtetësinë gjermane dhe austriake në të njëjtën mënyrë, si në periudhën e kaluar.

Emigrimi i parregullt

Të dhënat e regjistruara tregojnë se numri i shtetasve kosovarë të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufi ose të zënë në kufi në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, ishte më i lartë për rreth 14% krahasuar me periudhën e kaluar. Në anën tjetër, tendenca të rënies kishte përgjatë gjithë periudhës 2018–2022, me një numër relativisht konstant, mesatarisht rreth 5,057 personave në vit, për shtetasit kosovarë të cilët janë zënë me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen.

Numri i shtetasve kosovarë të urdhëruar të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen gjatë viteve 2018-2022, ka ndryshuar vazhdimisht, por gjithsesi ka qenë në rënie. Numri i shtetasve të Republikës së Kosovës, të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen pas një urdhri për largim, u zvoglua për rreth pesëfishit krahasuar me periudhën e kaluar.

Azilkërkuesit Kosovarë në Shtetet e BE-së dhe Zonës Schengen

Numri i kërkesave të qytetarëve kosovarë për mbrojtje ndërkombëtare në vendet e BE-së dhe zonës Schengen, që nga viti 2016 ka pasur trend në rënie deri në vitin 2020, ndërsa në vitin 2021 kërkesat për azil për herë të parë janë rritur me rreth 4.1% (1,640 kërkesa), krahasuar me vitin 2020 kur ishin 1,575 kërkesa dhe 52.1% (2,495 kërkesa) në 2022, krahasuar me 2021. Franca, Gjermania dhe Italia ishin vendet me numrin më të lartë të shtetasve kosovarë të cilët aplikuan për azil.

Në periudhën 2018-2022, një shumicë e konsiderueshme (86%) e kërkesave të shtetasve kosovarë për azil, në vendet e BE-së dhe zonës Schengen u konsideruan të pabazuara, duke rezultuar në vendime të negative, kurse 14% morën vendime pozitive.

Ripranimi dhe riintegrimi

Krahasuar me pesëvjeçarin e mëparshëm, numri i përgjithshëm i personave të ripranuar gjatë kësaj periudhe, kishte rënie të dukshme. Nga numri i të ripranuarve gjatë periudhës 2018-2022, rreth 73% janë kthyer me forcë, rreth 5% vullnetarë dhe 22% të asistuar nga IOM. Gjatë periudhës 2018 - -2022, rreth 80% e numrit të përgjithshëm të personave të ripranuar ishin nga Gjermania, Franca dhe Zvicra.

Migrimi dhe zhvillimi

Dërgesat e migrantëve gjatë periudhës referuese kanë shënuar rritje të vazhdueshme. Në vitin 2022, remitancat u rritën prej rreth 6.1%, krahasuar me vitin 2021. Dërgesat e emigrantëve në vitin 2022 kanë pasur pjesëmarrje prej 13.66% në bruto produktin vendor (BPV). Gjatë periudhës së referencës, shumat totale të remitancave tejkalonin investimet e huaja direkte. Burimet kryesore të dërgesave të emigrantëve edhe në këtë periudhë vazhduan të jenë nga Gjermania dhe Zvicra me rreth 60%, të totalit të dërgesave të pranuar në Republikën e Kosovës.

Investimet e Huaja Direkte (IHD), gjatë kësaj periudhe gjithashtu kanë shënuar rritje të vazhdueshme. Sektorët që kanë pasur trend pozitiv nga Investimet e Huaja Direkte (IHD) dhe kanë ndikuar në rritjen e investimeve janë sektorët e patundshmërisë, sektori financiar, sektori i xehetarisë etj.

Në periudhën 2018-2022, rritje prej rreth 63%, shënoi regjistrimi i bizneseve, ku përpos bizneseve me pronarë të huaj, një numër i konsedueshëm ka qenë nga diaspora dhe ky trend vazhdon të jetë në rritje e sipër.

Migrimi i brendshëm

Të dhënat për migrimin e brendshëm paraqiten për herë të parë në kuadër të Profilit të Migrimit. Gjatë periudhës 2018-2022, numri i qytetarëve të cilët kanë lëvizur nga një komunë, në komunën tjetër, arrin në 88,508. Ndërsa, numri i qytetarëve të cilët lëvizën brenda një komune (nga zonat rurale në zona urbane apo anasjelltas) ishte 70,201.

Personat e zhvendosur brenda vendit dhe jashtë vendit (PZHBJV)

Gjatë periudhës 2018 - 2022 janë kthyer 1,484 persona të zhvendosur brenda dhe jashtë vendit. Po ashtu, janë ndërtuar dhe renovuar gjithsej 432 shtëpi banimi, ndërsa 216 persona të zhvendosur janë të vendosur në qendra kolektive.

A.1. IMIGRIMI

Në bazë të përkufizimeve të organizatave ndërkombëtare të cilat gjejnë aplikim universal, nga perspektiva e vendit të arritjes, imigrimi i referohet 'lëvizjes së migrantëve nga vendi i origjinës ose vendbanimit të zakonshëm në vendin e destinacionit, i cili bëhet efektivisht vendi i ri i zakonshëm i banimit të tij/saj'¹⁰.

A.1.1.Imigrimi i rregullt

Në imigrimin rregullt përfshihen të huajt të cilët kanë status të rregullt të qëndrimit në Kosovë, të kategorizuar sipas legjislacionit nacional dhe ndërkombëtarë. Në këtë kategori përfshihen të huajt : me viza të hyrjes, me lejeqëndrim, me marrëveshje ndërkombëtare, të huajt për të cilët nuk aplikohet regjimi i vizave, personat me mbrojtje ndërkombëtare, mbrojtje të përkohshme, dhe personat me status personi pa-shtetësi. Përgjatë periudhës 2018-2022, në bazë të dhënave administrative dhe statistikore, kemi pasur një trend të rritjes së imigrimit në formë të rregullt, i shtyer nga disa faktorë të cilët do të elaborohen në seksionet në vazhdim.

A.1.2. Politika / Regjimi i Vizave

Politika e regjimit të vizave të Republikës së Kosovës është e rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-219 plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.06/L-036 për të Huajt. ¹¹

Shtetet të cilat i nënshtrohen regjimit të vizave, janë të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë për vendosjen e Regjimit të Vizave për të Huajt në Republikën e Kosovës, Nr.12/108, të datës

¹⁰ <https://www.iom.int/key-migration-terms>

¹¹ **Viza transite - Tipi A** : Është viza transit në aeroport që i jep të drejtën të huajit të hyjë dhe të qëndrojë në zonën për qarkullim ndërkombëtar të aeroportit, deri në nisjen e fluturimit për në vendin e destinacionit. Vlefshmëria e kësaj vize jepet në përputhje me kohën dhe rezervimet e biletave për udhëtimin/et në të cilin/at aplikuesu prashikon të kalojë transit.

Viza transite - Tipi B i lëshohet të huajit me qëllim të kalimit në territorin e Republikës së Kosovës, në formë transite përmes hyrjes/daljes nga Pikat e Kalimit Kufitar.

Visa hyrëse - Tipi C: Lëshohet për qëllim të hyrjes dhe qëndrimit në territorin e Republikës së Kosovës dhe i jep të drejtën mbajtësit të saj të hyjë dhe të qëndrojë në Republikën e Kosovës, jo më gjatë se 90 ditë brenda çdo periudhe prej 180 ditë.

Viza hyrëse - Tipi D: Është viza hyrëse që i lëshohet shtetasit të huaj që ka për qëllim të hyjë dhe qëndrojë në Republikën e Kosovës, më shumë se 90 ditë, dhe për t'u pajisur me leje qëndrim afatshkurtër për qëllim bashkimi familjar, punësimi dhe studimi.

14.12.2012. Ky vendim është plotësuar dhe ndryshuar në vazhdimësi varësisht nga vlerësimet dhe rekomandimet e MPJD¹². Aplikimi për vizë hyrëse të Kosovës bëhet në këto misione diplomatike/konsullore: Nju Jork, Paris, Tiranë, Shkup, Zagreb, Riad, Sofje, Vjenë, Bruksel, Londër, Stamboll, Kanbera, Berlin, Tokio, Gjenevë, Budapest, Podgoricë, Daka, Doha dhe në Pikat e Kalimit Kufitar (PKK) të Republikës së Kosovës: DSHAM, PKK Hani i Elezit, PKK Vermica, PKK Aeroporti “Adem Jashari”, PKK Jarinë.

Gjatë periudhës kohore 2018 - 2022, gjithsejt ka pasur 6,155 kërkesa për vizë hyrëse në Republikën e Kosovës. Nga ky numër janë aprovuar 86% (5,202) të kërkesave dhe janë refuzuar 14% (953).

Tabela 1: Numri i vizave të aprovuara dhe të refuzuara sipas llojit të vizave

VITI	Viza D- aprovuara	Viza D refuzuara	Viza C- aprovuara	Viza C- refuzuara	Viza B- aprovuara	Viza B- refuzuara	Viza A aprovuara	Viza A- refuzuara
2018	88	53	1,114	118	32	1	0	0
2019	269	53	1,129	74	30	2	0	0
2020	63	43	430	97	3	0	0	0
2021	115	38	599	141	4	2	0	0
2022	178	62	1,117	265	30	3	1	1
Gjithsej	713	249	4,389	695	99	8	1	1

Burimi;MPJD

Sa i përket llojeve të vizave të aprovuara, viza C ka një trend linear me përjashtim të viteve 2020 dhe 2021, ku për shkak të kufizimeve si rezultat i pandemisë Covid-19, kemi pasur numër më të ulët të aprovimeve. Ndërsa në anën tjetër, të dhënat e gjeneruara nga sistemi SIVK, konfirmojnë një trend të rritjes së kërkesave dhe aprovimeve të llojit të vizës D dhe kjo vjen si rezultat i nevojave/kërkesës së tregut të punës.

Gjatë periudhës 2018- 2022, numri më i madh i vizave të aprovuara ishte nga shteti i Bosnjës dhe Hercegovinës me 1,952 (37.5%), pasuar nga Ukraina me 250 (4.8%), Kina me 201 (3.8%) dhe shtetet tjera me 2,799 (54%). Në anën tjetër vërehet një trend në rritje sa i përket kërkesave


¹² Vendimin Nr. 15/158, të datës 29.11.2013; Vendimin Nr. 08/167, të datës 22.01.2014; Vendim Nr.07/21, dt.28/7/2021.Ndryshim dhe plotësim i Vendimit të Qeverisë Nr.15/158, të dt.29.11.2013, për vendet eBE-së, Zona Schengen,BM dhe Irlanda e Veriut, Selia e Shenjët,Pric. Andora, Monako, Repub.San Marinos, Shqipëris, M. të Zi dhe Serbisë.

Vendim Nr. 14/67, dt. 09.03.2022. Sipas pikës 6 të Vendimit të Qeverisë Nr.15/158 të dt. 29.11.2013 i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 08/167, të dt. 22.01.2014 dhe Vendimin e Qeverisë Nr.14/55, të dt. 06.07.2018,(për shtetasit e Ukrainës). Vendim Nr.10/99, dt.30.09.2022. Pezullohet përkohësisht zbatimi i pikës 2 dhe 5, të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.13/158, të dt.29 nëntor 2013 për Shtetasit e Federatës Ruse.

për viza nga vendet Aziatike (shih tabelën 23 dhe 24 në aneks lidhur me numrin e vizave të aprovuara dhe të refuzuara sipas vendit të origjinës).

Numri i përgjithshëm i aplikimeve në misionet diplomatike, është 5,758 kërkesa të paraqitura, prej tyre të aprovuara janë 4,852, ndërsa të refuzuara 906. Numri më i madh i kërkesave/aplikimeve është në Konsullatën e Përgjithshme në Shkup 2,304 aplikime, pastaj në Tiranë, 1,359 aplikime, duke u pasuar nga konsullatat tjera të paraqitura në figurën 1.

Figura 1. Numri i vizave sipas misioneve diplomatike, 2018 - 2022



Burimi;MPJD

A.1.3. Të huajt me qëndrim të rregullt në Republikën e Kosovës

Ministria e Punëve të Brendshme përkatësisht Divizioni për të Huajt në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM), është autoriteti shtetëror përgjegjës për pranimin, shqyrtimin dhe vendimmarrjen lidhur me kërkesat për pajisje me lejet e qëndrimit të përkohshëm (përfshirë lejeqëndrimet për qëllim punësimi), dhe lejet e përhershme të qëndrimit në Republikën e Kosovës.

Në bazë të Ligjit për të Huajt Nr.04/L 219, Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, lëshon "Leje pune afatshkurtër për të huajt", në kohëzgjatje prej 30 ditëve, 60 ditëve dhe 90 ditëve, në një periudhë kohore prej 180 ditëve, brenda vitit. Po ashtu, Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës/MFPT është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të punësimit dhe trajnimeve profesionale për të huajt, të cilët kanë qasje në tregun e punës në Republikën e Kosovës.


Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve është gjithashtu përgjegjëse për vendosjen e bashkëpunimit në fushën e shërbimeve të punësimit dhe trajnimeve profesionale përmes marrëveshjeve bilaterale me shtetet e ndryshme, kryesisht të shteteve të Bashkimit Evropian. Në kuadër të marrëveshjeve bilaterale apo memorandumeve të mirëkuptimit, Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, ofron shërbimet si: këshillim, informim, trajnime profesionale, (ndërmjetësim në punësim apo aftësim) dhe lehtësim të punësimit për punëkërkuarit kosovarë të cilët kërkojnë punësim jashtë vendit.

Gjatë periudhës 2018 - 2022, sistemi informativ i DSHAM-së, është avancuar dhe ka filluar gjenerimin e të dhënave lidhur me lejeqëndrimet në dy kategori: 1) lejeqëndrimet për herë të parë, dhe 2) lejeqëndrimet në vazhdim.

Lejeqëndrimet e përkohshme

Gjatë periudhës 2018-2022, janë lëshuar gjithsej 24,158 vendime pozitive për lejeqëndrime të përkohshme . Lejeqëndrime për herë të parë ishin 7,794 (32.3%), ndërsa lejeqëndrime në vazhdim 16,364 (67.7%). Arsytet e lëshimit të lejeve të qëndrimit të përkohshëm sipas kategorive janë si në vijim: qëllime punësimi 12,674 (52.4%), bashkim familjarë 9,733 (40.3%), studim/shkollim 1,329 (5.5%), arsye humanitare 177 (0.7%), qëndrim autonom 39 (0.2%), dhe për arsye të tjera 206 (0.85%).

Figura 2. Lejeqëndrimet e përkohshme, për herë të parë dhe në vazhdim, 2018-2022




Burimi: MPB/DSHAM

Numri i lejeve të qëndrimit të përkohshme të lëshuara sipas shteteve është si në vijim: Shqipëria me 6,591 (27.3%), Turqia me 5,260 (22%), Serbia me 4,355 (18%), Maqedonia e Veriut

me 2,400 (10 %), SHBA me 1.121 (4.6%), Mali i Zi 389 (1.6%), Gjermania 357 (1.5%) dhe shtete të tjera me 3,685 (15.3%). Sipas gjinisë, nga numri i përgjithshëm i vendimeve pozitive për lejeqëndrim të përkohshëm 13,164 (54.5%) janë të gjinisë femërore, kurse 10,994 (45.5%) janë të gjinisë mashkullore.


Figura 3. Numri i lejeve të qëndrimit të përkohshëm me qëllim të punësimit sipas lejeqëndrimeve për herë të parë dhe në vazhdim, 2018-2022



Burimi: MPB/DSHAM

Gjatë periudhës 2018-2022, numri i lejeve të qëndrimit të përkohshëm për arsye punësimi sipas vendeve të origjinës është si në vijim: Turqia me 3,345 (26.4%), Shqipëria me 3,157 (24.9%), Serbia me 1,528 (12%), Maqedonia e Veriut me 1,138 (9%), SHBA me 838 (6.6%) Mali i Zi me 111 (0.9%), Gjermania 223 (1.7%) dhe shtetet e tjera me 2,328 (18.4%).

Figura 4. Numri i vendimeve për lejeqëndrim të përkohshëm me Shqipërinë sipas marrëveshjes 2022




Burimi: MPB/DSHAM

Siç mund të shihet nga të dhënat e paraqitura në figurën 4, rritja e numrit të lejeve të qëndrimeve të lëshuara, është në përputhje me kërkesat në rritje për lejeqëndrime dhe kjo para se gjithash vjen si rezultat i hyrjes në fuqi të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për lehtësimin e procedurave dhe kushteve për marrjen e lejeqëndrimit të përkohshëm për shtetasit e Shqipërisë dhe saktësisht kjo marrëveshje ka ndikuar për të formalizuar qëndrimin e tyre në Republikën e Kosovës.

Lejeqëndrimet e përhershme

Gjatë periudhës 2018 -2022, janë lëshuar gjithsej 810 vendime pozitive për lejeqëndrim të përhershëm. Arsyet e lëshimit të lejeve të qëndrimit të përhershëm sipas kategorive janë si në vijim: punësim 307 (38%), bashkim familjarë 214 (26.4%), lirim nga shtetësia 127 (15.7%), rrethana të jashtëzakonshme 62 (7.6%) dhe arsye të tjera 100 (12.3%).

Figura 5. Lejeqëndrimet e përhershme sipas viteve 2018-2022



Burimi: MPB/DSHAM


Sipas gjinisë, nga numri i përgjithshëm i vendimeve pozitive për lejeqëndrim të përhershëm, 455 (56.2%) janë të gjinisë mashkullore, kurse 355 (43.8%) janë të gjinisë femërore. Numri i lejeve të qëndrimit të përhershëm të lëshuara sipas shteteve është si në vijim: Serbi 181 (22.3%), Gjermani 138 (17%), Shqipëri 136 (16.8%), Maqedoni e Veriut 90 (11%), Turqi 89 (11%), Austri 39 (4.8%), Amerikë 17 (2.1%) dhe shtete të tjera me 120 (14.8%). Sipas këtyre të dhënave stoku më i madh i lejeqëndrimeve është për qëllime punësimi, si rezultat i lejeqëndrimeve në vazhdim të cilat edhe në të kaluarën kanë qenë për qëllime pune. Gjatë

periudhës 2018 - 2022, shtetet më të përfaqësuara me numrin e lejeve të qëndrimit të përhershëm për arsye punësimi janë: Maqedonia e Veriut 80 (26%), Shqipëria 73 (23.8%), Turqia 53 (17.3%), Serbia 51 (16.6%), SHBA 8 (2.6%), Kinë 5 (1.6%), Korea e Jugut 4 (1.3%) dhe shtete të tjera 33 (10.7%).

Leje pune afatshkurta¹³

Gjatë periudhës 2018 - 2022, viti 2020 krahasuar me vitet paraprake, kemi një rënie drastike të numrit të lejeve të punës afatshkurtër për të huajt, si pasojë e pandemisë Covid-19.

Figura 6. Numri i lejeve të punës afatshkurtër sipas vitit 2018-2022



Burimi;APRK

Bazuar në të dhënat në figurën 6, shihet që numri më i madh i të huajve që kanë ardhur në territorin e Republikës së Kosovës për të punuar në një periudhë afatshkurtër deri në 90 ditë brenda periudhës prej 180 ditëve, janë ekspertë të fushave të caktuara të cilët angazhohen bazuar në marrëveshjet investive dhe projekteve të caktuara afatshkurtëra. Prej tyre janë meshkujt me 88%, ndërsa femra vetëm 12%.

Shërbimet e migrimit për çështje të punësimit

Nga viti 2018-2022, APRK-ja ka vazhduar me zbatimin e disa programeve për të përkrahur kosovarët që vendosin të emigrojnë për qëllime të punësimit. Po ashtu, APRK-ja në bashkëpunim me GIZ-in dhe Qendrën Informuese Gjermane për Migrim, Aftësim Profesional

¹³ Ligji Nr. 04/L-219 për të Huajt dhe Ligji Nr. 03/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt, neni 22, Leja e punës afatshkurtër deri në nëntëdhjetë (90) ditë brenda çdo periudhe prej njëqindetëdhjetë (180) ditëve brenda një (1) viti, mund të punojnë të huajt, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8876>

dhe Karrierë (DIMAK), ka vazhduar bashkëpunimin i cili përfshin një sërë shërbime informuese dhe këshillime në fushën e migrimit. Në këtë drejtim memorandumet e nënshkruara në vitet paraprake kanë vazhduar të zbatohen.

- Memorandum i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Landesverband Bayerischer Bauinnungen dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH Kosovo (GIZ), që synon përmirësimin e mundësive për arsimim dhe aftësimin profesional në fushën e ndërtimit në Republikën e Kosovës. Gjatë vitit 2018, të rinjëve nga Republika e Kosovës iu është ofruar mundësia e arsimimit dhe aftësimit profesional në sistemin dytësor 2-vjeçar në Gjermani, në fushën e ndërtimit.
- Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Fondacionit Besa dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH Kosovo (GIZ), me të cilin synohet migrimi qarkor dhe lëvizshmërisë përmes përmirësimit të arsimit dhe aftësimit. Gjatë vitit 2018 nga ky program kanë përfituar 18 kandidatë të cilët kanë qenë pjesë e programeve për punësim dhe aftësim në Gjermani, dhe të cilët monitorohen nga Agjencia (APRK).
- Memorandum i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – Unionin e Bizneseve dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH Kosovo (GIZ), që synon përmirësimin e mundësive për arsimim dhe aftësimin profesional në fushën e ndërtimit në Republikën e Kosovës. Gjatë vitit 2019, të rinjëve nga Republika e Kosovës iu është ofruar mundësia e arsimimit dhe aftësimit profesional në sistemin dual 2-vjeçar në Gjermani, në fushën e ndërtimitarisë dhe gastronomisë.
- Në tetor të vitit 2020, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës ka arritur Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë për Mobilitetin në Punë, mbi çështjet e punësimit dhe aftësimeve profesionale, bazuar mbi orientimet e BE-së, zotimet që dalin nga procesi i Berlinit, bashkëveprimet ndërkufitare në kuadër të përafrimit të masave në lidhje me mobilitetin për punë dhe politikat e përbashkëta. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është përforcimi i marrëdhënieve mes agjencive zbatuese të politikave të punësimit dhe aftësimit profesional me qëllim shkëmbimin e

praktikave më të mira dhe mundësinë e punësimit të punëtorëve nga secili shtet në territorin e shtetit tjetër.

A.1.4. Fitimi i shtetësisë së Republikës së Kosovës


Divizioni për Shtetësi/DSHAM, është autoriteti kryesor shtetëror përgjegjës për zbatimin e Ligjit Nr. 04/L-215¹⁴ për Shtetësinë e Kosovës, ligj ky i cili përcakton mënyrat e fitimit, humbjes dhe rifitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës, si dhe rregullon çështje të tjera të ndërlidhura me shtetësinë e Republikës së Kosovës. Në nenin 5 është përcaktuar mënyra e fitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës: me lindje, me adoptim, me natyralizim, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe në bazë të neneve 31 dhe 32 të këtij ligji. Për sa i përket dhënies së shtetësisë, një pjesë e kërkesave bëhet nga persona me origjinë nga Kosova.

Gjatë periudhës 2018-2022, shtetësinë e Republikës së Kosovës e kanë fituar 1,824 persona, kurse 2,321 personave iu është refuzuar kërkesa për arsye të mosplotësimit të kriterëve ligjore. Personat që kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës me numrin më të madh i përkasin shtetasve me shtetësi të Republikës së Serbisë 499 (27.3%), Republikës së Shqipërisë 256 (14%), Republikës së Maqedonisë së Veriut 183 (10%), Republikës Federale të Gjermanisë 154 (8.4%), Republikës së Malit të Zi 63 (3.5%), Norvegjisë 54 (3%), Konfederats së Zvicrës 53 (3%), Kroacisë 48(2.6%) dhe me shtetësi tjera me 514 (28.2%). Për më shumë info, shih tabelën 25 në aneks.

Gjatë periudhës raportuese, personat që kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës me numrin më të madh i përkasin grupmoshës 18-34 me 827 (45.3%), e pasuar nga grupmosha 35-64 me 822 (45%), grupmosha 14-17 me 82 (4.5%), grupmosha +65 me 80 (4.28%), grupmosha 6-13 me 10 (0.5%) dhe grupmosha 0-5 me 3 (0.2%).

¹⁴ Të dhënat statistikore për periudhën 2018-2022 burojnë nga Ligji Nr.04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës.

Figura 7. Numri i personave që kanë fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës 2018-2022




Burimi: DSHAM

Gjatë periudhës 2018-2019, trendet e fitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës janë të përafërta, përjashtuar me vitin 2020, ku për arsye të pandemisë Covid-19, trendi i fitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës kishte rënie. Ndërsa gjatë periudhës 2021 dhe 2022, kishte rritje të trendit të fitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës. Ky trend i rritjes ndërlihet kryesisht me paralajmërimet nga shteti gjerman rreth njohjes/lejimit të dyshetësisë dhe kërkesat e diasporës për pajisje me shtetësi të Republikës së Kosovës.

Nga numri prej 1,824 personave të cilët kanë fituar shtetësinë, 987 (54%) prej tyre janë të gjinisë femrore dhe 837 përkatësisht (46%) janë të gjinisë mashkullore.

Figura 8. Numri i vendimeve pozitive për fitim të shtetësisë së R. Kosovës me dekret presidencial 2018-2022



Burimi: Zyra Presidenciale

Migrimi i brendshëm (lëvizja e qytetarëve brenda territorit)

Migrimi i brendshëm si fenomen shoqëror i referohet lëvizjes së njerëzve brenda territorit të shtetit, përkatësisht nga qyteti në qytet, nga zonat rurale në zonat urbane, si dhe anasjelltas. Kjo lëvizje migratore brenda territorit të shtetit, padyshim se ka ndikim në aspektin demografik, si dhe në planifikimin e politikave publike në fushën e ekonomisë dhe financave publike, çështjeve sociale, arsimit, shëndetësisë, kulturës, rinisë, sportit etj.

Ngjashëm si me format tjera të migrimit ndërkombëtar, migrimi i brendshëm ndikohet nga një kombinim i faktorëve shtytës dhe tërheqës. Ndër faktorët shtytës konsiderohet: 1) Papunësia dhe mundësitë e limituara ekonomike - në zona të caktuara të vendit të cilat mund të shtyjnë individët drejt migrimit në zona me potencial më të madh ekonomik, kryesisht në qendrat kryesore urbane; 2) Shërbimet publike jo adekuate sidomos në fushën e shëndetësisë, arsimit dhe infrastrukturës; 3) Faktorët mjedisor sidomos në zona të cilat janë të ndieshme ndaj fatkeqësive natyrore, kualitetit të ajrit etj., si dhe 4) Tensionet politike dhe të sigurisë në zona të caktuara, mund të ndikojnë në zhvendosjen e qytetarëve në pjesë të caktuara të vendit. Ndërsa faktorët tërheqës kryesisht ndërlidhen me: 1) Mundësitë më të mira për punësim dhe kualitet të jetesës; 2) Shërbime më efektive në komunën/vendbanimin e destinacionit; 3) Mundësi më të mira për edukim cilësor; 4) Infrastruktura; 5) Diversiteti kulturor; 6) Siguria dhe stabiliteti; 7) Rrethi familjar etj.

Faktorët e larpërmendur padyshim se kanë ndikur edhe në lëvizjet e brendshme migratore në Republikën e Kosovës. Në bazë të të dhënave të cilat prezentohen për herë të parë në Profilin e Zgjeruar të Migrimit 2018-2022, konfirmohet fakti se një numër i konsiderueshëm i qytetarëve, kanë lëvizur brenda komunave, por edhe në komunat tjera. Përtej të dhënave zyrtare të prezantuara nga Agjencia e Regjistrimit Civil, besohet se numri i qytetarëve të cilët kanë migruar brenda komunës apo nga një komunë në komunën tjetër është më i lartë, por të cilët nuk janë përfshirë në të dhënat e prezantuara për shkak të vështirësive, të cilat ndërlidhen kryesisht me mbledhjen e të dhënave, si dhe me përgjegjësitë ligjore të qytetarëve për regjistrimin e ndryshimit të vendbanimit.

Autoritetet kryesore politikëbërëse dhe ligjzbatuese në fushën e migrimit të brendshëm janë: Autoriteti Qeveritar për Migracion (AQM) - Në kuadër të AQM-së funksionon Grupi Tematik për Migrimin e Brendshëm i cili funksionon si mekanizëm mbështetës në ofrimin e ekspertizës profesionale dhe tematike përmes zhvillimit të hulumtimeve, analizave dhe

përgatitjes së rekomandimeve për nivelin strategjik të AQM-së. Në mes tjerash, ky Grup Tematik i cili kryesohet nga përfaqësuesi i ARC-së, ka për detyrë të monitoroj trendin e migrimit të brendshëm (komunë-komunë, rural-urban dhe anasjelltas), të ofroj mbështetje profesionale për ndërlidhjen e sistemit të adresës me atë të gjendjes civile, të zhvillojë hulumtime dhe analiza për faktorët shtytës dhe tërheqës të migrimit të brendshëm, si dhe të hartoj dokumente analitike që ndërlidhen me migrimin e brendshëm.

*Agjencia për Regjistrim Civil (ARC)*¹⁵ - është e themeluar me Ligjin Nr. 04/L-160 për ARC-në. Ky ligj përcakton funksionimin dhe detyrat e ARC-së si mekanizëm qendror në fushën e regjistrimit civil, përgjegjëse për aplikimin, personalizimin dhe lëshimin e dokumenteve për shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit e huaj, administrimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave të regjistrit qendror të gjendjes civile etj. Në kuadër të ARC-së funksionon Drejtoria për Gjendje Civile e cila është përgjegjëse për formimin, përditësimin, kompletimin e regjistrit për vendbanimin dhe vendqëndrimin për qytetarët e Republikës së Kosovës. Ndërsa Inspektorati i ARC-së është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit në fushën e gjendjes civile duke përfshirë vendbanimin dhe vendqëndrimin.

Zyrat e Gjendjes Civile - Zyrat e Gjendjes Civile janë shërbime në kuadër të komunës të cilat kanë për detyrë të përditësojnë regjistrin qendror të gjendjes civile. Zyrat e Gjendjes Civile lëshojnë këto lloje të dokumenteve të gjendjes civile, siç janë: certifikatë lindjeje, ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile, certifikatë shtetësisë, certifikatë martesë, certifikatë vdekjeje, certifikatë e vendbanimit, certifikatë e gjendjes martesore, deklaratë për bashkësinë familjare, procesverbal për pranimin e atësisë/amësisë, leje e varrimit, dëshmi e vdekjes, vërtetim nga arkivi, vërtetim i ç'lajmërimit të vendbanimit.

Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) - është autoriteti qendror për administrimin e sistemit të të dhënave kadastrale, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësor, për sistemin e unifikuar të adresave, për administrimin e infrastrukturës së IT-së respektivisht qendrës së parë dhe të dytë të të dhënave. Si institucion i nivelit qendror, AKK ka përgjegjësi për nxjerrjen e udhëzuesve dhe kornizave të punës lidhur me të gjitha veprimtaritë kadastrale, bën trajnimin dhe certifikimin e zyrtarëve në Zyrat Kadastrale Komunale.


¹⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8653>

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) – është mekanizmi kryesor institucional i cili prodhon statistika zyrtare në Republikën e Kosovës përmes mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të të dhënave. ASK-ja ka përgjegjësi të përgjithshme në prodhimin e statistikave zyrtare sipas Programit për Statistika Zyrtare, duke përfshirë edhe zhvillimin e metodologjisë statistikore, klasifikimin dhe standardet për prodhimin e statistikave zyrtare.

Infrastruktura e teknologjisë informative lidhur me mbledhjen e të dhënave në fushën e migrimit të brendshëm bazohet kryesisht në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile. Ky regjistër përmban të dhënat e qytetarëve përmes të cilit regjistrohen aktet e lindjes, vdekjes, vendbanimit, statusit martesor etj. Aktualisht sistemi nuk mundëson regjistrimin e vendbanimit të qytetarëve duke përdorur të dhënat e regjistrit të adresave dhe regjistrin qendror të gjendjes civile, për shkak se këto dy sisteme nuk janë të ndërlidhura. Në vitin 2022, Agjencia e Regjistrimit Civil në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale kanë nisur një pilot-projekt në dy komuna (Mitrovicë dhe Istog) të Kosovës me qëllim të ndërlidhjes së këtyre dy sistemeve, përmes krijimit të një baze të të dhënave të ndërmjetme me Sistemin Elektronik për Lidhjen e Qytetarit me Adresën SELQA.

Migrimi i brendshëm që bëhet nga një komunë në tjetrën, gjatë periudhës 2018-2022 arrin në shifrën **88,508**, ku në figurën 9, kemi të paraqitura komunat me numrin më të madh të lëvizjeve të qytetarëve. Sa i përket lëvizjes së qytetarëve nga Mitrovica Jugore në Mitrovicën Veriore, ky numër i lartë është si rezultat i përcaktimit të kodit komunal dhe regjistrimit të qytetarëve në përputhje me kodin e përcaktuar dhe jo domosdoshmërisht si rezultat i lëvizjes faktike.

Figura 9. Numri i personave që lëvizin nga komuna në komunën tjetër, 2018-2022



Burimi: ARC

Migrimi i brendshëm që bëhet brenda një komune, gjatë periudhës 2018-2022 arrin në shifrën **70,201**, ku në tabelen 2 kemi të paraqitura komunat me numrin më të madh të lëvizjeve të banorëve, ndërsa sa i përket ndarjes së lëvizjes nga zona qytet-fshat, fshat-qytet, fshat-fshat të dhënat e procesuara nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile, dëshmojnë se ka lëvizje të barazpeshuar, madje në disa raste prin lëvizja e personave nga qyteti në fshat dhe kjo është si rezultat i regjistrimit të gjendjes faktike të adresës, martesave, krijimi i vendbanimeve të reja në zona periferike/rurale të qytetit.

Tabela 2: Numri i personave që kanë lëvizur brenda komunës, Urban-Rural, Rural-Urban, Rural-Rural, 2018 - 2022

Viti	Komuna	2018				2019				2020				2021				2022				
		Total	U-R	R-U	R-R	Total	U-R	R-U	R-R	Total	U-R	R-U	R-R	Total	U-R	R-U	R-R	Total	U-R	R-U	R-R	
	Prizren	5,726	1,276	641	343	292	1,215	590	291	334	875	357	271	247	1,187	472	343	372	1,173	468	347	358
	Gjilan	5,580	1,140	741	308	91	1,199	747	327	125	883	525	264	94	1,226	719	364	143	1,132	616	375	141
	Pejë	5,486	1,085	704	188	193	1,242	885	178	179	839	568	114	157	1,228	791	223	214	1,092	665	228	199
	Ferizaj	4,683	756	295	242	219	1,094	485	369	240	738	299	256	183	960	393	315	252	1,135	431	442	262
	Vushtrri	4,275	579	187	215	177	965	403	341	221	644	234	249	161	994	382	369	243	1,093	432	403	258
	Prishtinë	4,162	806	317	407	82	875	356	417	102	681	338	264	79	864	340	411	113	936	411	426	99
	Lipjan	3,553	625	183	156	286	823	261	262	300	520	153	186	181	790	214	293	283	795	192	328	275
	Podujevë	3,328	628	174	160	294	684	171	184	329	519	134	132	253	798	201	210	387	699	178	210	311
	Mitrovicë	3,075	583	206	290	87	671	254	341	76	464	161	249	54	690	223	363	104	667	227	332	108
	Gjakovë	2,452	531	106	211	214	532	102	207	223	330	70	122	138	533	125	193	215	526	111	208	207
	Viti	2,382	438	165	95	178	473	206	78	189	441	198	83	160	605	278	117	210	425	139	82	204
	Klinë	2,219	464	148	149	167	423	128	148	147	335	89	125	121	527	193	154	180	470	160	150	160
	Malishevë	2,204	421	42	39	340	456	37	29	390	327	28	34	265	499	51	61	387	501	54	46	401

Burimi: ARC

A.1.5. Imigrimi i parregullt

Shtetasit e huaj të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufi

Gjatë periudhës 2018 - 2022, numri i përgjithshëm i personave të cilëve iu është refuzuar hyrja në pikat e kalimit kufitar (PKK) është 22,824. Nga të dhënat në tabelë shohim se viti 2021 dhe 2022 prijnë me numrin më të madh të refuzimit të hyrjeve në pikë kalimet kufitare.

Tabela 3: Numri i refuzim-hyrjeve në Pikë Kalimet Kufitare, 2018-2022

Viti	2018	2019	2020	2021	2022
Numri personave	2,016	3,029	3,082	7,436	7,261

Burimi: Njësia e Analizës së Rrezikut, Inteligjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti i Kufirit - Policia e Kosovës

Nga numri i përgjithshëm i shtetasve të huaj të refuzuar në hyrje të kufirit gjatë periudhës 2018-2022, 88% prej tyre janë nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, duke përfshirë shtetet e rajonit (Ballkanit Perëndimor), 6.1% nga shtetet aziatike dhe 7.4% janë nga shtete të tjera. Arsyet për refuzim të hyrjeve në kufi për shtetasit e vendeve fqinje (Shqipëria, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi), ishte mungesa e dokumenteve të vlefshme ose ndalesat për të hyrë në Republikën e Kosovës, ndërsa për shtetasit e shteteve anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen ishte mungesa e letërnjoftimeve biometrike apo pasaportave. Shtetasve të shteteve aziatike dhe afrikane u është refuzuar hyrja për shkak të mungesës së vizës, mjeteve të pamjaftueshme financiare, mosjustifikimi i qëllimit dhe kushteve të qëndrimit. Për dallim nga vitet e tjera, në vitet 2020 dhe 2021, arsyet më të shpeshta të refuzimit në hyrje për shtetasit nga vendet evropiane ishte mungesa e testeve apo dëshmia/certifikatat e vaksinës kundër Covid.


Kalimi i paautorizuar i kufirit

Gjatë periudhës 2018 - 2022, numri i imigrantëve të parregullt që kanë kaluar kufirin dhe kanë hyrë në territorin e Republikës së Kosovës në mënyrë të paautorizuar, ka qenë 7,440. Për më shumë info shih tabelën 26, në aneks.

Në vitin 2022, gjithsejt 939 migrantë, 602 (64%) kanë hyrë nga Shqipëria, 252 (27%) kanë hyrë nga Maqedonia e Veriut, 58 (6%) kanë hyrë nga Serbia, 24 (3%) përmes Aeroportit dhe 3 (0.3%) nga Mali i Zi. Prej numrit të përgjithshëm, 40 migrantë (16 Turqi, 13 Afganistan, 5

Ukrainë, 3 Afrika e Jugut, 3 Jordani) kanë hyrë në mënyrë të rregullt, 48 (20 Afganistan, 9 Siri, 5 Indi, 5 Marok, 4 Bangladesh, 4 Palestinë dhe 1 Irak) janë zbuluar duke tentuar të futen si klandestinë përmes pikë kalimit kufitar dhe 851 tjerë kanë hyrë në Kosovë në mënyrë të paautorizuar përmes vijës së gjelbër të kufirit.


Figura 10. Numri i imigrantëve që kanë hyrë në Kosovë në mënyrë të paautorizuar, 2018-2022



Burimi: Njësia e Analizës së Rrezikut, Inteligjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti i Kufirit – Policia e Kosovës

Rastet e trajtuara tregojnë se imigrantët e parregullt kanë lëvizur në grupe të vogla. Rrugëtimi i tyre kryesisht fillon nga Turqia, vazhdojnë nëpër Greqi e më pastaj të ndihmuar nga kontrabandistët, të cilët në territorin e Republikës së Kosovës i fusin përmes kufirit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Republika e Kosovës kryesisht konsiderohet si vend transit nga imigrantët e parregullt dhe nuk është shtet i destinimit përfundimtar, pasi që ata synim kryesor kanë migrimin në shtetet e BE-së.

Figura 11. Imigrantët që kanë hyrë në Kosovë në mënyrë të paautorizuar sipas grupmoshës, e paraqitur në përqindje 2018-2022



Burimi: Njësia e Analizës së Rrezikut, Inteligjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti i Kufirit – Policia e Kosovës.


Policia Kufitare, gjatë viteve 2018 - 2022, ka evidentuar dhe proceduar për veprë penale të kalimit të paautorizuar të kufirit apo vijës kufitare 885 raste, ndërsa janë arrestuar 960 persona të dyshuar për kryerje të kësaj vepre penale. Bazuar në statistikat e Policisë Kufitare, numri më i madh i personave të dyshuar për kalim të paautorizuar të kufirit, është nga shtetasit e Kosovës me gjithsejtë 331 persona apo 34.5%, pastaj të atyre nga Serbia me 325 persona apo 33.9%, pasohen nga Shqipëria me 202 persona apo 21%, nga Maqedonia e Veriut me 51 persona apo 5.3% dhe nga vendet e tjera me 51 persona apo 5.3%.

Shtetasit e huaj me qëndrim të paligjshëm të urdhëruar të largohen vullnetarisht, përfshirë edhe statistikat për kthim të asistuar vullnetar sipas marrëveshjes me IOM-in

Institucionet përgjegjëse për kthim janë Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion dhe Policia e Republikës së Kosovës. Kthimi është proces i migrimit të parregullt dhe të paautorizuar në një shtet dhe i cili i nënshtrohet procesit të kthimit drejt vendit tij të origjinës apo prejardhjes. Ky proces ka karakter ndërkombëtar dhe historikisht është zhvilluar me veprime ndërshtetërore por edhe me ndërmjetësimin e organizatave ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Republika e Kosovës ballafaqohet me vështirësi në kthimin e migrantëve në vendet e tyre të origjinës për shkak të mungesës së marrëdhënieve diplomatike me shtete të cilat ende nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës.

Qendra e Pritjes së Përkohshme është themeluar më Vendim të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Nr. 0490/2022, të datës 24.06.2022. Arsyet e themelimit të kësaj qendre janë si nevojë për profilizimin dhe referimin e migrantëve të parregullt. Kjo qendër është përgjegjëse për pritjen, akomodimin, identifikimin dhe vlerësimin e nevojave të migrantëve të cenusëshëm, si dhe të viktimave të mundshme të trafikimit më qenie njerëzore dhe të miturve të pashoqëruar. Gjatë vitit 2022, që nga Themelimi i Qendrës së Pritjes të Përkohshme për Migrantë janë pritur dhe akomoduar 363 migrantë.

Figura 12. Numri i të akomoduarve në Qendrën e Pritjes së Përkohshme



Burimi: QPPM/DSHAM

Sa i përket vendeve të origjinës, numri më i lartë i migrantëve ishte nga: Siria me 188 (52%), Maroko 77 (21.2%), Palestina me 36 (10%), Afganistani, 24 (6.6%), Algjeria 10 (2.7%) dhe shtete tjera 28 (8%).

Vendimet për largim vullnetar - Gjatë periudhës 2018-2022, janë lëshuar 879 vendime për largim vullnetar nga territori i Republikës së Kosovës. Nga të dhënat e paraqitura vërehet se viti 2019 karakterizohet me numrin më të madh të vendimeve për largim vullnetar. Arsyet pse viti 2019, shënon numrin më të madh të shtetasve të huaj ndaj të cilëve është nxjerrë vendim për largim vullnetar qëndron në atë se, asokohe në qytetet e Kosovës si: Pejë, Ferizaj etj. shtetas të Republikës së Shqipërisë kishin ngritur vendbanime joformale. Të njëjtit kryesisht merreshin me kërkim lëmoshe dhe mbledhje të mbeturinave të hekurit. Të njëjtit nuk kishin filluar asnjë procedurë për rregullimin e lejeqëndrimit në Kosovë dhe për këtë autoritetet vendore kanë nxjerrë vendim për largimin e tyre vullnetar dhe kthimin në vendin e origjinës.

Në figurën 13, është paraqitur numri i vendimeve për largim vullnetar gjatë periudhës 2018-2022. Numri më i lartë, sipas shteteve ishin për shtetasit e Shqipërisë me 391 vendime, Turqisë 136, Bangladesh 68, Serbisë 53, Maqedonisë së Veriut 16, Indi 8, Afrikë e Jugut 5 vendime dhe 202 vendime ishin për shtetasit e shteteve tjera. Arsytet e lëshimit të vendimeve për largim vullnetar për të huajt me qëndrim të parregullt në Republikën e Kosovës ishin mungesa e lejes së vlefshme të qëndrimit, anulimi ose revokimi i lejes së qëndrimit, ose janë zënë duke punuar në kundërshtim me dispozitat e parapara me Ligjin për të Huajt ose me ligjet e tjera në fuqi.

Kthimi i asistuar vullnetar përmes IOM- gjatë periudhës 2018-2022, janë kthyer 40 persona të asistuar vullnetarisht nga territori i Republikës së Kosovës. Nga të dhënat e paraqitura në figurën 13, vërejmë se viti 2021 dhe 2022 karakterizohet me numrin më të madh të kthimit vullnetar të asistuar. Kjo vjen si rezultat i gatishmërisë së institucioneve për ta fuqizuar mekanizmin e kthimit vullnetar përmes marrëveshjes së nënshkruar në mes të MPB-së dhe IOM në Maj të vitit 2019, për kthim të asistuar vullnetar dhe riintegrim.¹⁶

Numri më i madh i vendimeve për largim vullnetar, gjatë periudhës 2018-2022, sipas shteteve ishin për shtetasit e Nepalit me 9 vendime , Jordanisë 8, Maroko 5 , Algjeri 3 dhe për shtetasit e vendeve tjera ishin 15 vendime.

Largimet me forcë - Gjatë periudhës 2018-2022 , janë ekzekutuar 550 largime me forcë nga territori i Republikës së Kosovës. Nga të dhënat e paraqitura në figurën 13, vërejmë se viti 2018 karakterizohet me numrin më të madh të largimeve me forcë. Numri më i madh i largimeve me forcë gjatë periudhës 2018-2022, sipas shtetësisë ishin 80% të Shqipërisë, Serbisë 9% dhe të vendeve tjera 11%.


Vlerësojmë se, rënia e numrit të vendimeve për largim me forcë, ka rënë nga viti në vit për shkak se është shtuar kontrolli për të huajt përmes inspektimeve. Po ashtu, rritja e numrit të kërkesave për rregullimin e statusit të qëndrimit në Kosovë nga shtetasit e huaj, ka ndikuar në rënien e vendimeve për largim me forcë. Të gjithë të huajt të cilët tanimë dëshirojnë të jetojnë dhe veprojnë në Kosovë për një kohë më të gjatë, aplikojnë për pajisje me lejeqëndrim të përkohshëm.

¹⁶ Marrëveshja e nënshkruar në mes të MPB-së dhe IOM, në Maj të vitit 2019

Dëbimi me vendim gjykatë - Drejtoria për Migrim dhe të Huaj me vendim të gjykatave të Kosovës dhe duke u bazuar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, ka dëbuar nga Republika e Kosovës 137 persona gjatë periudhës 2018-2022. Nga të dhënat e paraqitura në figurën 13, vërehet se viti 2022 karakterizohet me rënie të vogël krahasuar me vitet tjera. Nga këto dëbime gjatë periudhës 2018-2022, sipas shtetësië 64 persona ishin nga Shqipëria, 31 nga Serbia, 16 nga Turqia, 4 nga Maqedonia e Veriut, 3 nga Jemeni, 3 nga India dhe 16 nga vendet tjera. Dëbimet me vendime të gjykatave, nxjerrën si masa plotësuese nga vetë gjykatat vendore, ndërsa DMH-ja vetëm ekzekuton këto vendime.

Në figurën 13, është paraqitur numri i shtetasve të huaj me qëndrim të paligjshëm të urdhëruar të largohen në vend të origjinës vullnetarisht, të asistuar nga IOM, me forcë dhe me vendim gjykatë.

Figura 13. Numri i vendimeve për largim vullnetarë, vullnetarë IOM, me forcë dhe me vendim gjykatë, 2018-2022



Burimi: Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti i Kufirit dhe Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar, Policia e Kosovës

Qendra Mbjajtjes për të Huaj është përgjegjëse për të huajt e parregullt të cilët janë gjendur në Kosovë dhe të cilët janë vendosur në këtë qendër deri në kthimin në vendin e tyre të origjinës ose të prejardhjes. Kjo Qendër është përgjegjëse për regjistrimin e të huajve që i plotësojnë kushtet për kthim, bën akomodimin e të huajve, përkujdeset për kushtet dhe mirëqenien e të huajve sipas legjislacionit në fuqi (ku përfshihen kushtet e banimit dhe pako higjienike, ushqimore, shërbime mjekësore dhe psikologjike), vendos rregulla për sjelljen e të huajve

brenda Qendrës, koordinohet me Divizionin për Ripranim dhe Kthim, lidhur me kthimin e të huajve në vendin e origjinës, përkujdeset për sigurinë e të huajve në Qendër në bashkëpunim me policinë, bashkëpunon me Policinë e Kosovës, Drejtorinë për Migrim dhe të Huaj për kthimin e të huajve në vendin e origjinës apo në vendin e tretë, përkujdeset që të huajt t'i njoftoj me të drejtat dhe detyrat e tyre, përkujdeset për sigurimin e ndihmës juridike për të huajt e akomoduar etj.

Situata me pandeminë Covid -19, gjatë vitit 2020 në shtetet anëtare të BE dhe në rajon¹⁷ edhe për më tepër ka rënduar procesin e kthimit, pasi numri i migrantvë të parregullt të gjetur në vend, rajon dhe më gjerë ka qenë i lartë dhe procesi i kthimit ishte prolonguar, për shkak të masave kufizuese të rekomanduara nga OBSH, si dhe vendimeve e qeverive përkatëse.

Gjatë periudhës 2018-2022 në Qendrën për Mbajtjen e të Huajve kanë qenë të akomoduar 144 shtetas të huaj, prej tyre meshkuj 96 (66.7%) dhe femra 48 (33.3%). Ndërsa sipas grupmoshës numri më i madh i të huajve në këtë Qendër i përket grupmoshës 18-34 me 128 (89%), e pasuar nga grupmosha 35-64 me 8 (5.6%), kurse grupmoshat tjera me një numër shumë të vogël.

Shteti që prin për nga numri migrantëve në këtë Qendër është Shqipëria me 26.4%, Turqia me 9.7%, Maroko me 9%, Nepali 8.3%, Libia me 6.25% dhe shtete tjera 40.3%. *Për më shumë, shih tabelën 27, në aneks.*

Luftimi i kontrabandimit me migrantë

Policia e Kosovës ka vazhduar kontrollet sistematike dhe të hollësishme në të gjitha pikat e kalimit kufitar dhe përgjatë vijës së gjelbër të kufirit, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të kontrabandimit me migrantë. Po ashtu, janë luftuar edhe grupet e organizuara kriminale brenda territorit të Republikës së Kosovës të cilët janë marrë me kontrabandë me migrantë.

Tabela 4: Numri i rasteve të iniciuara të kontrabandës me migrantë, 2018-2022

Vitet	2018	2019	2020	2021	2022	Gjithsej
Rastet e iniciuara të kontrabandës	8	24	25	30	37	124

¹⁷ Konferenca e Migrimit Vjenë, 16-19 Nëntor 2020- Schengen, asylum reform and Europe's migration diplomacy: Has COVID-19 changed everything, Në këtë konferencë pjesëmarrësit raportuan për një numër të shtuar të migrantve të parregullt të cilët ishin subjekt i kthimit.

Në periudhën kohore 2018 – 2022, numri i rasteve të iniciuara për veprën penale të kontrabandimit me migrantë nga Policia e Kosovës ishte 124. Sipas të dhënave të paraqitura në tabelën 4, vërehet se gjatë vitit 2022, janë zbuluar më së shumti raste të kësaj natyre me gjithsejt 37 raste. Rastet e kësaj natyre kanë qenë në vazhdimësi në rritje si rezultat i disa faktorëve në radhë të parë fuqizimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, shkëmbimit të informatave, bashkëpunimit ndër-institucional me agjencione tjera të zbatimit të ligjit, shtimit të patrullimeve në vijën e gjelbër të kufirit etj.

Tabela 5: Numri i të dyshuarit për kontrabandë me migrantë sipas shteteve, 2018-2022

Shtetësia	2018	2019	2020	2021	2022
KOSOVË	12	24	27	52	49
SHQIPËRI	5	3	4	1	3
SERBI	2	1	2	2	0
TURQI	1	1	1	1	3
MAQEDONI E V.	0	3	0	3	3
SIRIA	0	2	0	1	6
IRAK	0	1	0	1	0
ALGJERI	0	0	0	2	0
PALESTINË	0	0	0	2	0
LIBAN	0	0	0	1	0
JORDANI	0	0	0	1	0
AFGANISTAN	0	0	0	0	1
Gjithsej	20	35	34	67	65

Numri i personave të dyshuar të kontrabandimit me migrantë të identifikuar dhe të arrestuar nga organet e rendit gjatë viteve 2018-2022, është gjithsejt 221 persona. Nga gjithsejt 221 persona të identifikuar, 164 prej tyre ishin shtetas të Republikës së Kosovës, 25 ishin shtetas të vendeve aziatike, 16 shtetas të Shqipërisë, 9 shtetas të Maqedonisë së Veriut, dhe 7 nga Serbia.

Tabela 6: Numri i viktimave të evidentuara të kontrabandimit me migrantë sipas shtetësisë 2022¹⁸

SHTETET	Nr. i viktimave të evidentuara
SIRI	226
AFGANISTAN	34
KOSOVË	18 ¹⁹
EGJIPT	15
BANGLADESH	11
IRAK	9
JEMEN	6
SUDAN	6
PALESTINË	5
IRAN	4
ALGJERI	2
MAROK	2
BOSNJA DHE HERCEGOVINA	1
Gjithsej	339

Burimi: Njësia e Analizës së Riskut, Inteligjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti i Kufirit dhe Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar, Policia e Kosovës

Trafikimi me qenie njerëzore

Të dhënat tregojnë se gjatë viteve 2018-2022 janë identifikuar 11 viktime të trafikimit (e huaj).

Të gjitha viktimave u janë ofruar shërbimet, siç parashihen në PSO për Viktima të Trafikimit.

Tabela 7: Numri i viktimave të trafikimit sipas shtetësisë, 2018-2022

Viktima të trafikimit të identifikuar/origjina	2018	2019	2020	2021	2022
SHQIPËRIA	2	1	0	1	1
REPUBLIKA ÇEKE	1	0	0	0	0

¹⁸ Të dhënat për këtë kategori kanë filluar të gjenerohen nga viti 2022

¹⁹ Ky numër i referohet viktimave të kontrabandimit nga Kosova me destinacion vendet evropiane

MALI I ZI	0	2	0	0	0
SERBIA	0	2	0	0	1
Gjithsej	3	5	0	1	2

Burimi: Drejtoria për Hetimin e Trafikimin me Njerëz, Policia e Kosovës

A.1.6. Mbrojtja ndërkombëtare

Divizioni për Azil /DSHAM, është autoriteti përgjegjës për zhvillimin e procedurës së azilit. Procedura e azilit në Kosovë është rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-217 për Azil, i cili rregullon kushtet dhe procedurat për njohjen e statusit të refugjatit, mbrojtjes plotësuese, mbrojtjes së përkohshme, statusin, të drejtat dhe detyrimet e azilkërkuesve, personave me status refugjati, si dhe personave të cilëve iu është lejuar mbrojtja plotësuese dhe mbrojtja e përkohshme.


Komisioni Kombëtar për Refugjatë (KKR) është organ kompetent në shkallë të dytë për shqyrtimin e ankesave të drejtuara kundër vendimeve të shkallës së parë. Policia Kufitare është përgjegjëse për procedurën fillestare, e cila përfshin parashtrimin e aplikacioneve, intervistën fillestare, marrjen e shenjave të gishtërinjve dhe fotografive dhe transferimin e aplikuesve në Qendrën për Azil. Qendra për Azil është përgjegjëse: për pranimin, regjistrimin, akomodimin dhe pajisjen e aplikuesve me dokumente personale përgjatë procedurës së kërkimit të azilit.

Në Republikën e Kosovës gjatë periudhës kohore 2018 - 2022 janë regjistruar 5,216 aplikues për mbrojtje ndërkombëtare, shumica e tyre nga shtetet e Lindjes së Mesme dhe shtetet nga Afrika Veriore. Gjinia mashkullore prin me 4,545 (87%) përderisa gjinia femërore përfaqësohet me 671 (13%).

Grupmosha më e përfaqësuar në mesin e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare ishte 18-34 me 3,676 (70.4%) persona, grupmosha 35-64 me 728 (14%) persona, grupmosha 6-13 me 374 (7.2%) persona, grupmosha 14-17 me 242 (4.6%) persona, grupmosha 0-5 me 185 (3.5%) dhe grupmosha 65+ me 11 (0.2%) persona. Vërehet ngritja e konsiderueshme e numrit të aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare në grupmoshën 0-13 vjeç që ishte 559 fëmijë, gjë që mundëson konstatimin se kjo grupmoshë lëviz me familjet e tyre për tu larguar nga zonat e konfliktit dhe të pasigurta (si nga Siria, Iraku, Afganistani etj). Nga numri i përgjithshëm i kësaj kategorie 133 (2.5%) ishin të mitur të pashoqëruar.

Vendet kryesore të origjinës së azilkërkuesve janë: Siri 2,153 (41.2%), Irak 742 (14.2%), Maroko 704 (13.4%), Palestinë 322 (6.2%), Algjeri 319 (6.1%), kurse shtetet tjera janë përfaqësuar me 976 (18.7%) azilkërkues. Për më shumë informata lidhur me të gjitha shtetet, shih tabelen 28, përkatëse në aneks.

Figura 14. Azilkërkuesit në Republikën e Kosovës sipas grupmoshës, 2018-2022



Burimi: DSHAM/MPB

Trendet tregojnë se lëvizjet e migrantëve drejt shteteve perëndimore dhe rrugëtimi i tyre nga vendet e origjinës nëpër 'Rrugën Ballkanike' ka ndryshuar, gjë që reflektohet në numrin e azilkërkuesve në Republikën e Kosovës, numër i cili është dukshëm më i vogël në vitet 2021 dhe 2022 krahasuar me dy vitet paraprake.

Në tabelën e mëposhtme është i paraqitur numri i vendimeve sipas llojit të statusit dhe në bazë të të dhënave del se stoku më i madh i kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare rezulton në ndërprerje të procedurës, sepse aplikuesit për mbrojtje ndërkombëtare e lëshojnë territorin e Republikës së Kosovës, derisa janë ende në procedurë të shqyrtimit të aplikacionit për mbrojtje ndërkombëtare. Sipas praktikës së kaluar ende Kosova shfrytëzohet si vend transit për azilkërkues, njëkohësisht edhe për trafikantët si mundësi për të kaluar nga vendet aziatike në shtetet e Evropës Perëndimore.

Tabela 8: Numri i vendimeve sipas statusit 2018-2022


Lloji i vendimeve	Nr.	%
Ndërprerje e procedurës	4,726	91.5
Ndërprerje vullnetare	189	3.6

Status refugjati	121	2.3
Revokim i statusit të refugjatit	1	0.01
Mbrojtje plotësuese	25	0.4
Mbrojtje e përkohshme	14	0.3
Refuzim kërkesë	38	0.7
Refuzim sipas procedurës së përsheptuar	22	0.4
Vendim negativ	8	0.1
Në pritje të vendimit	19	0.4
Gjithsej	5,163	100

Burimi: DSHAM/MPB

Të dhënat e paraqitura në figurën 15, tregojnë se numri më i madh i të huajve që kanë shprehur qëllim për mbrojtje ndërkombëtare është në vitin 2020 nga shtetasit Sirian, pasuar nga Marokienët, Libianet etj. Gjatë këtij viti ka hyrë në fuqi edhe Vendimi²⁰ për 72 orëshin, ndërsa që nga hapja e Qendrës për Pritjen e Përkohshme për Migrantë ky vendim nuk aplikohet. Në aneks është paraqitur tabela, duke përfshirë të gjitha shtetet sa i përket 72 orëshit. Për më shumë info, shih tabelen 29 në aneks.

Figura 15. Të huajt që kanë shprehur qëllim për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare (72 orëshi) 2020-2022



Burimi: DSHAM/MPB

²⁰ Vendimi me Nr. 031/2020, më datë: 29.01.2020

A.2. EMIGRIMI

Me emigrim kuptojmë lëvizjen e popullsisë nga vendi i origjinës apo të prejardhjes drejt vendeve të tjera për qëllime pune, bashkim familjar, studime etj. Kjo lëvizje e popullsisë bëhet në formë të rregullt dhe të parregullt. Duke iu referuar periudhës raportuese, kemi një trend në rritje të emigrimit të rregullt në veçanti për qëllime pune, si rezultat i ndryshimit të politikave të migrimit në shtetet evropiane, sidomos për shtetasit e vendete të Ballkanit Perëndimor. Stoku më i lartë i migrantëve të punës është në Gjermani ^[1] e cila përmes politikave dhe legjislacionit nacional ka ndryshur hartën e emigrimit të rregullt.

A.2.1. Kërkesat për vizë nga shtetasit e Republikës së Kosovës


Edhe përgjatë periudhës referuese 2018 – 2022, Republika e Kosovës ka vazhduar të mbetet i vetmi vend në rajonin e Ballkanit Perëndimor për të cilin aplikohet regjimi i vizave në zonën Schengen. Si rezultat i këtij fakti, shtetasit e Republikës së Kosovës përgjatë kësaj periudhe aplikuan për viza Schengen në misionet diplomatike/konsullore të shteteve respektive të BE-së dhe zonës Schengen të akredituara në Republikën e Kosovës dhe vendet e rajonit. Gjatë viteve 2020 dhe 2021, pandemia e COVID-19, ka pasur ndikim të prekshëm përsa i përket uljes së lëvizshmërisë nga shtetasit kosovarë drejtë shteteve të BE-së dhe zonës Schengen çka vërehet edhe nga figura 16.

Gjatë periudhës referente janë regjistruar gjithsej 392.291 kërkesa për viza Schengen nga shtetasit kosovarë në misionet diplomatike dhe konsullore të shteteve anëtare të BE-së dhe në zonën Schengen të akredituara në Republikën e Kosovës dhe vendet e rajonit. Krahasuar me periudhën e mëparshme, është shënuar një rritje prej rreth 16.2%. Nga numri i përgjithshëm i kërkesave për viza Schengen, 84% (327,777) janë lëshuar viza, ndërsa 16% (64,514) janë refuzuar.²¹

^[1] https://www.institutigap.org/documents/82484_emigrimi_gjermani_.pdf

²¹ <https://statistics.schengenvisainfo.com/>, 16.10.2023


Figura 16. Kërkesat dhe vizat Schengen të lëshuara për shtetasit kosovarë, 2018 – 2022



Burimi: Statistikat e vizave Schengen

Gjatë kësaj periudhe mund të veçojmë dy vite më të theksuara të rënies së numrit të kërkesave për vizë Schengen nga shtetasit kosovarë, në vitin 2020, numri i kërkesave për vizën Schengen pati rënie për trefishin, krahasuar me vitin 2019, kurse viti 2021, pati rënie prej rreth -143%, krahasuar me vitin e njëjtë. Kjo i referohet pandemisë COVID-19 dhe kufizimeve të udhëtimit ndërkombëtar. Vendet që shtetasit kosovarë kanë vizituar më shpesh në vitet 2018 – 2022, ishin Gjermania dhe Zvicra të cilat përbënin 77% e të gjitha vizave të lëshuara ndërsa shtetet tjera, si Greqia kishte 9% të vizave të lëshuara, Italia dhe Sllovenia kishin nga 4% etj.

Figura 17. Numri i kërkesave, viza të lëshuara dhe të refuzuara sipas shteteve, 2018-2022



Burimi: Statistikat e vizave Schengen

A.2.2. Lejeqëndrimet e lëshuara për shtetasit e Republikës së Kosovës

Analiza e emigrimit të rregullt të shtetasve të Republikës së Kosovës në shtetet anëtare të BE-së dhe në zonën Schengen është fokusuar kryesisht në përmbledhjen e të dhënave të gjendjes së lejeqëndrimit të parë gjatë periudhës 2018-2022. Janë analizuar aspekte të ndryshme, si arsytet e dhënies së lejeve, kohëzgjatja e lejeve dhe vendet e destinacionit. Të dhënat nga viti 2020 përjashtojnë informacionin për Mbretërinë e Bashkuar.

Gjatë periudhës 2018 - 2022, vendet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen kanë lëshuar 158,546 lejeqëndrime për herë të parë²², për shtetasit kosovarë. Kjo paraqet një rritje prej 38.3% (114,597) krahasuar me periudhën paraardhëse pesëvjeçare. *Për më shumë info, shih tabelën 30, në aneks.*


Numri i lejeqëndrimeve të lëshuara për herë të parë për shtetasit kosovarë nga autoritetet e shteteve anëtare të BE-së dhe në zonën Schengen, ka pasur një trend rritës që nga viti 2014 për të arritur kulmin në vitin 2019 me rreth 45,670 lejeqëndrime të para dhe më pas pësoi rënie prej - 55% deri në vitin 2022 (20,514), krahasuar me vitin 2019.

Rritja e numrit të lejeqëndrimit për herë të parë të lëshuara për shtetasit kosovarë, vjen si rezultat i rritjes së numrit të lejeqëndrimit të parë për arsye punësimi, i cili pothuajse u trefishua në krahasim me pesëvjeçarin e kaluar. Kështu, për herë të parë që nga viti 2009, në vitin 2021, lejeqëndrimi për herë të parë për qëllime punësimi e kalon për rreth 10% numrin e lejeqëndrimeve për herë të parë për bashkim familjar (Figura 18). Reduktimi i numrit të lejeqëndrimeve të lëshuara pas vitit 2019, mund të ketë ardhur si shkak i situatës pandemike me COVID-19 (kufizimet e udhëtimit dhe forma të tjera administrative, të vendosura nga qeveritë e vendeve anëtare të BE-së dhe zonave Schengen).

²² **Lejeqëndrimi** është çdo autorizim i vlefshëm për të paktën 3 muaj i lëshuar nga autoritetet e një shteti anëtar të BE-së, që lejton një shtetas të një vendi të tretë të qëndrojë ligjërisht në territorin e tij. **Leja e parë e qëndrimit** është një leje që i jepet një personi për herë të parë. Leja e qëndrimit konsiderohet si **leje e parë** edhe nëse intervali kohor ndërmjet skadimit të lejes së vjetër dhe fillimit të vlefshmërisë së lejes së **parë** është të paktën 6 muaj, pavarësisht nga viti i lëshimit të lejes. Konventa e lejes së re lidhet me lejet e lëshuara në të gjitha nivelet e shkallës administrative/gjyqësore (p.sh.: shkalla e parë, apelimi, etj.) dhe nga të gjitha autoritetet kombëtare.

²³ https://ec.europa.eu/eurostat/databroeser/vieë/MIGR_RESVALID_custom_7494163/default/table?lang=en, Përditësimi i fundit: 11/09/2023 23:00

Figura 18. Numri i lejeqëndrimit të parë lëshuar për shtetasit kosovarë dhe shpërndarja e tyre sipas arsyes në shtetet anëtare të BE-së dhe në zonën Schengen, 2018-2022




Burimi: Eurostat

Shumica e lejeqëndrimeve të para të lëshuara për shtetasit kosovarë gjatë periudhës referuese, kishin të bënin me bashkimin familjarë 46% dhe qëllime punësimi 36%, ndërsa lejet e para të qëndrimit të klasifikuara “arsye të tjera” 16% dhe arsyet arsimore 2% i përcillnin rrjedhat e emigrimit me oscilime, ngritje dhe rënie të moderuara ndër vite.

Nga numri i përgjithshëm i lejeqëndrimeve të para të lëshuara sipas kohëzgjatjes për periudhën e referencës, është evidente ngase më shumë se gjysma apo rreth 64%, janë lëshuar për një periudhë 12 mujore e më shumë, 29% për një periudhë nga 6 deri në 11 mujore, dhe 7% për një periudhë prej 3 deri në 5 muaj. Rreth dy të tretat e shtetasve kosovarë që kanë leje të parë të qëndrimit të vlefshëm në vendet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen qëndrojnë në Gjermani, Slloveni dhe Kroaci.

Figura 19. Shpërndarja në përqindje e lejeve të qëndrimit për herë të parë të lëshuara nga autoritetet e vendeve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, sipas pesë vendeve kryesore, 2018 – 2022



Burimi: Eurostat


Shumica e shtetasve kosovarë që kanë lejeqëndrimi të lëshuara për qëllime punësimi për periudhën referuese, qëndrojnë në Slloveni 36%, Kroaci 27% dhe Gjermani 19%, ndërsa mbajtësit e lejeve të qëndrimit për qëllim të bashkimit familjar qëndrojnë në Gjermani 42.4%, Zvicër 11.5%, dhe Itali 11%. Lidhur me qëllimet arsimore – shumica e shtetasve kosovarë studiojnë në Gjermani 25%, Austri 12% dhe Hungari 10%.

A.2.3. Lirimi i shtetësisë së Republikës së Kosovës

Gjatë periudhës 2018-2022, nga shtetësia e Republikës së Kosovës janë liruar 24,218 persona, kurse 368 janë refuzuar për mosplotësimin e kriterëve ligjore. Gjatë periudhës 2018-2022, personat të cilët janë liruar nga shtetësia e Republikës së Kosovës, të ndarë sipas shteteve janë nga Gjermania 20,915 (86.4%), nga Austria 2,342 (9.67%), nga Sllovenia 366 (1.5%), nga Kroacia 155 (0.6%), nga Mali i Zi 126 (0.5%) dhe 314 (1.3%) nga shtetet e tjera. *Për më shumë info, shih tabelën 33 në ankes.*

Ndërsa sa i përket grupmoshës numri më i madh i të liruarve i përkasin grupmoshës 18-34 me 12,646 (52.2%), 35-64 me 6,706 (27.7%), 14-17 me 2,618 (10.8%), 6-13 me 1,424 (5.87%), 0-5 me 766 (3.16%), mbi 65 vjeç me 58 (0.23%).

Figura 20. Numri i personave që janë liruar nga shtetësia e Republikës së Kosovës, 2018-2022



Burimi: DSHAM

Gjatë periudhës 2018-2022, trendet e lirimit nga shtetësia e Republikës së Kosovës janë pothuajse lineare, përjashtuar vitin 2020, ku për shkak të pandemisë edhe trendi i lirimit nga shtetësia e Republikës së Kosovës kishte rënie. Nga 24,218 persona, të liruar nga shtetësia, ku prin gjinia 12,426 (51.3%) ishin të gjinisë mashkullore, ndërsa 11,792 (48.7%) të gjinisë femërore.

A.2.4. Emigrimi i parregullt

Emigrimi i parregullt i referohet lëvizjeve të individëve ose grupeve që largohen nga vendi i tyre për t'u vendosur në një vend tjetër, jashtë normave rregullative të vendeve dërguese, të transitit dhe vendeve pritëse²⁴. Emigrimi i parregullt është një çështje komplekse që paraqet sfida si për migrantët, vendet e origjinës dhe vendet e destinimit. Këto sfida lidhen kryesisht me sigurinë kufitare, rendin publik, dinamikën e tregut të punës, kohezionin social dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve.


Kjo pjesë ofron të dhëna dhe statistika për shtetasit kosovarë: të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufijtë e shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, të cilët u gjenden me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, të urdhëruar të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen dhe të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen në bazë të urdhrit për largim.

²⁴ E Drejta Migratore Ndërkombëtare, Fjalorth i Terminologjisë Migratore, fq. 38 (IOM)

Në periudhën 2018 – 2022, rreth 7,820 e shtetasve kosovarë, iu është refuzuar hyrja në kufijtë e shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, rreth 25,285 shtetas kosovarë janë gjetur në mënyrë të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, rreth 24,305 shtetas të Republikës së Kosovës u urdhëruan të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen dhe rreth 9,310 shtetas kosovarë u larguan nga territoret e shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, pas një urdhri për t'u larguar.

Figura 21, ofron një pasqyrë në bazë të dhënave të raportuara për emigrimin e parregullt të shtetasve kosovarë të cilët ishin subjekt i autoriteteve të zbatimit të Ligjit të Imigrimit në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen.

Figura 21. Shtetasit kosovarë, subjekt i autoriteteve të zbatimit të Ligjit të Imigrimit në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen, 2018 – 2022



Burimi: Eurostat

Shtetasit kosovarë të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufi ose të zënë në kufi në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen

Të dhënat e regjistruara për periudhën 2018 – 2022, tregojnë se rreth 7,820 shtetasve kosovarë iu është refuzuar hyrja²⁵ në kufijtë e shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen²⁶. Për

²⁵ Çdo person llogaritet vetëm një herë brenda periudhës së referencës, pavarësisht nga numri i refuzimeve të dhëna për të njëjtin person.

shtetasit kosovarë të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufijtë e shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, gjatë periudhës 2018 - 2022, mund të veçojmë dy vitet e fundit si më të theksuara me trend rritjeje, vitin 2022 (rritje prej rreth 8.8%, krahasuar me vitin 2021), dhe vitin 2021 (rritje prej rreth 36.2%, krahasuar me vitin 2020). Arsyeja e rritjes në vitin 2021, mund të ndërlidhet me masat kufizuese të udhëtimit në kufijtë e shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen (shkak situata pandemike me Covid-19).

Më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të refuzimeve u regjistruan në dy shtete të BE-së, Kroaci 2,585 (33%) dhe Slloveni 1,600 (20%), kurse pjesën tjetër të shteteve e përbënin Hungaria 1,240 (16%), Franca 745 (10%), Gjermania 400 (5%), dhe shtetet tjera 1,250 (16%). *Për më shumë info, shih tabelën 33 në ankes.*

Sllovenia, kishte rritjen më të madhe të refuzimeve të hyrjes për rreth dyfishit (173%), krahasuar me periudhën e kaluar. Refuzimet e hyrjes të shtetasve kosovarë në kufijtë e shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, kryesisht ishin në kufijtë tokësor të cilat përbënin 81%, të numrit të përgjithshëm, ndërsa në kufijtë ajror ishte 16%, ndërsa vetëm një pjesë e vogël 3% e refuzimeve ishte në kufijtë detarë. Duke i krahasuar të dy periudhat për refuzimet e hyrjes në kufijtë shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen të dhënat ishin të ngjashme.

Në krahasim me periudhën e kaluar të dhënat nga Figura 22, tregojnë se refuzimet për arsye të mungesës së vizës apo lejes së qëndrimit të vlefshëm, u rriten për 22%, arsyeja e mungesës së dokumentit të vlefshme udhëtimi u zvoglua për -25%.

²⁶ Personat të cilëve u refuzohet hyrja në kufirin e jashtëm të BE-së për shkak se nuk përmbushin të gjitha kushtet e hyrjes të përcaktuara në nenin 6 (1) të Kodit të Kufijve të Schengenit dhe nuk i përkasin asnjë prej kategorive të njerëzve të përmendur në nenin 6 (5.) të kësaj Rregulloreje.

Figura 22. Refuzimi i hyrjes në kufijtë e jashtëm të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, të shtetasve kosovarë, sipas arsyes, krahasim i periudhës 2018-2022 me periudhën e kaluar



Burimi: Eurostat

Në krahasim me periudhën e kaluar, gjatë periudhës referuese në kufijtë e jashtëm të BE-së, numri i shtetasve kosovarë të cilët konsideroheshin si kërcënim publik, kishte rritje të konsiderueshme. Rritjet më të theksuara për këtë kategori (në persona) ishin në vitet 2020 (305) dhe vitin 2021 (215) për të rënë në (30) në vitin 2022. Arsyeja e kësaj rritje të refuzimeve të hyrjes në kufijtë e jashtëm të BE-së, ishte efekti i kufizimeve të udhëtimit për shkak të trajtimit të pandemisë me Covid -19.

Arsyet e tjera për refuzimin e hyrjes së shtetasve kosovarë në kufijtë e BE-së dhe zonën Schengen krahasuar me periudhën e kaluar ishin: qëllimi dhe kushtet e qëndrimit të pajustificuara u rritën për 22.2%, ndërsa rastet kur është lëshuar një alarm u ulën për -1.5%. Shtetasit kosovarë të cilët paraqiten para autoriteteve kufitare dokument (et) të rreme udhëtimi u dyfishuan 215%, për ata me vizë ose lejeqëndrimi falso pati rënie prej -16.1%; për persona që tashmë qëndruan 3 muaj në një periudhë 6-mujore pati ngritje prej 33.3% dhe për shtetasit kosovarë të cilët nuk patën mjete të mjaftueshme të jetesës pati rënie prej -22.2%.

Shtetas kosovarë të cilët janë zënë me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen

Sipas të dhënave në periudhën 2018 - 2022, me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen²⁷ janë gjetur rreth 25,285 persona me shtetësi


²⁷ Kjo kategori lidhet me personat që janë gjetur se kanë hyrë në mënyrë të paligjshme (për shembull duke shmangur kontrollat e imigracionit ose duke përdorur një dokument mashtrues) dhe ata që mund të kenë hyrë në mënyrë të ligjshme, por më pas kanë

kosovare. Duhet nënvizuar faktin se në periudhën e kaluar me qëndrim të parregullt janë gjetur rreth 123,370 shtetas kosovarë, si shkak i fenomenit të emigrimit të parregullt gjatë vitit 2014 dhe 2015. Tendanca të rënies kishte përgjatë gjithë periudhës 2018–2022, me një numër relativisht konstant, mesatarisht rreth 5,057 personave në vit. Gjatë kësaj periudhe mund të veçojmë vitin 2021 (4,405) me numrin më të ulët dhe vitin 2018 (5,945) me numrin më të lartë të shtetasve kosovarë, të cilët janë gjetur me qëndrim të parregullt, ndërsa në vitin e fundit 2022, kishte një rritje të lehtë prej rreth 14%, krahasuar me vitin 2021.

Të dhënat e regjistruara sipas shteteve për periudhën 2018 – 2022, tregojnë se më shumë se gjysma 57% (14,365), të shtetasve kosovarë me qëndrim të parregullt janë gjetur në tri shtete: Gjermani 37% (9,240), Francë 11% (2,840), Kroaci 8% (2,285) dhe shtetet tjera 43% (10,825). *Për më shumë info, shih tabelën 34 në aneks.*

Të dhënat për numrin e shtetasve kosovarë që u gjetën të jenë të pranishëm me qëndrim të parregullt sipas shteteve të BE-së dhe zonës Schengen (Figura 23), tregojnë se rënie të konsiderueshme kishin shtetet: Hungaria, Suedia, Gjermania, Austria, Franca dhe Zvicra, kurse rritje të lehtë kishin shtetet: Sllovenia, Italia dhe Kroacia.

Figura 23: Shtetasit kosovarë u gjetën të jenë të pranishëm me qëndrim të parregullt, sipas shteteve, 2018 – 2022



Burimi: Eurostat

Gjatë periudhës referuese, të dhënat e ndara sipas gjinisë, tregojnë se kryesisht meshkujt përbënin rreth 87.2%, të atyre që janë gjetur me qëndrim të parregullt brenda territorit të

mbetur në baza të paligjshme (për shembull, duke e tejkaluar lejen e tyre për të qëndruar ose duke marrë punë të pa-autorizuara). Në këto statistika regjistrohen vetëm personat që janë kapur ose përndryshe vihen në vëmendjen e autoriteteve të shteteve të imigrimit.

shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, në krahasim me gjininë femrore e cila përbënte 12.8%. Gjatë kësaj periudhe, ka pasur tendenca më të shpejta në rënie të gjinisë femrore që u gjetën me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, krahasuar me numrin e gjinisë mashkullore. Kështu, shkalla e rënies për gjininë femrore në periudhën 2018-2022 krahasuar me periudhën e kaluar 2013-2017 është 88% kundrejt 79% për gjininë mashkullore. Një ndër arsytet që mund të lidhet me këtë ndryshim të trendit ndërlihet me forcimin e kontrollit të kufijëve të jashtëm të shteteve të zonës Schengen dhe ndryshimet e rrugëve të migrimit të parregullt.

Tabela 9: Shpërndarja sipas moshës dhe gjinisë të shtetasve kosovarë të cilët janë gjetur me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, 2018 – 2022

Gjinia	F	%	M	%
Gjithsej	4,345	100	22,045	100
Nën 14 vjeç	230	5.3	265	1.2
14 deri në 17 vjeç	150	3.4	530	2.5
Nën 18 vjeç	390	9	805	3.7
18 deri në 34 vjeç	1,515	34.9	12,715	57.6
35 vjeç e lart	2,040	47	7,150	32.4
E panjohur	20	0.4	580	2.6

Burimi: Eurostat

Struktura sipas grupmoshave të shtetasve kosovarë që u gjetën të jenë të pranishëm me qëndrim të parregullt brenda territorit të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, tregon një tendencë përfaqësimi për moshën 18 - 34 vjeç prej 54%, ata të moshës 35 vjeç e lart përfaqësoheshin me 34%, nën 18 vjeç me 5%, 14 - 17 vjeç me 3%, nën 14 vjeç me 2% dhe të panjohur me 2%, (shih tabelën 9).


Gjysma e shtetasve kosovarë rreth 50%, janë gjetur duke hyrë në formë të parregullt (ilegale) në territorin e shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, me mbi qëndrim ishin 19% dhe arsyeje tjetër 31%. Në dy vitet e fundit, Kroacia raportoi numrin më të madh të shtetasve kosovarë që hynë në mënyrë të parregullt me 27%, e pasuar nga Zvicra me 26%, Italia 13%, Sllovenia 12%, Gjermania 12% dhe shtetet tjera me 10%

Shtetasit kosovarë të urdhëruar të largohen²⁸ nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen

Të dhënat statistikore tregojnë se numri i shtetasve kosovarë të urdhëruar të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen gjatë viteve 2018-2022, ka ndryshuar vazhdimisht por gjithsesi ka qenë në rënie. Sipas të dhënave për periudhën referuese, rreth 24,305 shtetas të Republikës së Kosovës u urdhëruan të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen. Gjatë kësaj periudhe mund të veçojmë vetëm vitin 2022, që kishte një rritje të lehtë prej 2.6%, krahasuar me vitin 2021.

Gjatë periudhës referuese, tre shtete anëtare të BE-së, së bashku përbënin 59% të të gjithë shtetasve kosovarë të urdhëruar të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen. Franca raportoi numrin më të madh të shtetasve kosovarë të urdhëruar të largohen 8,650 (36%), e pasuar nga Gjermania, 2,975 (12%) dhe Kroacia, 2,680 (11%). Për më shumë info, shih tabelën 22 në aneks. Krahasuar me periudhën e kaluar, numri i shtetasve kosovarë të urdhëruar të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen në të gjitha shtetet paraqet rënie të dukshme, tendenca në rritje paraqiten në tri shtete të BE-së, ashtu siç shihet nga figura 24.

Figura 24: Shtetasit kosovarë të urdhëruar të largohen nga dhjet shtetet e para të BE-së, krahasim i periudhës 2018-2022



Burimi: Eurostat

²⁸ Kjo kategori përfshin shtetasit e vendeve të treta që gjenden në mënyrë të paligjshme, të cilët i nënshtrohen një vendimi ose akti administrativ ose gjyqësor që deklaron se qëndrimi i tyre është i paligjshëm dhe që vendos detyrimin për t'u larguar nga territori i Shtetit Anëtar. Këto statistika nuk përfshijnë personat që transferohen nga një shtet anëtar në tjetrin sipas mekanizmit të vendosur nga Rregullorja e Dublinit, por mbledhen nga Eurostat sipas statistikave të Dublinit. Çdo person llogaritet vetëm një herë brenda periudhës së referencës, pavarësisht nga numri i njoftimeve të dhëna për të njëjtin person.

Të dhënat e regjistruara tregojnë se nga numri i përgjithshëm i shtetasve kosovarë të urdhëruar të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, prin gjinia mashkullore (88%), ndaj asaj femrore (9%), kurse 3% ishin të panjohur.

Gjatë periudhës 2018 - 2022, 90% e shtetasve kosovarë të urdhëruar të largohen, ishin të moshës madhore të aftë për punë. Të rinjtë e grupmoshës 18-34 vjeç, përbënin pothuajse më shumë se gjysmën përkatësisht 62% e të gjithë shtetasve kosovarë të urdhëruar të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, të ndjekur nga grupmosha 35 vjeç e lart, me 28% dhe më pak se 18 vjet, me 7%, kurse 3% ishin të panjohur.


Shtetasit e Republikës së Kosovës të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen në bazë të urdhrimit për largim

Shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen raportuan gjithsej 9,310²⁹ shtetas kosovarë të larguar³⁰ nga territoret e tyre gjatë periudhës 2018-2022 . Për dallim nga vitet e mëparshme, gjatë periudhës referuese 2018-2022, kishte numër më të ulët të të largimeve për shtetasit kosovarë. Në këtë kontekst, viti 2020 (për shkak të kufizimeve si rezultat i pandemisë Covid-19), karakterizohet me numrin më të ulët të largimeve për shtetasit kosovarë që nga koha kur Republika e Kosovës paraqitej në të dhëna të EUROSTAT-it. Nga numri i përgjithshëm në periudhën 2018 - 2022, nga Gjermania u larguan 3,475 (38%) shtetas kosovarë, nga Kroacia 1,805 (19%), nga Franca 1,020 (11%), nga Suedia 885 (10%), nga Austria 790 (8%) dhe 1,265 (14%) nga shtetet tjera. *Për më shumë info, shih tabelën 35 në aneks.*

²⁹ https://ec.europa.eu/eurostat/databroeser/vieë/MIGR_EIRTN/default/table?lang=en, përditësimi i fundit, 11/05/2023 23:00

³⁰ Kjo kategori përfshin shtetasit e vendeve të treta që janë larguar nga territori i Shtetit Anëtar pas marrjes së një urdhri për t'u larguar ose në një vend tjetër BE+EFTA ose në një vend të tretë.

Figura 25: Shtetasit kosovarë të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen në bazë të urdhërit për largim, sipas shteteve, 2018-2022



Burimi: Eurostat

Të dhënat sipas gjinisë tregojnë se meshkujt përbënin më shumë se 3/4 ose 85% e shtetasve kosovarë të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, në krahasim me gjininë femrore e cila përbënte 14%, kurse 1% ishin të panjohur. Grupmosha 18 deri 35 vjeç, përbënte rreth 90%, të larguarve (18 deri në 34 vjeç me 55% dhe grupmosha 35 vjeç e lart me 34%).

A.2.5. Azilkërkuesit kosovarë në shtetet e BE-së dhe zonës Schengen

Kërkesa për azil, nënkupton një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare siç përcaktohet në nenin 2 (h) të Direktivës 2011/95/BE, ku përfshihen kërkesat për statusin e refugjatit ose për statusin e mbrojtjes plotësuese, pavarësisht nëse aplikimi është paraqitur me mbërritjen në pikën kufitare, ose nga brenda vendit dhe pavarësisht nëse personi ka hyrë në territor ligjërish (p.sh. si turist) ose në mënyrë të parregullt (ilegalisht).

Numri i kërkesave nga shtetasit kosovarë për mbrojtjen ndërkombëtare në vendet e BE-së dhe zonës Schengen është zvogluar për rreth tetëfishit gjatë pesë viteve të fundit, krahasuar me periudhën e kaluar. Gjatë periudhës referuse, rreth 12,055³¹ shtetasit kosovarë ishin aplikant për herë të parë³², kurse në përgjithsi kishte 17,120 aplikime për azil³³.

³¹ https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/MIGR_ASYAPPCTZA/default/table?lang=en, përditësimi i fundit, 02/06/2023 23:00


³² Aplikanti për herë të parë-për mbrojtjen ndërkombëtare (i përkufizuar nga neni 2(h) dhe 2(i) të Direktivës së Kualifikimit 2011/95/EU), është një person që ka depozituar një aplikim për azil për HERË TË PARË në një Shtet Anëtar të caktuar. Shprehja “herë të parë” nuk nënkupton afate kohore dhe prandaj një person mund të regjistrohet si aplikant për herë të parë, vetëm nëse ai

Për të pasqyruar më saktë numrin e kërkesave për azil në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen, analiza përfshinë aplikantët për herë të parë për mbrojtje ndërkombëtare, ndërsa përjashton aplikantët e përsëritur.

Të dhënat, tregojnë se në vitin 2020, numri i azilkërkuesve kosovarë për herë të parë u ul në 1,575 persona, njëherit numri më i ultë që nga viti 2009 (Figura 26). Tendenca e rënies u ruajt edhe në vitet në vijim deri në vitin 2021, ku kërkesat e azilit për herë të parë u rritën prej rreth 4.1% krahasuar me vitin 2020 dhe 52.1% në vitin 2022 (2,495), krahasuar me vitin 2021 (1,640).

Figura e mëposhtme tregon numrin e shtetasve kosovarë që aplikuan për azil në vendet e BE-së dhe zonës Schengen. Këto shifra përfshijnë aplikantët për azil, aplikantët për herë të parë dhe nga viti 2021, aplikantët e mëvonshëm. Sipas të dhënave për dy vitet e fundit 2021 dhe 2022, gjithsej 1,415 shtetasve kosovarë kanë bërë një aplikim të mëvonshëm³⁴ për azil.

Figura 26: Numri i kërkesave për azil nga shtetasit kosovarë në vendet e BE-së dhe zonës Schengen, 2018 - 2022



Burimi: Eurostat

ose ajo nuk ka aplikuar asnjëherë për mbrojtje ndërkombëtare në shtetin raportues në të shkuarën, pavarësisht faktit që ai rezultoi se ka aplikuar në Shtet tjetër Anëtar të Bashkimit Europian.

³³ **Aplikant për azil** - i referohet një shtetasi të një vendi të tretë ose personi pashtetësi që ka depozituar një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare ose që është përfshirë në një aplikim të tillë si anëtarë i familjes në lidhje me të cilin nuk është marrë akoma një vendim përfundimtar gjatë periudhës së referencës.

³⁴ **Aplikimi i mëvonshëm**-nënkupton një kërkesë të mëtejshme për mbrojtje ndërkombëtare e bërë pasi është marrë një vendim përfundimtar për një aplikim të mëparshëm, duke përfshirë rastet kur aplikanti ka tërhequr në mënyrë eksplicite aplikimin e tij ose të saj dhe rastet kur autoriteti përcaktues ka refuzuar një kërkesë pas tërheqjes së nënkuptuar të tij në përputhje me Neni 2, q) dhe nenin 28 (1) të DIREKTIVËS 2013/32/BE TË PARLAMENTIT DHE TË KËSHILLIT EVROPIAN e datës 26 qershor 2013 mbi procedurat e përbashkëta për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare.

Bazuar në të dhënat e regjistruara, gjatë periudhës 2018 - 2022, për azilkërkuesit kosovarë për herë të parë, destinacionet kryesore kanë qenë Franca 7,295 (60%) dhe Gjermania 1,685 (14%), të cilat së bashku kanë pranuar rreth 74%, të kërkesave për azil nga Republika e Kosovës. Destinacioni i radhës për azilkërkuesit kosovarë ishte Italia 950 (8%), Belgjika 465 (4%), Suedia 435 (4%), Zvicra 330 (3%) dhe vendet e tjera 895 (7%). *Për më shumë info, shih tabelën 37 në aneks.*

Më shumë se një e treta e azilkërkuesve për herë të parë, shtetas kosovarë ishin në grupmoshën 18 deri në 34 vjeç, që përbënte 41%, grupmosha nën 18 vjeç përfaqësohej me 35%, grupmosha 35 deri në 64 vjeç me 23%, grupmosha mbi 65 vjeç përfaqësohej nën 1%. Kjo shpërndarje moshe ishte e zakonshme pothuajse në të dyja periudhat, ku shumica e azilkërkuesve për herë të parë ishin të rinj nën 35 vjeç, të cilët përbënin pothuajse 76% të numrit të përgjithshëm.

Të dhënat sipas gjinisë për azilkërkuesit për herë të parë, shtetas kosovarë, tregojnë një dominim të lehtë të gjinisë mashkullore (41%, krahasuar me 39% të gjinisë femërore). Ky trend ishte i njejtë në të gjitha periudhat që nga viti 2008.

Sa i përket azilkërkuesve kosovarë që konsiderohen të mitur të pashoqëruar³⁵, në periudhën 2018-2022, kishte gjithsej 85 aplikime në shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen. Gjatë kësaj periudhe numri më i madh i aplikimeve për azil nga të miturit e pashoqëruar³⁶ u regjistrua në vitin 2021 (30) dhe në vitin 2022 (20). Kryesisht dominonte gjina mashkullore me 89% krahasuar me atë femrore 11%. Shtete anëtare të BE-së që regjistruan numrin më të madh të aplikimeve nga të miturit e pashoqëruar kosovarë ishin: Sllovenia 53%, Suedia 23% dhe shtetet tjera me 6%.


Të dhënat për vendimet mbi kërkesat për azil janë të disponueshme për dy faza të procesit: vendimet e shkallës së parë (vendimet fillestare) dhe vendimet përfundimtare të marra pas ankimimit ose shqyrtimit. Shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen për periudhën 2018 - 2022 kanë nxjerrë gjithsej 16,325 vendime të shkallës së parë (Figura 27) dhe 10,095 vendime përfundimtare të marra pas ankesës apo shqyrtimit (Figura 28), për shtetasit kosovarë.

³⁵ https://ec.europa.eu/eurostat/databroeser/vieë/MIGR_ASYUNAA/default/table?lang=en, përditësimi i fundit, 16/05/2023 23:00

³⁶ I mituri i pashoqëruar është një person nën moshën 18 vjeç, i cili arrin në territorin e një Shteti Anëtar të BE-së, dhe është i pashoqëruar nga një i rritur përgjegjës për të miturin ose një i mitur, i cili mbetet i pashoqëruar pasi të ketë hyrë në territorin e një Shteti anëtar të BE-së.

Vendimet e shkallës së parë janë vendime të dhëna nga autoriteti përkatës që vepron si shkallë e parë e procedurës administrative/gjyqësore të azilit në vendin pritës. Vendimet e marra në shkallë të parë për azilkërkuesit kosovarë kanë rezultuar, pozitive 2,225 (14%) dhe refuzuara 14,100 (86%). Nga numri i përgjithshëm i vendimeve pozitive për shtetasit kosovarë, statusi i Konventës së Gjenevës iu dha 870 personave (39%), Statusi i Mbrojtjes Plotësuese 745 personave (34%) dhe Statusi Humanitar 605 personave (27%).

Figura 27: Numri i vendimeve të shkallës së parë vendimet pozitive, refuzimet për azilkërkuesit kosovarë, 2018 - 2022




Burimi: Eurostat

Gjatë periudhës së referencës, norma më e lartë vjetore e vendimeve pozitive të shkallës së parë është shënuar në vitin 2018 (790), më pas ka pasur tendencë rënie deri në vitin 2021, për t'u rritur sërish lehtësisht në vitin 2022 prej 8.4%, krahasuar me vitin 2021. Numri më i madh i vendimeve të shkallës së parë është dhënë në Francë 9,495 (58%), e ndjekur nga Gjermania 3,405 (21%), Italia 1,110 (7%) dhe vendet e tjera 2,305 (14%).

Vendimet përfundimtare në apel ose rishikim kanë të bëjnë me vendimet e dhëna në shkallën përfundimtare të procedurës administrative/gjyqësore të azilit dhe që rezultojnë nga një ankim i paraqitur nga një azilkërkues i refuzuar në fazën e mëparshme.

Gjatë periudhës referuese, 1,240 (12%), azilkërkuesve kosovarë iu dha vendimi pozitiv përfundimtar pas ankimit ose shqyrtimit, kurse u refuzuan 8,850 (88%). Nga numri i përgjithshëm i vendimeve përfundimtare të marra në apel ose rishikim, statusi i Konventës së Gjenevës iu dha 400 personave (33%), Statusi i Mbrojtjes Plotësuese 340 personave (28%) dhe Statusi Humanitar 475 personave (39%).

Figura 28: Numri i vendimeve përfundimtare pas ankimimit ose shqyrtimit, vendimet pozitive, refuzimet për azilkërkuesit kosovarë, 2013 - 2022



Burimi: Eurostat

Norma më e lartë vjetore e vendimeve pozitive përfundimtare pas ankimimit ose shqyrtimit është shënuar në vitin 2018 (430), më pas ka pasur tendencë rënie deri në vitin 2020, për t'u rritur sërish lehtësisht në vitin 2021 prej 3.5% dhe në vitin 2022 prej 44.8% krahasuar me vitin paraprak.

Ndër shtetet anëtare të BE-së, që regjistruan mumrin më të lartë të lëshimit të vendimeve pozitive përfundimtare pas ankimimit ose shqyrtimit ishin: Franca 4,780 (47%), e ndjekur nga Gjermania 3,650 (36%), Suedia 475 (7%) dhe vendet e tjera 1,200 (12%).

Kërkesat për azil në Mbreterinë e Bashkuar


Të dhënat për numrin e azilkërkuesve në Mbreterinë e Bashkuar³⁷ që nga viti 2020, nuk publikohen në bazat e të dhënave të EUROSTAT-it. Numri i kosovarëve që bënë një kërkesë për azil në Mbreterinë e Bashkuar, gjatë viteve 2020 - 2022, ishte gjithsej 82 persona. Sipas gjinisë, të dhënat tregojnë se kryesisht meshkujt përbënin rreth 83%, të atyre që kishin bërë një kërkesë për azil në krahasim me gjininë femrore e cila përbënte 13%. Sipas moshës

³⁷ <https://www.gov.uk/government/statistical-data-sets/asylum-and-resettlement-datasets>,

kryesonte grupmosha 30-49 vjeç me 49%, 18-29 vjeç me 45%, nën moshën 18 vjeç me 4% dhe 50-69 vjeç 2%.

Figura 29, tregon numrin e vendimeve fillestare për azilkërkuesit kosovarë në Mbreterinë e Bashkuar në përqindje. Gjatë periudhës referuse për azilkërkuesit kosovarë në Mbreterinë e Bashkuar u nxorrën 30 vendime fillestare për azilin. Gjysma e kërkesave për azilkërkuesit kosovarë 50% u refuzuan, 23 % morën një përgjigje pozitive, ndërsa tërheqje tjera të kërkesave ishin 27%.

Figura 29: Vendimet fillestare për azilkërkuesit kosovarë në Mbreterinë e Bashkuar (%), 2020 - 2022



Burimi: Home Office Immigration System Statistics

Ndarja sipas statusit të vendimit fillestar të azilkërkuesve kosovarë (në persona): statusi i refugjatit³⁸ 5, grante të tjera 2, refuzim i vërtetuar³⁹ 9, refuzime tjera⁴⁰ 6 dhe tërheqje të tjera⁴¹ 8.

³⁸ Statusi i refugjatit (i njohur më parë si 'azil') u jepet aplikantëve për azil, sipas paragrafit 334, Pjesa 11 e Rregullorës të Imigrimit, për të njohur se ata kanë një frikë të bazuar nga persekutimi në vendin e tyre të origjinës ose në vendin e ish-rezidencës së zakonshme, për arsye të racës, fesë, kombësisë, opinionit politik ose anëtarësimit në një grup të caktuar shoqëror.

³⁹ Një kërkesë për azil vërtetohet kur kërkesa është "qartësisht e pabazuar". Kjo do të thotë se azilkërkuesi nuk mund, në asnjë mënyrë legjitime, të kualifikohet për statusin e refugjatit, Mbrojtje Humanitare, Pushim Diskrecionar ose leje për të qëndruar sipas rregullave familjare ose të jetës private.

⁴⁰ Refuzimet për pretendimet kur azilkërkuesi nuk i plotëson kushtet për statusin e refugjatit, mbrojtje humanitare, leje diskrecionale ose leje për të qëndruar sipas rregullave familjare ose të jetës private.

⁴¹ Një kërkesë për azil mund të tërhiqet në mënyrë eksplicite (d.m.th. nëse aplikanti nënshkruan një formular për tërheqjen e një aplikimi), ose të tërhiqet nëse aplikanti largohet nga MB përpara një vendimi.

A.3. RIPRANIMI DHE RIINTEGRIMI I PERSONAVE TË RIPRANUAR

A.3.1 Ripranimi me forcë dhe vullnetarë

Divizioni për Ripranim dhe Kthim/DSHAM, është autoriteti kryesor shtetëror përgjegjës për zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-208 për Ripranim, si dhe zbatimin e Marrëveshjeve bilaterale të ripranimit. Deri në vitin 2022, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nënshkruar marrëveshje ripranimi me 24 vende⁴², 20 prej të cilave janë vende anëtare të BE-së dhe vendet e Schengenit.

DSHAM zbaton procedurat për ripranimin e një personi i cili është shtetas i Republikës së Kosovës ose i huaji, i cili nuk përmbush ose nuk përmbushë më, kushtet në fuqi për hyrje apo qëndrim në territorin e shtetit kërkues.

Procesi i ripranimit/riatdhimit fillon në bazë të një urdhri/vendimi administrativ apo një vendimi gjyqësor të lëshuar nga shteti kërkues apo shteti pranues, që ia mohon personit apo familjes qëndrimin e rregullt dhe të ligjshëm në atë shtet. Të ripranuarit të cilët kthehen në pikat e kalimit kufitar i takojnë kategorive të të kthyerve me forcë, vullnetarë dhe vullnetarë të asistuar nga IOM.

Të dhënat tregojnë se numri i të ripranuarve (me forcë dhe vullnetarë) gjatë pesë viteve të fundit është 6,262 persona. Po ashtu, në bazë të të dhënave konfirmohet se ripranimi i personave të riatdhesuar në 98% të rasteve bëhet me shtete me të cilat Kosova ka marrëveshje të ripranimit, kurse në 2% të rasteve bëhet duke zbatuar Ligjin e Ripranimit.


Nga numri i përgjithshëm i të ripranuarve 6,262 gjatë periudhës 2018 – 2022, sipas mënyrës së kthimit janë: me forcë 4,589 (73.3%)⁴³, vullnetarë 302 (4.8%) dhe vullnetarë të asistuar nga IOM 1,371 (22%)⁴⁴. Sipas këtyre të dhënave ka një rritje prej 64 % e të ripranuarve me forcë në krahasim me ata vullnetarë.

⁴² Marrëveshjet për ripranim gjenden tek pjesa C.4. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar.

⁴³ Burimi: PK/MPB

⁴⁴ Burimi: IOM

Figura 30: Ripranimi vullnetarë dhe me forcë sipas viteve, 2018–2022




Burimi: DSHAM, PK, IOM

Të dhënat sipas gjinisë për numrin e të ripranuarve me forcë të shtetasve kosovarë, tregojnë se numri i të ripranuarve kryesisht dominohet nga meshkujt me 76.5% (3,510), ndërsa gjinia femërore përfaqësohet me 23.5% (1,079). Po ashtu, sipas të dhënave të ripranuarve vullnetarë dhe vullnetarë të asistuar nga IOM , nga numri i përgjithshëm (1,673) gjinia mashkullore përfaqësohet me 803 (48%), ndërsa gjinia femërore me 870 (52%).

Në bazë të dhënave gjatë këtyre pesë viteve, numri më i madh i të ripranuarve me forcë dhe vullnetarë, vërehet të grupmoshat 18-34 (2,539 ose 40.5%) dhe 35-64 (2,199 ose 35%). Po ashtu, edhe grupmoshat 6-13 (595 ose 9.5%) dhe grupmoshat 0-5 (589 ose 9.4%) kanë numër të madh të ripranuarve dhe kështu mund të nënvizohet se gjatë kësaj periudhe edhe numri i familjeve të kthyer ka qenë i lartë. Siç vërehet në të dhënat për grupmoshat, kryesisht dominon grupmosha aktive për punë (18-34 vjec).

Në figurën 31, prezentohen të dhënat lidhur me ripranimin me forcë dhe vullnetarë sipas shteteve. Siç mund të shihet, prinë Gjermania me 3,802 (60.7%), Franca me 663 (10.6%), Zvicra me 541 (8.6%), Austria me 384 (6.1%), Suedia me 215 (4%) dhe shtetet tjera me 657 (10.5%). Për më shumë, shih tabelën 38 në aneks.

Figura 31: Ripranimi me forcë dhe vullnetarë sipas shteteve, 2018–2022



Burimi: DSHAM/PK/IOM,


Trendi i ripranimit gjatë periudhës 2018 - 2022 ka lëvizur me një mesatare rreth 1,000 - 2000 persona në vit, vitet 2018 dhe 2019 kanë shënuar numrin më të madh të të ripranuarve, ndërsa vitet tjera kanë pësuar rënie të vazhdueshme dhe kjo si rezultat i rënies së emigrimit të parregullt. Lehtësirat që janë krijuar nga shteti Gjerman për tu pajisur me viza për qëllime pune⁴⁵ e ka ndryshuar dukshëm trendin e personave që kanë migruar në mënyrë të parregullt. Ky fakt ka ndikuar në ndryshimin e trendit nga emigrim të parregullt në emigrim të rregullt, dhe ky ndryshim ka një ndikim të madh socio-ekonomik i cili vlerësohet në pjesën B të këtij dokumenti.

A.3.2 Riintegrimi i personave të riatdhesuar

Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve (DRPRIH) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është autoriteti përgjegjës për menaxhimin, mbështetjen e riintegrimin të personave të riatdhesuar. Gjatë vitit 2018-2022, në kuadër të skemave të ndryshme emergjente janë mbështetur personat e riatdhesuar sipas statistikave në vijim:

⁴⁵ <https://www.albinfo.ch/rruget-legale-per-te-gjetur-pune-ne-gjermani/>

Figura 32: Ndhimja menjëherë pas arritjes dhe ndihmat emergjente të riatdhesimit për periudhën 2018-2022




Burimi; DRPRIH

Sipas figurës 32, nga skemat për riintegrim gjatë periudhës 2018-2022,⁴⁶ vërehet që numri më i madh i personave të riatdhesuar kanë përfituar nga skema e transportit (deri në komunën e origjinës), përkatësisht në vitin 2018 dhe pastaj vërehet një rënie e numrit të përfitueseve në vitet pasuese. Po ashtu, vërehet që numri i përfitueseve të riatdhesuar me kompozicion individ është më i lartë se kompozicioni familje që kanë përfituar nga skema e akomodimit me qira deri në 12 muaj, ndërsa gjatë kësaj periudhe nga skema pako ushqimore dhe higjienike dhe asistencë sociale, kemi një rritje të konsiderueshme të numrit të përfitueseve të riatdhesuar në vitet 2019, 2020, 2021.

⁴⁶ Numri i përfitueseve nga skemat e riintegrimit nuk mund të krahasohet me numrin e personave të ripranuar brenda një viti. Personat e riatdhesuar kanë afat ligjor për parashtrimin e kërkesave deri në gjashtë muaj (që do të thotë për disa skema mund parashtrijnë kërkesë në vitin pasues). Për disa masa të cilat ofrohen në bazë të thirrjeve të hapura (personat e riatdhesuar mund të përfitojnë deri në pesë vite pas ripranimit). Po ashtu, personat e riatdhesuar, mund të jenë përfitues të një e më shumë skemave të riintegrimit. Përfituesit nga organizatat ndëkombëtare dhe institucionet vendore, bazohen në programet (kriteret) e tyre mbështetëse në kuadër të këtyre përfituesve ka persona të riatdhesuar në vitin raportues dhe vitet paraqape.

Figura 33: Ndihma për riintegrim të qëndrueshëm, 2018-2022



Burimi; DRPRIH/ Institucionet Vendore dhe Organizatat Ndërkombëtare

Në kuadër të disa skemave për riintegrim të qëndrueshëm (Figura 33), gjatë periudhës 2018-2022 vërehet një rritje prej 82% në skemën financim biznesi, po ashtu një rritje nga viti në vit, vërehet edhe tek trajnimi në punë dhe shërbimet e konsulencës, dhe kjo si rezultat i rritjes së bashkëpunimit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve me organizata ndërkombëtare që e mbështesin procesin e riintegritimit.

A.3.3 Integrimi i të huajve

Integrimi i të huajve në shoqërinë kosovare është i rregulluar përmes kornizës ligjore, përkatësisht me Ligjin për të Huaj, Ligjin për Azil, Ligjin për Shtetësi, si dhe përmes Rregullores (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve, e cila përcakton bazën e sistemit të integritimit të të huajve në Republikën e Kosovës. MPB/DRPRIH është përgjegjëse për menaxhimin dhe koordinimin e politikave të integritimit në bashkëpunim të ngushtë me institucionet relevante qendrore dhe lokale.


Qeveria e Republikës së Kosovës sipas Vendimeve të Qeverisë Nr.10/68 dhe Nr. 9/94, gazetarët nga Ukraina po i financon me programin “Journalists in Residence - Kosovo” në kuadër të cilit gjatë vitit 2022, ka strehuar 13 gazetarë nga Ukraina.

DRPRIH ka mbështetur këta persona me masa emergjente (organizimin e arritjes së tyre dhe transport deri në vendin e destinimit). Po ashtu, të njëjtit kanë përfituar pako ushqimore dhe higjienike në baza mujore, kursin e gjuhës, kursin e integritit të mbështetur nga organizatat ndërkombëtare në koordinim me DRPRIH-në etj.

Për Integrimin e të Huajve, mbështetja e personave të huaj bëhet përmes masave specifike të integritit, me fokus në: vlerësimin e nevojave, kurseve të gjuhës shqipe, kurseve të integritit dhe akomodimit me qira. Në periudhën 2019-2022, kurset e gjuhës shqipe janë ofruar për 28 persona të huaj, kurset e integritit janë ofruar për 21 persona të huaj, si dhe akomodim me qira iu është ofruar 45 personave të huaj.

Gjatë vitit 2020-2022⁴⁷, në kuadër të skemave të ndryshme për integrim janë mbështetur personat e huaj numri i të cilëve është i paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

Figura 34: Numri i personave të cilat kanë përfituar nga skemat e integritit



Burimi: DRPRIH/MPB

A.3.4 Personat e zhvendosur brenda vendit dhe jashtë vendit (PZHBJV)

Në këtë kategori klasifikohen personat të cilët janë zhvendosur brenda Kosovës apo në rajon.

Kthimet vullnetare

Ministria për Kthim dhe Komunitete sipas mandatit të saj në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë së Kosovës, synon të arrijë kthimin e qëndrueshëm të personave të

⁴⁷ Statistikat reflektojnë periudhën kohore 2020-2022, kur edhe ka filluar ofrimi i shërbimeve nga DRPRIH

zhvendosur brenda dhe jashtë vendit, si dhe integrimin dhe stabilizimin e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Tabela e mëposhtme paraqet kthimet e personave të zhvendosur në Malin e Zi, Serbi, Maqedoninë e Veriut, si dhe personat e zhvendosur brenda vendit për vitet 2018 - 2022.

Tabela 10: Numri i të kthyerve vullnetarë brenda dhe jashtë vendit, 2018 - 2022

Etnitetet	2018	2019	2020	2021	2022	Gjithsej	%
Shqiptarë	43	1	16	21	6	87	5.86
Ashkali/Egjiptian	96	53	76	31	25	281	18.94
Boshnjak	10	0	3	0	1	14	0.94
Rom	35	14	61	47	17	174	11.73
Serb	133	123	238	269	155	918	61.86
Tjerë	10	0	0	0	0	10	0.67
Gjithsej	327	191	394	368	204	1,484	100

Burimi :UNHCR

Në mesin e personave të zhvendosur, disa nga problemet që lidhen me procesin e kthimit janë: periudha e gjatë e marrjes së vendimit, proceset e përzgjedhjes, mungesa e infrastrukturës, mbështetja e institucioneve (në fushën socio-ekonomike). Gjithashtu, në varësi të vendndodhjes së kthimit, janë theksuar edhe çështjet e sigurisë dhe të sundimit të ligjit, me theks të veçantë për komunitetet që jetojnë në veri të Kosovës.

Moshat më të vjetra të personave të zhvendosur, kanë shprehur gatishmërinë për të qëndruar në Kosovë. Gatishmëria për të qëndruar në Kosovë, ndryshon tek grupmoshat dhe komunitetet e ndryshme, megjithatë, disa pika të përbashkëta referuese mund të të paraqiten më poshtë:

- Përspektivat e punësimit luajnë një rol shumë të rëndësishëm (sidomos për brezat e rinj);
- Zgjidhja e çështjes së banimit kryesisht për familjet rome, ashkali dhe egjiptiane, të cilat janë të gatshme të kthehen dhe të qëndrojnë, por çështjet që ndërlidhen me alokimin e parcelave/tokës nga ana e komunave përkatëse kanë ngecur.
- Investime infrastrukturore në zonat e banuara me komunitetet pakicë (ndriçimi i rrugëve, sistemet e ujërave të zeza, furnizimi me ujë). Pjesëtarët e komunitetit lokal që

nuk kanë lëshuar vendin, janë shprehur të lumtur me vet faktin që jetojnë në shtëpitë e tyre;

- Vizitat nga zyrtarët komunalë dhe palët e tjera të interesuara kanë luajtur rol shumë të rëndësishëm për kthimin. Gjërat ushqimore dhe jo-ushqimore të ofruara si ndihmë nga palët e ndryshme kanë qenë të mirëpritur.

Shtëpitë e ndërtuara dhe të banuara gjatë periudhës 2018-2022

Raportet e MKK-së tregojnë se gjatë periudhës 2018-2022 janë ndërtuar 214 shtëpi, si dhe janë renovuar 9 shtëpi ekzistuese (financuar nga MKK-ja), ndërsa 164 shtëpi të ndërtuara me fonde të Bashkimit Europian në projektin "RRK V", dhe 69 renovime të vogla (financuar nga akterë të jashtëm, kryesisht Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Ambasada Britanike, si dhe Ambasada Amerikane në Beograd).

Tabela 11: Numri i objekteve të ndërtuara/renovuara nga MKK-ja dhe Akterët e Jashtëm, 2018 – 2022

Shtëpitë e ndërtuara/ renovime	2018	2019	2020	2021	2022	Gjithsej
MKK	94	90	6	24	36	250
EU/IOM	0	30	100	34	0	164
Amb.Britaneze /DRC- renovime	10	4	4	0	0	18
Gjithsej	104	124	110	58	36	432

Burimi :MKK

Qendrat kolektive

Në bazë të raporteve të DRC-së, ende ka 216 PZHBV të vendosur në qendra kolektive.

Tabela 12: Numri i Qendrave Kolektive në Kosovë

Regjionet	Komunat	Qendrat Kolektive	
		Gjithsej	
		FAM	IND
Mitrovica	Leposaviq	40	93
	Zubin Potok	25	69

	Zveçan	7	28
Prishtinë	Graçanicë	17	26
Gjithsej		89	216

Burimi : DRC

Qendra Kolektive në komunën e Shtërpcës është mbyllur gjatë vitit 2020, ku janë ndërtuar 76 banesa, si dhe dy shtëpi. 78 familje kanë përfituar me gjithsej 131 anëtarë. Qendra Kolektive në Graçanicë e njohur si “Bergen” është mbyllur në vitin 2021, me ç’rast janë renovuar 21 njësi banimi, për 21 familje, me gjithsej 26 anëtarë.

Është në implementim e sipër projekti i ndërtimit të dy ndërtesave në komunën e Graçanicës për 17 familje të cilat gjenden në Qendra Kolektive në këtë komunë. Bashkimi European ka ndarë fondet për këtë projekt, ndërsa implementimi bëhet nga Këshilli Danez për Refugjatë (DRC-ja) dhe parashihet që të përfundoj në vitin 2023.

B: NDIKIMI I MIGRIMIT NË ZHVILLIMIN SOCIO-EKONOMIK TË VENDIT, ASPEKTET DEMOGRAFIKE DHE POLITIKAT SEKTORIALE

B.1. NDIKIMI I MIGRIMIT NË ASPEKTIN DEMOGRAFIK

B.1.1. Treguesit bazik demografik


Popullsia rezidente në Kosovë në fund të vitit 2022 (31 dhjetor 2022), është vlerësuar të jetë 1,762,220 banorë. Agjencia e Statistikës së Kosovës çdo vit bën vlerësimin e numrit të popullsisë, duke përfshirë të dhënat për migrimin, me përdorimin e metodologjisë së standardizuar me qëllim të gjithëpërfshirjes së të gjitha grupeve të migrimit.

B.1.2. Rrjedhat dhe stoqet e migrimit

Imigrimi

Sipas vlerësimit të ASK-së gjatë vitit 2022, pjesëmarrja e imigrantëve në popullsinë e përgjithshme rezidente ishte 0.6% apo 10,664 persona⁴⁸ Në këtë shifër janë përfshirë të gjitha kategoritë e imigrantëve (shtetas kosovarë të kthyer/ripranuar dhe të huaj), pa marrë parasysh arsyen e imigrimit.

Figura 35: Imigrimi në Kosovë sipas viteve, 2018-2022



Burimi: ASK


⁴⁸ Burim: ASK <https://ask.rks-gov.net/media/6105/vler%C3%ABsimi-i-popullsis%C3%AB-2020.pdf>

Për periudhën 2018-2022, të dhënat tregojnë se një numër i konsiderueshëm i personave që kanë imigruar gjatë këtyre viteve, janë shtetas kosovarë (migrantë të kthyer/ripranuar) dhe të huaj, me një mesatare vjetore prej 7,831 personave apo 0.44% të popullsisë së përgjithshme rezidente brenda viti.

Emigrimi

Numri i emigrantëve kosovarë gjatë vitit 2022, i vlerësuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës ishte gjithsej 41,553 persona⁴⁹ apo 2.36 % e popullsisë rezidente. Në këtë numër janë përfshirë të gjithë emigrantët pa marrë parasysh arsyen e migrimit dhe statusin e tyre (të rregullt dhe të parregullt).

Figura 36: Emigrimi nga Kosova i vlerësuar nga ASK-ja sipas viteve, 2018-2022



Burimi: ASK

Të dhënat për periudhën 2018-2022 tregojnë se Kosova vazhdon të ketë shkallë të lartë të emigrimit me një mesatare vjetore prej 31,216 personave apo 1.78% të popullatës kosovare.

Migrimi neto

Bilanci i migrimit ndërkombëtar (migrimi neto) në Kosovë për vitin 2022 ishte -- 30,889 banorë apo 1.75% e popullsisë rezidente. Për periudhën 2018-2022 vlerësohet se nga Kosova janë larguar 156,080 banorë apo rreth 8.85% e popullsisë së vendit.

⁴⁹ Burim:ASK <https://ask.rks-gov.net/media/6105/vler%C3%ABsimi-i-popullsis%C3%AB-2020.pdf>

Tabela 13: Rrjedhat e migrimit: imigrimi, emigrimi dhe migrimi neto për vitet 2018-2022

Vitet	Imigrimi	Emigrimi	Net migrimi (nr.absolut)	Net migrimi (përqindje)
2018	6,762	28,164	-21,402	-1.19
2019	6,066	34,911	-28,845	-1.62
2020	11,543	8,724	2,819	0.16
2021	4,122	42,728	-38,606	-2.18
2022	10,664	41,553	-30,889	-1.75

Burimi: ASK

B.1.2. STOQET E MIGRIMIT

Stoqet e imigrimit

Për periudhën 2018-2022 vlerësohet të kemi rritje të stoqeve të imigrimit për 32,395 apo rreth 1.8% të popullsisë.

Tabela 14: Stoqet e imigrimit dhe rrjedhat e imigrimit të shprehura në numra absolut dhe relativ, 2018-2022

Viti	Gjithsej popullsia	Stoku i imigrimit (numra absolut)	Stoku (përqindje)
2018	1,795,666	60,672	3.38
2019	1,782,115	66,738	3.74
2020	1,798,186	78,281	4.35
2021	1,773,971	82,403	4.65
2022	1762277	93,067	5.28

Burimi: ASK

Stoqet e emigrimit

Tabela 15: Stoqet e emigrimit dhe rrjedha e emigrimit të shprehura në numra absolut dhe relativ, 2018-2022

Viti	Gjithsej popullsia	Stoku i emigrimit (numra absolut)	Stoku (përqindje)
2018	1,795,666	210,170	11.70

2019	1,782,115	245,081	13.75
2020	1,798,188	253,805	14.11
2021	1,773,791	296,533	16.70
2022	1,762,277	338,086	19.2

Burimi: ASK

Stoku i imigrimit neto

Gjatë periudhës 2018-2022, në Kosovë imigruan 39,157 banorë, ndërsa emigruan mbi 156,080 banorë dhe popullata e Kosovës gjatë kësaj periudhe është zvogëluar për më shumë se 78,317 banorë, apo 4.4% të popullsisë.

Tabela 16: Stoqet e migrimit neto të shprehura në numra absolut dhe relativ, 2018-2022

Vitet	Gjithsej popullsia	Rrjedhat e imigrimit (numra absolut)	Rrjedhat e emigrimit (numra absolut)	Rrjedhat neto të emigrimit, sipas viteve	Stoku neto i migrimit (numra absolut)	Stoku neto (në raport me shpërndarjen e popullsisë)
2018	1,795,666	6,762	28,164	-21,402	854,198	47.57
2019	1,782,115	6,066	34,911	-28,845	883,043	49.55
2020	1,798,188	11,543	8,724	2,819	880,224	48.95
2021	1,773,971	4,122	42,728	-38,606	918,830	51.8
2022	1,762,220	10,664	41,553	-30,889	949,719	53.89

Burim: ASK

Nëse merret si bazë popullsia që jetonte jashtë vendit më 1 prill 2011 (703,978 banorë vlerësohet se jetonin jashtë vendit) në fund të vitit 2022, vlerësohet se mbi 949,719 banorë apo 53.89 % e popullsisë së Kosovës jetonte jashtë vendit.

B.2. NDIKIMI I MIGRIMIT NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË VENDIT

Në këtë kapitull pasqyrohen politikat dhe strategjitë zhvillimore të Republikës së Kosovës që ndërlidhen me migrimin dhe zhvillimin. Fokusi është vënë në prezantimin e mënyrave se si mund të përdoret potenciali i migrimit për qëllime zhvillimore, dërgesat (remitencat) dhe investimet nga diaspora.

Nisur nga fakti se Republika e Kosovës ka diasporë të konsiderueshme, rol kryesor në këtë fushë ka Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD). Krahas saj, edhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Ministria e Ekonomisë, dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në fushëveprimin e tyre përfshijnë hartimin e politikave dhe strategjive të cilat në mënyrë direkte apo indirekte rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me migrimin dhe zhvillimin. Qëllimi i përbashkët i këtyre institucioneve është krijimi i një klime të favorshme për tërheqjen e investimeve në përgjithësi dhe investimeve nga diaspora në veçanti.

Ministria e Ekonomisë angazhohet në sigurimin e qasjes në shërbimet e energjisë, i cili është një ndër sektorët kyç në zhvillimin ekonomik të vendit. Për këtë qëllim, ME ka hartuar Strategjinë e Energjisë 2022-2031, e cila ka për qëllim rritjen e kapaciteteve gjeneruese të energjisë me kosto të përballueshme dhe të pastërt, si parakusht për zhvillim ekonomik dhe mirëqenie të qytetarëve.⁵⁰

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë përmes Agjencisë për Përkrahjen e Investimeve dhe Ndërmarrjeve (KIESA), i ka kushtuar një rëndësi të veçantë mbështetjes së bizneseve dhe mjedisit të të bërit biznes, përfshirë edhe rrjetet e bizneseve të diasporës. Gjatë periudhës 2018-2022, KIESA ka organizuar gjithsej 13 sesione informuese me rrjetet e bizneseve të diasporës, në bashkëpunim me MPJD, Doganën e Kosovës dhe ATK-në. Në kuadër të politikave zhvillimore me qëllim të përmirësimit të klimës së të bërit biznes, është unifikuar numri i regjistrimit të bizneseve me Doganën e Kosovës dhe Administratën Tatimore të Kosovës. Përmes programit të saj ‘Aftercare-Përkujdesje’ (pas investimit), i dedikuar për investitorët e huaj dhe nga Diaspora, është bërë përditësimi i listës së investitorëve dhe janë vizituar rreth 300 investitorë të huaj.

Në periudhën 2018-2022 janë regjistruar gjithsej: 50,929 biznese, ku prej tyre janë: 3,716 biznese me pronarë të huaj, përfshirë diasporën. Po ashtu, vlen të ceket se ekzistojnë 29 qendra të regjistrimit të bizneseve (one-stop shops) në komunat e Kosovës, në të cilat është zhvilluar moduli për regjistrimin online të bizneseve, ku prej vitit 2019 deri tani kemi gjithsej: 17,952 biznese të regjistruara online.

⁵⁰ [Untitled \(rks-gov.net\)](#)

Tabela 17: Numri i bizneseve të regjistruara me pronarë të huaj, 2018-2022

Viti	Numri i bizneseve
2018	746
2019	694
2020	587
2021	812
2022	877
Total	3,716

Burimi: ARBK

B.2.1. SISTEMI FINANCIAR

Klima e investimeve (politikat fiskale dhe monetare)

Me qëllim të ndërtimit të sistemit të qëndrueshëm të financave publike në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare, të cilat sigurojnë rritje dhe zhvillim ekonomik dhe mirëqenie më të mirë për të gjithë qytetarët, Qeveria e Kosovës ka vazhduar me ridizajnimin e politikave fiskale, avancimit në menaxhimin e financave publike dhe sistemit financiar që sigurojnë llogaridhënie.


Skenari makroekonomik afatmesëm

Pas një ngadalësimi të rritjes ekonomike në vitin 2022 në raport me vitin 2021, ekonomia e Kosovës gjatë periudhës afatmesme pritet të shënojë një rritje ekonomike më të përshpejtuar. Objektivë e Qeverisë mbetet sigurimi i disiplinës fiskale të qëndrueshme, përmes së cilës synohen këto objektiva:

- Fuqizimi i projeksioneve makro-fiskale duke i përafëruar ato me vlerësimet e rrezikut fiskal;
- Forcimi i mbledhjes së të hyrave dhe matja e boshllëkut tatimor;
- Shpenzime të shëndosha tatimore;
- Buxhetimi gjinor në institucionet qendrore dhe lokale.

Në periudhën afatmesme (2024-2026), ekonomia e Kosovës pritet të shënojë rritje reale që qëndron mbi mesataren historike të para-pandemisë, duke u luhatur mesatarisht rreth vlerës 5.8% në terma realë.

Figura 37: Rritja e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve




Burimi;MF

B.2.2. TREGTIA

Gjatë periudhës 2018-2022, bilanci tregtar është karakterizuar, me rritje të bilancit negativ të mallrave. Ndërsa, bilanci i shërbimeve është në trend pozitiv, mirëpo jo mjaftueshëm për ta kompensuar bilancin negativ të mallrave. Masat e ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për nxitjen e prodhimit dhe investimeve në sektorin privat, pritet të kenë efekt pozitiv në eksportin e mallrave dhe rrjedhimisht edhe në ngushtimin e bilancit tregtar negativ të mallrave.

Figura 38: Bilanci tregtar në mallra dhe shërbime dhe si përqindje e BPV, 2018-2022



Burimi: MFPT

Importi i mallrave dhe shërbimeve

Importi i mallrave gjatë periudhës 2018-2022, ka shënuar rritje të theksuar me një mesatare prej 14.7%. Importi i mallrave gjatë kësaj periudhe është rritur me një mesatare prej 14%, ndërsa importi i shërbimeve është rritur në mesatare prej 18.8%.

Eksporti i mallrave dhe shërbimeve

Ekporti i mallrave gjatë periudhës 2018-2022 ka shënuar rritje të theksuar me një mesatare prej 20.0%. Eksporti i mallrave gjatë kësaj periudhe është rritur me një mesatare prej 21.4%, ndërsa ekporti i shërbimeve është rritur në mesatare prej 20.9%.

Tabela 18: Importet dhe eksportet shprehur në milion, 2018-2022


Viti	Totali i importeve	Importet e mallrave	Importet e shërbimeve	Totali i eksporteve	Eksportet e mallrave	Eksportet e shërbimeve
2018	3,820.2	3,114.5	705.8	1,938.3	376.7	1,561.6
2019	3,982.6	3,233.5	749.1	2,068.3	393.2	1,675.1
2020	3,651.6	3,048.3	603.3	1,470.0	475.1	994.9
2021	5,190.9	4,319.7	871.1	2,658.7	752.7	1,906.0
2022	6,350.3	5,218.7	1,131.6	3,436.0	931.5	2,504.5

Burimi: MFPT

B.2.3. INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë për vitin 2022 arrijnë vlerën prej 778.2 milion euro, apo 85% më shumë sesa në vitin paraprak. Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur trendi i IHD-ve në Kosovë gjatë periudhës 2018-2022.

Figura 39: Investimet e huaja direkte në Kosovë të shprehura në miliona euro dhe si përqindje e BPV-së, 2018-2022



Burimi: BQK,


Sektorët që kanë pasur trend pozitiv krahasuar me vitin paraprak dhe kanë ndikuar në rritjen e investimeve gjatë vitit 2022 janë sektorët e patundshmërisë, sektori financiar, sektori i xehetarisë, sektori i furnizimit me energji elektrike, gaz avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar dhe ai i ndërtimit. Pjesëmarrja e patundshmërisë në gjithsej investimet direkte në Kosovë, në vitin 2022 ishte 67.3%, (523.7 milion euro) aktivitetet financiare me 6.9% (53.9 milion euro), xehetarisë me 6.7% (52.4 milion euro), sektori i furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar me 5.8% (44.9 milion euro) dhe ai i ndërtimit me 3.4% (26.7 milion euro).

B.2.4. DËRGESAT E EMIGRANTËVE - REMITENCAT

Remitencat sipas kanaleve, shtetet nga vijnë remitencat

Remitencat në përgjithësi kanë ndikim të shumëfishtë në aspektet kryesore të zhvillimit në Kosovë. Të hyrat nga dërgesat e emigrantëve janë në rritje si rezultat i trendit të rritjes së emigrimit të rregullt për qëllime të punësimit. Në vitin 2022, remitencat në Kosovë arritën shumën prej 1,223.8 miliardë euro, krahasuar me vitin 2021, ku remitencat arritën vlerën 1,153.4 miliardë. Dërgesat e emigrantëve në vitin 2022 kanë pasur pjesëmarrje prej 13.66% në Bruto Produktin Vendor (BPV).

Figura 40: Të hyrat nga remitencat, 2018-2022




Burimi: BQK,

Rreth 74.2% e dërgesave të emigrantëve gjatë vitit 2022 janë transferuar përmes sistemit financiar, ndërsa pjesa tjetër përfshin dërgesat e emigrantëve në mallra dhe mjete të tjera që transferohen përmes kanaleve joformale. Burimet kryesore të dërgesave të emigrantëve vazhdojnë të jenë nga Gjermania me 38.5% dhe Zvicra me 19.8% të totalit të dërgesave të pranuar në Kosovë, duke pasuar me SHBA-të me 8.6%, Austria me 5.5%, Italia me 4.9%, dhe Franca me 4.0%.

Shërbimet e udhëtimit të vizitorëve – Turizmi i Diasporës

Kosova gëzon turizëm të konsiderueshëm nga diaspora, veçanërisht gjatë pushimeve sezonale të verës dhe dimrit. Të hyrat nga shërbimet e udhëtimit janë rritur vazhdimisht që nga viti 2010 duke arritur në 1,875.3 milion euro në vitin 2022. Gjatë vitit 2020 për arsye të pandemisë dhe mbylljes totale për disa muaj, vlera e turizmit ka rënë për 52.5%, duke shënuar vlerën 628.0 milion euro. Ndërsa pas heqjes së restriksioneve të pandemisë në vitin 2021, vlera e turizmit pati rritje të theksuar prej 137.3%. Në vitin 2022 ka arritur në shumën prej 1,875.3 miliardë euro, që paraqet një rritje prej 25.8% krahasuar me vitin paraprak. Pjesa dominuese e të ardhurave të kësaj kategorie, rreth 95% i atribuohet diasporës.

Figura 41: Shërbimet e udhëtimit të vizitorëve, 2018-2022




Burimi: BQK,

Rëndësia e diasporës mund të shihet edhe nga përqindja e pjesëmarrjes në bruto produktin vendor ku remitancat përbëjnë rreth 13.7% të BPV-së, shërbimet e udhëtimit të diasporës përbëjnë 19.9% dhe nga përqindja e pjesëmarrjes së IHD-ve në patundshmëri me 5.3%, siç

është paraqitur në figurën 42. Duke pasur parasysh se shumica e këtyre tre komponentëve përbën rreth 39% të bruto produktit vendor, të hyrat përkatësisht nga migrimi janë faktor i rëndësishëm për të mundësuar konsumin e brendshëm të vendit (konsumi plus investimet) dhe për të ndihmuar në ngritje të prodhimit vendor.

Figura 42: Të hyrat e përgjithshme nga Diaspora, 2018/2022



Burimi: BQK,

B.3. NDIKIMI I MIGRIMIT NË ARSIM DHE ZHVILLIMIN E KAPITALIT NJERËZOR

MASHTI promovon sistem jodiskriminues, të arsimit në të cilin respektohen të drejtat për arsim si për shtetasit e Republikës së Kosovës, ashtu edhe shtetasit e huaj, si dhe ofrohen mundësi të barabarta për arsim cilësor. MASHTI përgjatë periudhës raportuese 2018-2022 ka vazhduar me implementimin e legjislacionit që ndërlidhen me diasporën dhe nxënësit e riatdhesuar.⁵¹ Në këtë drejtim edhe janë hartuar dy tekste si: Libri për Nxënësit e Riatdhesuar dhe Libri i Mësuesit. Këto libra ndihmojnë mësime të mësimdhënësve për mbajtjen e mësimit plotësues me nxënësit e riatdhesuar.

⁵¹ UA për Barasvlerë dhe Njohje të Dokumenteve të Arsimit Parauniversitar të Ardhura nga Vendet Jashtë Kosovës; UA, për Organizimin e Mësimit Plotësues për Nxënësit e Riatdhesuar.

Tabela 19: Numri i nxënësve të larguar jashtë vendit, 2018/2022

Niveli	2017/18			2018/19			2019/20			2020/21			2021/22		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Parafillor (mosha 5-<6)	3	6	9	6	14	20	9	6	15	12	3	15	2	4	6
Fillor dhe i mesëm i ulët (kl. 1 - 9)	269	215	484	432	363	795	338	249	587	330	281	611	301	273	574
I mesëm i lartë (kl. 10 - 12)	28	14	42	109	33	142	65	38	103	111	60	171	110	38	148
Gjithsej	300	235	535	547	410	957	412	293	705	453	344	797	413	315	728

Burimi: MASHTI/SMIA

Nga tabela e mësipërme vërehet një ngritje e numrit të nxënësve që kanë emigruar nga viti 2018 e tutje. Arsye të këtij trendi të emigrimit mund të jenë kryesisht për arsye të bashkimit familjarë, duke pas parasysh se numri i emigrimit të shtetasve të Republikës së Kosovës për arsye të punësimit në vendet Evropiane është duke shënuar rritje gjithashtu.

Përderisa, trendet e emigrimit të parregullt janë në rënie të theksuar, ky trend reflektohet edhe tek personat e riatdhesuar dhe regjistrimin e nxënësve të riatdhesuar në sistemin arsimor para-universitar në Republikën e Kosovës. Statistikat e këtyre trendeve janë paraqitur në tabelën si në vijim.

Tabela 20: Numri i nxënësve të riatdhesuar dhe regjistruar në sistemin arsimor, 2018-2022

Niveli	2017/18			2018/19			2019/20			2020/21			2021/22		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Parafillor (mosha 5-<6)	6	5	11	2	5	7	19	12	31	1	10	11	9	20	29
Fillor dhe i mesëm i ulët (kl. 1 - 9)	233	188	421	196	129	325	183	133	316	160	137	297	110	89	199
I mesëm i lartë (kl. 10 - 12)	64	33	97	32	23	55	30	17	47	22	10	32	34	18	52
Gjithsej	303	226	529	230	157	387	232	162	394	183	157	340	153	127	280

Burimi: MASHTI/SMI

B.4. NDIKIMI I MIGRIMIT NË PUNËSIM DHE TREGUN E PUNËS

Në periudhën 2018-2022, politika e punësimit të Kosovës është udhëhequr nga parimet e përcaktuara me Strategjinë Sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, tani

Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, e cila kishte në qendër: (i) punësimin (ulja e pasivitetit, rritja e punësimit, zhvillimi aftësitë në përputhje me nevojat e tregut të punës, reduktimin e informalitetit dhe përmirësimin e kushteve të punës); (ii) mirëqenia sociale (ulja e varfërisë, rritja e mbulimit të grupeve të cënueshme në skemat sociale dhe ofrimi i shërbimeve të integruara sociale dhe punësimi) dhe (iii) sistemi i pensioneve (zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm pensionesh, rritja e kapaciteteve menaxhuese dhe nxitja e barazisë). Zbatimi i strategjisë së sipërpërmendur ka pasur progres të ngadalshëm në arritjen e objektivave, veçanërisht në zbatimin e masave legjislative, si: legjislacioni për ndihmën sociale dhe për mbrojtjen sociale, Kodi i Punës, legjislacioni për Agjencinë e Punësimit etj.

Deri në vitin 2022, Kosova ka investuar në shërbimet e punësimit dhe programet aktive të tregut të punës për rreth 0.1 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto, pesë herë më pak se mesatarja e gjetur në vendet fqinje. Që nga viti 2022, investimi u rrit në 0.4 për qind të PBB-së (20 milion euro).

Në kuadër të politikave për menaxhimin e tregut të punës, masat që janë ndërmarrë dhe janë të ndërlidhura me migrim, janë si në vijim:

- Aftësimi profesional;
- Trajnimi në punë;
- Praktika në punë;
- Subvencionimi në pagë;
- Puna publike;
- Lejet e punës afatshkurtra;
- Lejeqëndrimet me qëllim punësimi.

Në kuadër të politikave të riintegritit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar, APRK ka ofruar përkrahje edhe për personat e riatdhesuar në kuadër të masave aktive të tregut të punës dhe instrumenteve të ndërlidhura me to. Për më tepër, referohuni tek Tabela në vijim për statistikën e elaboruarë për secilin shërbim.

Tabela 21: Numri i të Riatdhesuarve përfitues në Masat Aktive të Tregut të Punës (MATP), 2018-2022

Aktiviteti	2018	2019	2020	2021	2022	Gjithsej
Trajnim në punë	87	63	40	24	25	239
Subvencionimi i pagave	132	88	56	14	4	294
Programi i vetpunësimit	340	206	167	100	242	1,055
Trajnim për ndërmarrësi dhe vetëpunësim	0	0	0	0	493	493
Aftësim profesional	380	439	59	108	31	1,017
Gjithsej	939	796	322	246	795	3,098

Bazuar në të dhënat e Eurostatit, vërehet një trend në rritje i shtetasve të Kosovës që emigrojnë në vendet e BE-së për arsye të punësimit. Kjo rritje ka ndikuar në tregun vendor të punës duke rritur hendekun në mes të kërkesave për fuqi punëtore e cila i përgjigjet nevojave të sektorit privat, në industrinë e ndryshme. Ky hendek synohet të adresohet përmes tërheqjes së punëtorëve të kualifikuar të huaj në tregun vendor të punës. Të dhënat për vitin 2022 tregojnë një rritje në trendin e punësimit të të huajve. Për më tepër, tabela si në vijim paraqet statistikat dhe trendin e punësimit të të huajve në tregun vendor të punës.

Tabela 22: Statistikat lidhur me numrin e Lejeqëndrimit për Punë dhe Lejet e Punës Afatshkurtër për të Huajt, 2018-2022

Aktiviteti	2018	2019	2020	2021	2022	Gjithsej
Leje pune afatshkurtër për herë të parë	386	162	68	167	232	1,015
Leje pune afatshkurtër vazhdim	60	12	2	23	25	122
Lejeqëndrimet e përkohshme për qëllime të punësimit për herë të parë	3,596	3,555	2,551	2,865	3,997	16,564
Lejeqëndrimet e përkohshme për qëllime të punësimit vazhdim	1,666	1,580	885	1,413	2,251	7,795

Burimi: APRK, DSHAM

B.5. NDIKIMI I MIGRIMIT NË NGRITJEN E MIRËQENIES SOCIALE

Departamenti i Pensioneve në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, administron 12 skema pensionale (pensionin bazik të moshës, pensionin kontribut-pagues të

moshës, pensionin parcial kontribut-pagues të moshës, pensionin e paaftësisë së përhershme, pensionin e parakohshëm, pensionin invalidor të punës, pensionin familjarë, pensionet për pjestarët e TMK-së, pensionet për pjestarët e FSK-së, kompensimin material për personat e verbër, kompensimin për personat paraplegjik dhe tetraplegjik dhe kompensimin e punëtorëve të arsimit shqip të viteve 1990/99).

Departamenti i Pensioneve, po ashtu zhvillon procedurat për përfitimin e pensioneve të jashtme, ku përfshihen pensioni i pleqërisë, familjar, invalidor i punës dhe kthimi i kontributeve sipas marrëveshjeve bilaterale. Republika e Kosovës aktualisht ka Marrëveshje për Sigurime Sociale me Zvicrën, Belgjikën, Shqipërinë dhe vazhdon zbatimin e marrëveshjeve të trashëguara nga ish-Jugosllavia, me Gjermaninë, Austrinë, Holandën, Francën, Italinë, etj.

Të dhënat për pensionistët të cilët përfitojnë nga Marrëveshjet për Sigurime Sociale janë gjeneruar vetëm për vitin 2022 dhe ato janë si në vijim:

- **Zvicra:** Pensione të pleqërisë 1,094, pensione familjare 1,044, pensione të aftësisë së kufizuar 458. Gjithsejt: 2,596 pensione në vlerë prej 29,560,275.00 CHF;
- **Gjermania:** Pensione të pleqërisë 4,499, pensione familjare 4589, pensione të aftësisë së kufizuar 165. Gjithsejt: 9,253, pensione në vlerë 24,297,000.00 Euro.


B.6. NDIKIMI I MIGRIMIT NË SISTEMIN SHËNDETËSOR

Sektori i shëndetësisë në Republikën e Kosovës ka kaluar nëpër faza të ndryshme të reformave institucionale, si dhe në aspektin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e Republikës së Kosovës ashtu edhe për të huajt. Përkundër progresit të arritur, sistemi shëndetësor vazhdon të përballet me sfida të cilat ndërlidhen mes tjerash, me mosfunksionimin e Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISh). Sipas një studimi të IKSHPS-së, të financuar nga Millenium Challenge Corporation dhe Millenium Foundation Kosovo, u theksua se mungesa e të dhënave si pasojë e mosfunksionalizimit të plotë të SISh-it, moskodimi i diagnozave, kodimin e shkaqeve të vdekjeve, mungesa e raportimit të të dhënave nga institucionet private shëndetësore, janë vetëm disa nga faktorët që ndikojnë në mosfunksionimin e mirëfilltë të sistemit shëndetësor në Kosovë.

Në anën tjetër faktorët jo të favorshëm socio-ekonomik (varfëria dhe papunësia), faktorët ambiental (prevalenca e lartë e sëmundjeve të frymëmarrjes), si dhe shkalla e lartë e fatkeqësive dhe aksidenteve në komunikacion, kanë shkaktuar vështirësi specifike në aspektin e rritjes së jetëgjatësisë në Kosovë, e që ishte edhe synim i SSSh 2017-2021.

Një nga synimet e rëndësishme të SSSh 2017-2021 ishte edhe ulja e mortalitetit perinatal nën 10%. Të dhënat e siguruara tregojnë se kemi një trend të rënies së të dhënave kryesore perinatale në Kosovë për periudhën prej vitit 2000 - 2021⁵², derisa të dhënat e vdekshmërisë tregojnë se kemi një trend të rritjes së vdekshmërisë në Kosovë për periudhën prej vitit 2002-2020⁵³. Koeficienti i mortalitetit është 5.3 të vdekur në 1000 banorë për vitin 2019⁵⁴. Krahasuar me vendet e rajonit dhe vendet e Bashkimit Evropian ky numër është më i ulët.⁵⁵

Figura 43: Shkalla e mortalitetit në 1000 banorë në rajon në BE, 2019



Burimi: Institute National D Etudes Demographiques

Derisa, sa i përket synimit për rritjen e shkallës së vaksinimit të rregullt të moshës 0-12 muaj, Kosova qëndron shumë mirë dhe ka arritur shkallën në nivelin e 95% të vaksinimit të fëmijëve të kësaj moshe, përkundër vështirësive të hasura në vaksinimin e komunitetit rom, ashkalinj dhe egjiptas, që janë shfaqur si pasojë e ndërrimit të vendbanimeve të tyre. Me qëllim të ruajtjes së nivelit të lartë të imunizimit dhe sigurisht rritjes së saj, MSh ka hartuar dhe miratuar Planin Strategjik të Imunizimit 2019-2021.

⁵² Raporti i gjendjes perinatale 2010; ASK: Statistikat e lindjeve dhe vdekjeve, 2011-2021; Statistikat e lindjeve, Departamenti i Statistikave Shëndetësore- IKShPK

⁵³ Agjensioni i Statistikave të Kosovës, dhe ASK DATA, qasja 2.11.2022

⁵⁴ ASK, Statistikat e vdekjeve, 2019


⁵⁵ Institute National D Etudes Demographiques, https://www.ined.fr/en/everything_about_population/data/europe-developed-countries/population-births-deaths

Pandemia Covid-19 përgjatë periudhës së viteve 2020- 2022, ka goditur sektorin e shëndetësisë, dhe si pasojë e saj shumë politika të planifikuara nuk kanë mundur të zhvillohen dhe hartohen sipas planit të paraparë. Por, edhe përkundër këtyre vështirësive, MSh në afat rekord, ka arritur të sigurojë vaksina të mjaftueshme për qytetarët e saj përfshirë edhe dozat për fëmijë.

Trendi emigrimit të personelit mjekësor

Ministria e Shëndetësisë nuk ka ndonjë mekanizëm përkatës për të bërë matjen e emigrimit të personelit mjekësor, por të dhënat që janë ofruar si më poshtë, janë të përmbledhura nga odat përkatëse të cilat lëshojnë certifikata, respektivisht vërtetime për profesionistët shëndetësor, të cilat kërkohen me qëllim të emigrimit. Në fakt ky numër nuk na jep siguri të konstatojmë se të gjithë profesionistët që kanë nxjerrë këto vërtetime kanë emigruar, rrjedhimisht një ndër rekomandimet e dala nga Profili i Zgjeruar i Migrimit 2018-2022, ndërlidhur me krijimin e një mekanizmi të duhur, ku do të mund të mbledhim të dhëna të sakta për numrin e profesionistëve dhe bashkëpunëtorëve shëndetësor të emigruar. Figura si më poshtë paraqet të dhënat e përmbledhura në bazë të nxjerrjes së dokumenteve:

Figura 44: Numri i certifikatave dhe vërtetimeve të lëshuara, 2018/2022




Burimi; MSH

Pra, numri total i të tre kategorive profesionale shëndetësore është 1,529. Siç shihet në të dhënat e mësipërme, vërehet ndër vite një ngritje e emigrimit të mjekëve, dhe sidomos vërehet me përqindje të lartë emigrimi i infermierëve.

Numri i shërbimeve mjekësore të ofruar për shtetasit e Republikës së Kosovës jashtë vendit

Numri i shërbimeve mjekësore të ofruara për shtetasit e Republikës së Kosovës jashtë vendit, është nxjerrë nga numri i totalit të aplikimeve në Programin për Trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore, ku gjithsej numri i aplikimeve për trajtim jashtë vendit gjatë periudhës 2018 – 2022 ishte 6,045. Në bazë të të dhënave të paraqitura në grafikun, vërehet se trendi më i lartë i aplikimeve ishte në vitet 2018 dhe 2019, krahasuar me vitin 2020 që kishte rënie rreth - 32% dhe kjo si pasojë e Covid-19, mirëpo trendi i rritjes së aplikimeve vazhdoj edhe në vitet 2021 dhe 2022.

Figura 45: Numri i aplikimeve për trajtim jashtë vendit, 2018/2022



Burimi; MSH

B.7. NDIKIMI I MIGRIMIT NË FUSHËN E MJEDISIT

Sa i përket ndikimit të migrimit në mjedis, nuk ka indikatorë matës dhe as të dhëna që do mbështetnin çfarëdo analize, vlerësimi apo konstatimi. Vlen të theksohet që emigrimi në rritje i shtetasve të Kosovës, përfshirë edhe migrimin e brendshëm, sidomos lëvizja nga fshati në qytet, ndikon në shpopullimin e zonave të caktuara dhe për pasojë mund të kenë ndikim në mjedis. Mbipopullimi i zonave të mëdha urbane si rezultat i investimeve private në sektorin e ndërtimitarisë, pa një planifikim të duhur urban, ndikon në zhvillimin e politikave të duhura të mjedisit dhe si pasojë ndikon në cilësinë e ajrit dhe në mjedis në përgjithësi.

Në anën tjetër, degradimi i lumenjëve ka rritur rrezikun dhe kërcënimin nga vërshimet dhe fatkeqësitë tjera natyrore të cilat janë në rritje në vitet e fundit dhe të cilat ndikojnë drejtëpërdrejt në zhvendosje të mundshme të popullsisë nga një zonë në zonën tjetër, përfshirë edhe jashtë kufijve kombëtar.

C: QEVERISJA E MIGRIMIT

Qeverisja e migrimit përmes mekanizmave institucional dhe zhvillimi i politikave strategjike të bazuara në të dhëna është ndër prioritetet kryesore të Republikës së Kosovës. Korniza ligjore, strategjike dhe institucionale e ndërtuar dhe zhvilluar ndër vite në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe iniciativave tjera globale në fushën e migrimit. Po ashtu, me qëllim të menaxhimit efikas të migrimit, përgjatë 5 viteve të fundit është konsoliduar dukshëm infrastruktura e teknologjisë informative në funksion të mbledhjes, administrimit dhe analizimit të të dhënave në fushën e migrimit.

Po ashtu në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar është arritur progres sidomos me nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale për ripranim, agjencioneve të specializuara të BE-së, si FRONTEX, EUAA, si dhe atyre me karakter rajonal në kuadër të Procesit të Berlinit. Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar sfidat kryesore të cilat ndërlidhen me pozicionin ndërkombëtar të Republikës së Kosovës sidomos në raport me agjencionet e specializuara në kuadër të OKB-së, apo edhe me disa vende të origjinës të migrantëve të cilat ende nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës.

C.1. KORNIZA E POLITIKAVE

Republika e Kosovës ka miratuar një kornizë të politikave strategjike në fushën e menaxhimit të migrimit. Këto dokumente të politikave reflektojnë prioritetet strategjike të Institucioneve të Republikës së Kosovës në fushën e migrimit, gjithmonë duke pasur në konsideratë ndryshimet e trendeve dhe rrjedhës së migrimit dhe ndërlidhjes me politikat e zhvillimit. Dokumentet kryesore të politikave janë të përmbledhura në vijim:

Strategjia për Migrim (2021-2025)⁵⁶ - është dokumenti kryesor strategjik në fushën e migrimit. Strategjia për Migrim 2021-2025 reflekton prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në menaxhimin e migrimit dhe zbatimin e obligimeve që dalin nga Marrëveshja për Stabilizim-Asociim në mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, si dhe zotimeve të cilat rrjedhin nga objektivat e Paktit Global për Migrimin⁵⁷. Strategjia është e strukturuar në 4

⁵⁶ [Strategjia-e-Migrimit-2021-2025.pdf \(rks-gov.net\)](#)

⁵⁷ https://refugeemigrants.un.org/sites/default/files/180713_agreed_outcome_global_compact_for_migration.pdf

objektiva strategjike, 15 objektiva specifike dhe 91 masa implementuese të cilat synojnë fuqizimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për qeverisjen e migrimit në veçanti Autoritetin Qeveritar për Migrim (AQM), avancimin e sistemit për menaxhimin e migrimit të brendshëm, fuqizimin e sistemit për mbrojtje ndërkombëtare, garantimin e migrimit të sigurt dhe të rregullt, thellimin e bashkëpunimit rajonal dhe me organizata të specializuara ndërkombëtare etj. Mbi të gjitha, Strategjia për Migrim 2021-2025 synon fuqizimin e menaxhimit të migrimit si një shtyllë e rëndësishme e zhvillimit socio-ekonomik të vendit, duke reflektuar kështu sinergji dhe koherencë me objektivat strategjike të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030.

Strategjia Shtetërore për Riintegrim të Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar (2018-2022)⁵⁸ - përcakton objektivat dhe synimet e Institucioneve të Republikës së Kosovës për të konsoliduar sistemin e riintegrimin të personave të riatdhesuar përmes avancimit të masave për riintegrim të qëndrueshëm socio-ekonomik, duke aplikuar qasje gjithëpërfshirëse bazuar në nevoja, me fokuse të veçanta tek grupet e cenueshme. Në vitin 2021, si rezultat i rishikimit të procesit të planifikimit strategjik në kuadër të MPB-së, është vendosur që kjo Strategji të fuzionohet në kuadër të Strategjisë për Migrim 2021-2025.

Strategjia Shtetërore për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (2020-2025)⁵⁹ - përcakton politikën e Republikës së Kosovës për menaxhimin, kontrollin dhe sigurinë kufitare. Objektivi kryesor i kësaj Strategjie është të siguroj bashkërendimin dhe bashkëpunimin e autoriteteve relevante kufitare të përfshira në kontrollin dhe sigurinë kufitare, me qëllim të krijimit të një sistemi efektiv për menaxhimin e kufirit, i cili garanton kufijë të hapur por të kontrolluar dhe të sigurt, përmes një qasjeje të integruar të bashkëpunimit brenda autoriteteve kufitare, bashkëpunimin midis autoriteteve kufitare dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit me Njerëz (2022-2026)⁶⁰ - është dokumenti kryesor i politikave strategjike shtetërore kundër trafikimit me njerëz. Strategjia kundër Trafikimit me Njerëz, ka paraparë veprime dhe masa konkrete me qëllim të parandalimit dhe luftimit efikas të trafikimit, duke u fokusuar në avancimin e mekanizmave përgjegjës institucional,

⁵⁸ [STRATEGJIA SHETËRORE PËR RIINTEGRIM TË QËNDRUESHËM TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR NË KOSOVË 2018-2022.pdf \(rks-gov.net\)](#)

⁵⁹ <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/364/Strategjia%202020-2025.pdf>

⁶⁰ [Strategjia TQNJ 2022-2026.pdf \(rks-gov.net\)](#)

parandalimit dhe vetëdijesimit për pasojat e trafikimit, fuqizimit të sistemit nga identifikimi i viktimës deri në riintegrimin afatgjatë, ngritjes së efikasitetit në ndjekjen penale të kryesve të krimit të trafikimit me njerëz, si dhe fuqizimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.

Strategjia Shtetërore kundër Krimit të Organizuar (2018-2022)⁶¹ - ka përcaktuar objektivat dhe aktivitetet të cilat kanë për qëllim fuqizimin e mekanizmave institucional në fushën e parandalimit dhe luftimit të të gjitha formave të krimit të organizuar, duke përfshirë trafikimin e personave dhe kontrabandimin me migrantë.

Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017 -2021 (SSSh 2017-2021), kishte objektiva të qarta për të realizuar synimet e saja në periudhën 5 vjeçare. Ndryshimet e shpeshta të Qeverive por, sidomos Pandemia Covid-19, ishin faktorë të dëmshëm në realizimin e synimeve strategjike në sektorin e shëndetësisë.

Plani i Reagimit për Menaxhimin e Fluksit të mundshëm me Migrantë, Refugjatë dhe Aplikues për Mbrojtje Ndërkombëtare (2021)⁶² - Qëllimi i këtij plani është menaxhimi i fluksit të migrantëve, refugjatëve dhe aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, duke definuar veprimet përgatitore dhe të reagimit në mënyrë të koordinuar nga institucionet e Republikës së Kosovës. Ky plan përcakton autoritetet kompetente, organizatat dhe përgjegjësitë e tyre në rast të fluksit të migrantëve, refugjatëve dhe aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe masat e aktivitetet që duhet të ndërmerren dhe burimet e nevojshme për zbatimin e tij. Në plan janë të paraparë pesë skenarë të mundshëm, masat e reagimit për secilin skenar, afatet kohore, si dhe kostoja për zbatimin e secilit aktivitet.

Politika e regjimit të vizave - Siç është prezentuar në pjesën A të këtij dokumenti, politika e vizave në Republikën e Kosovës është e rregulluar në bazë të Ligjit për të Huajt dhe Vendimit të Qeverisë, ku përcaktohen shtetet të cilat i nënshtrohen regjimit të vizave. Sistemi Informativ për Viza (SIVK) është shtrirë në 19 misione diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës, ku bëhet aplikimi dhe nga ku lëshohen viza për qytetarët e këtyre shteteve. Në raste të jashtëzakonshme, vizat mund të lëshohen edhe në ndonjërin nga Pikat e Kalimit Kufitar të Republikës së Kosovës përkatësisht në PKK Han i Elezit, Vermicë, ANP dhe Jarinjë.

⁶¹<https://mpb.rksgov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/48/STRATEGJIA%20SHTET%C3%8BRORE%20KUND%C3%8BR%20KRIMIT%20T%C3%8B%20ORGANIZUAR%20DHE%20PLANI%20I%20VEPRIMIT%202018%20E2%80%93%202022.pdf>

⁶²<https://mpb.rksgov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/376/Plani%20i%20Reagimit%20p%C3%ABr%20Menxhimin%20e%20Fluksit%20t%C3%AB%20Mundsh%C3%ABm%20T%C3%AB%20Migrant%C3%ABve.pdf>

C.2. KORNIZA LEGJISLATIVE DHE RREGULLATIVE

Republika e Kosovës ka arritur të konsolidoj tutje kornizën ligjore në fushën e migrimit të zhvilluar në kontekst të Procesit të Stabilizim Asociimit dhe Liberalizimit të Vizave me BE-në. Përgjatë vitit 2020, Ministria e Punëve të Brendshme me mbështetjen e GIZ-it ka ndërmarrë një analizë gjithpërfshirëse lidhur me nivelin e harmonizimit të legjislacionit vendor me Kapitullin 24 të *EU Acquis* (Drejtësia, Liria dhe Siguria), përkatsisht nën-kapitullin që ndërlidhet me fushën e migrimit.

Ky vlerësim ka konstatuar shkallë të lartë të harmonizimit të legjislacionit kombëtar me *Acquis* të BE-së në fushën e migrimit. Ky vlerësim nënvizon se pothuajse 100% e legjislacionit vendor për migrim të rregullt konsiderohet të jetë në harmonizim të plotë ose të avancuar me *Acquis* të BE-së për migrim të rregullt, përkatësisht rreth 33 % e legjislacionit kombëtar është harmonizuar plotësisht me *Acquis* të BE-së, kurse 77% ka harmonizim të avancuar me *Acquis* të BE-së. Ndërsa, sa i përket migrimit të parregullt, vlerësimi ka konstatuar se Republika e Kosovës ka arritur përparim të konsiderueshëm në harmonizimin e legjislacionit kombëtar me *Acquis* të BE-së. Vlerësimi nënvizon se pothuajse 80% e legjislacionit vendor për migrim të parregullt, konsiderohet të jetë në harmonizim të plotë ose të avancuar me *Acquis* të BE-së, kurse 20% ka harmonizim të pjesshëm me *Acquis* të BE-së për migrim të parregullt.

Legjislacioni bazë në fushën e migracionit në Republikën e Kosovës konsiston në këto akte ligjore:

Ligji Nr.04/L-219 për të Huajt - ⁶³ Ky ligj rregullon kushtet e hyrjes, qëndrimit dhe punësimit të të huajve në territorin e Republikës së Kosovës. Në muajin Maj 2018, Ligji bazik për të Huajt Nr.04/L-219 është plotësuar dhe ndryshuar më **Ligjin Nr. 06/L-036** ⁶⁴. Me miratimin e Ligjit Nr.06/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt është bërë inkorporimi i Ligjit për Dhënien e Lejes për Punë dhe Punësimin e Shtetasve të Huaj në Republikën e Kosovës. Po ashtu, janë inkorporuar disa dispozita ligjore me qëllim të lehtësimit të procedurës për lëshimin e lejes së punës për të huajt, procedurat për urdhër largimin vullnetar dhe urdhër largimin me forcë, si dhe shqiptimin e gjobave për të huaj. Në

⁶³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8876>

⁶⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8876>

fund të vitit 2022, ka filluar puna në hartimin e Ligjit të ri për të Huajt, i cili në momentin e hyrjes në fuqi do të shfuqizojë Ligjin Nr.04/L-219 dhe Ligjin Nr.06/L-036.

Gjatë periudhës 2018-2022 janë miratuar aktet nënligjore si në vijim:

- Rregullore (MPB) Nr. 04/2018 për Funkcionimin e Qendrës për Mbajtjen e të Huajve;
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 03 2019 për Kthimin e të Huajve me Qëndrim të paligjshëm në Republikën e Kosovës;
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 09/2019 për Procedurën dhe Kriteret e Lëshimit të Lejes së Qëndrimit për të Huajt;
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 04/2020 për Refuzimin e Hyrjes në Republikën e Kosovës;
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 10/2020 për Kushtet dhe Procedurat e Lëshimit të Vizave në Pikën e Kalimit Kufitar;
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 09/2020 për Kushtet dhe Procedurat e Vazhdimit të Vizës;
- Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 05/2022 për Komisionin e Ankesave për të Huajt;
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për lehtësimin e procedurave dhe kushteve për marrjen e lejeqëndrimit të përkohshëm për shtetasit e Shqipërisë, me dt.10.02.2022 ka hyrë në fuqi dhe nga dt.11.02.2022, ka filluar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Korniza kryesore ligjore që rregullon integrimin e të huajve në Republikën e Kosovës është Rregullorja (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve e cila gjithashtu rregullon bazën e sistemit të integritit të huajve në Republikën e Kosovës. Rregullorja përcakton procedurat, kriteret dhe institucionet përgjegjëse për integrimin e të huajve në jetën sociale, ekonomike dhe kulturore në Republikën e Kosovës. Në kuadër të zbatimit të Rregullores (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve⁶⁵, gjatë viteve 2019-2022 janë hartuar dhe është duke u zbatuar:

- Udhëzuesi për zbatimin e Rregullores (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve në RKS;
- Udhëzuesi për Procedurat Standarde të Veprimit për Integrimin e të huajve në RKS;

⁶⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21006>

- Fletëpalosjet Informative në 8 gjuhë për të drejtat dhe detyrimet e të huajve me status të mbrojtjes ndërkombëtare, të cilat janë shpërndarë tek akterët relevant dhe personave të cilët kanë fituar statusin e mbrojtjes ndërkombëtare në RKS;
- Kurrikula Shtetërore për Trajnimin e Integritimit të Huajve;
- Udhëzuesi për Qasjen e të Huajve në Aftësim Profesional dhe Punësim.

Ligji Nr.06/L-026 për Azil⁶⁶ - Ky ligj rregullon kushtet dhe procedurat për njohjen e statusit të refugjatit, mbrojtjes plotësuese, mbrojtjes së përkohshme, statusin, të drejtat dhe detyrimet e aplikuesve, personave me status refugjati, si dhe personave të cilëve iu është lejuar mbrojtja plotësuese dhe mbrojtja e përkohshme. Gjatë periudhës 2018-2022 janë miratuar aktet nënligjore si në vijim:

- Është miratuar Vlerësimi Ex-post i Ligjit Nr.06/L-026 për Azil;
- Rregullore (QRK) Nr. 29/2018 e Punës së Komisionit Kombëtar për Refugjatë;
- Rregullore (MPB) Nr. 03/2018 për Funkcionimin e Qendrës për Azil;
- Është miratuar Udhëzuesi për Parandalimin, Menaxhimin e Riskut dhe Përgjigjen ndaj Dhunës, bazuar në gjini, dhe në kontekst të migracionit të përzier;
- Plani i Reagimit për Menaxhimin e Fluksit të Mundshëm të Migrantëve, Refugjatëve dhe Aplikuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare;
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 01/2019 për Procedurat e Pranimit dhe Trajtimit Aplikuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare;
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 02/2019 për Procedurat dhe Standardet e Shqyrtimit dhe Marrjes së Vendimit lidhur me Aplikacionin për Mbrojtje Ndërkombëtare.

Në kuadër të avancimit të politikave të riintegritimit, gjatë periudhës 2018-2022 janë hartuar dokumentet si në vijim:

- Udhëzuesi i Mirëqenies Mendore për Riintegritimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar në RKS;
- Manuali për “Vlerësimin e Nevojave dhe Ofrimin e Mbështetjes Psiko-Sociale për Personat e Riatdhesuar në Republikën e Kosovës”.

⁶⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16389>

Ligji Nr.04/L-215 për Shtetësinë e Kosovës⁶⁷ - Përcakton mënyrat e fitimit, humbjes dhe rifitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës. Gjatë periudhës 2018-2022 janë miratuar aktet nënligjore, si në vijim:

- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 06/2019 për Procedurën e Humbjes së Shtetësisë së Kosovës me Lirim dhe Privim;
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 03/2020 për Themelimin dhe Përcaktimin e Rregullave të Punës së Komisionit të Ankesave për Shtetësi;
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 06/2020 për Procedurën dhe Kriteret e Përcaktimit të Statusit të Personit pa Shtetësi, Mënyra e Fitimit të Shtetësisë për Personin pa Shtetësi dhe Personin me Status të Refugjatit;
- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 05/2020 për Kriteret dhe Procedurat e Fitimit të Shtetësisë së Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-208 për Ripranim⁶⁸ - Ky ligj përcakton rregullat dhe procedurat për ripranimin e një personi i cili është shtetas i Republikës së Kosovës ose i huaji, i cili nuk përmbush ose nuk përmbush më, kushtet në fuqi për hyrje apo qëndrim në territorin e shtetit kërkues. Zbatimi i legjislacionit për ripranim aplikohet sa i përket bashkëpunimit për ripranim me vendet me të cilat Kosova ende nuk ka nënshkruar marrëveshje dypalëshe për ripranim.

Ligji Nr.04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikqyrjen e Kufirit Shtetëror ⁶⁹ - Me këtë ligj rregullohet kontrolli kufitar, kompetencat e policisë brenda shtetit, si dhe bashkëpunimi ndërmjet organeve shtetërore të cilat kanë kompetencë në menaxhimin kufitar. Në Shtator 2013, me Ligjin **Nr.04/L-214**⁷⁰ është bërë plotësim-ndryshimi i Ligjit bazik Nr.04/L-072. Ndryshimet e bëra ndërlidhen kryesisht me pjesën e emërtimit të ligjit dhe përkufizimeve me qëllim të harmonizimit me Acquis të BE-së. Ndërsa, në Prill 2018 me Ligjin **Nr.06/L-013**⁷¹ është bërë plotësim-ndryshimi i Ligjit bazik Nr.04/L-072. Ky plotësim-ndryshim është bërë me qëllim të transpozimit të Rregullores (BE) 2016/399 së Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 09 mars 2016 për krijimin e një Kodi të Unionit mbi Rregullat që rregullojnë lëvizjen e personave përtej kufijve (Kodi i Kufijve Schengen).

⁶⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8873>

⁶⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2687>

⁶⁹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2801>

⁷⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2801>

⁷¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2801>

Gjatë periudhës 2018-2022 është miratuar:

- Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 01/2021 për Masat dhe Procedurat e Pranimit dhe Përdorimit të të Dhënave të IPU dhe REU.

Ligji Nr.04/L-216 për Bashkëpunim Ndërmjet Autoriteteve të Përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit⁷² - Rregullon bashkëpunimin ndërmjet të gjitha autoriteteve që janë të përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit (Policisë, Doganës, Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës) në zbatimin e planeve të përbashkëta të këtyre autoriteteve, që kanë të bëjnë me parandalimin, zbulimin dhe hetimin e aktiviteteve të kundërligjshme penale, kontrollin dhe menaxhimin kufitar, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Ligji Nr.04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit⁷³ - Përcakton dispozitat juridike përmes të cilave, i ngarkon me përgjegjësi autoritetet kompetente në: parandalimin dhe luftimin trafikimit me njerëz në të gjitha format e tij, mbrojtjen e viktimave të trafikuar, përfshirë sigurimin e të drejtave, si ndihmë juridike, ndihmë mjekësore, mbështetje psiko- sociale, sigurimi i kompensimit dhe të drejtave të tjera, si dhe bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim të parandalimit dhe luftimit të trafikimit me njerëz, dhe sigurimit të ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të trafikuar.

Ligji Nr.04/L-076 për Policinë⁷⁴ - Ky ligj rregullon autorizimet dhe detyrat e Policisë së Republikës së Kosovës, organizimin e saj dhe çështje të tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës. Gjatë periudhës 2018-2022 janë miratuar aktet nënligjore, si në vijim:

- Udhëzim Administrativ (MPB) Nr. 02/2021 për Menaxhimin dhe Shpenzimin e Fondeve të Veçanta Policore;
- Rregullore (QRK) Nr. 06/2022 për Bashkëpunim Policor Ndërkombëtar dhe Shërbimin e Ndërlidhësve Policor.

Ligji Nr. 04/L-003 për Gjendjen Civile⁷⁵ - Ky ligj rregullon kuptimin dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve të Kosovës, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të

⁷² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8868>

⁷³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8875>

⁷⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2806>

⁷⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2743>

përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës, përcaktimin e rregullave për krijimin, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimin dhe funksionimin e shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Kosovës.

Ligji Nr.02/L-121 për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin⁷⁶ - Me këtë ligj në mënyrë unike rregullohet lajmërimi dhe ç'lajmërimi i vendbanimit dhe vendqëndrimit të qytetarëve, ndërrimi i adresës së banimit, kompetenca dhe mënyra e mbajtjes së evidencave përkatëse.

Migrimi i brendshëm përkatësisht regjistrimi i lëvizjes së qytetarëve nga një vendbanim në vendbanimin tjetër, rregullohet me këto akte ligjore:

Ligji Nr.02/L-121 për Vendbanim dhe Vendqëndrim i miratuar në vitin 2008, përcakton disapozitat ligjore të cilat ndërlidhen me lajmërimin dhe ç'lajmërimin e lëvizjeve të vendbanimit dhe vendqëndrimit të qytetarëve, lajmërimin dhe ç'lajmërimin e mysafirit, ndërrimin e adresës së banimit, kompetencat dhe mënyrën e mbajtjes së evidencave përkatëse. Po ashtu, me këtë ligj definohej detyrimet e qytetarëve për lajmërimin e ndryshimit të vendbanimit, si dhe masa ndëshkimore administrative për mosrespektimin e detyrimeve të përcaktuara me ligj. Në anën tjetër, ligji i definoj edhe përgjegjësitë e organit kompetent në nivel lokal përkatësisht Zyrave të Gjendjes Civile dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme në nivel vendi për mbajtjen e evidencës përkatëse.

Megjithatë, në praktikë gjatë zbatimit të këtij ligji, janë identifikuar disa mangësi strukturore të cilat kanë pamundësuar krijimin e një regjistri të vendbanimit dhe vendqëndrimit të plotë, të saktë dhe të përditësuar. Për këtë qëllim, Ministria e Punëve të Brendshme në vitin 2022 ka finalizuar Koncept Dokumentin për Vendbanimin dhe Vendqëndrimin⁷⁷ duke rekomanduar plotësim-ndryshimin e këtij ligji, përmes të cilit do të konsolidohet Regjistri i Vendbanimit në kuadër të Regjistrit Qendror të Gjendjes Civile .

Ligji Nr.04/L-003 për Gjendjen Civile - Ky ligj rregullon kuptimin dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve të Kosovës, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës, përcaktimin e rregullave për krijimin, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimin dhe funksionimin e shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Kosovës.

⁷⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2589>

⁷⁷ [KONCEPT DOKUMENT PËR VENDBANIM DHE VENDQËNDRIM \(rks-gov.net\)](#)

Ligji Nr.04/L-071 për Sistemin e Adresave⁷⁸ - Qëllimi i këtij ligji është të përcaktoj dhe rregulloj mënyrën e krijimit dhe të administrimit të Sistemit të Adresave, përcaktimin e kriterëve dhe identifikimin e çdo ndërtese, objekti dhe çdo parcele kadastrale të lirë në territorin e Republikës së Kosovës.

Ligji Nr.04/L-013 për Kadastër⁷⁹ - Rregullon kadastrin e paluejtshmërive, matjet shtetërore dhe kadastrale, punët gjeodezike dhe kadastrale, si dhe regjistrimin, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e të dhënave kadastrale.

Ligji Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare në Republikën e Kosovës⁸⁰ - Ligji për statistikat zyrtare ka për qëllim të përcaktoj parimet themelore dhe të krijoj bazën ligjore për organizimin, prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare të Kosovës. Qëllimi i statistikave zyrtare është mbledhja, përpunimi dhe shpërndarja e të dhënave për qëllime statistikore për aktivitetet ekonomike, sociale dhe kushtet e përgjithshme në Kosovë, si dhe i sigurojnë Kosovës përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare në prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare. Në nenin 27, ky ligj përcakton se Agjencia e Statistikave të Kosovës, është përgjegjëse për krijimin, ruajtjen dhe mbajtjen e këtyre regjistrave statistikor, si regjistrin e popullsisë, regjistrin e ekonomive familjare, regjistrin e shtëpive dhe të banesave, regjistrin e bizneseve, regjistrin e njësive hapësinore, regjistrin e ekonomive bujqësore dhe të regjistrave të tjerë në pajtim me planet dhe vendimet.

Ligji Nr.03/L-040 për Vetqeverisjen Lokale⁸¹- Ky ligj përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brenda komunale dhe bashkëpunimin ndërkomunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror.

Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr.03/2015 për Procedurat e Lajmërimit dhe Ç’lajmërimit të Vendbanimit apo Vendqëndrimit⁸²- përcakton procedurat për lajmërimin dhe ç’lajmërimin e vendbanimit apo vendqëndrimit të shtetasve dhe të huajve.

⁷⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2792>

⁷⁹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2757>

⁸⁰ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2782>

⁸¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2530>

⁸² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10645>

Strategjia për Migrim 2021-2025 - Përgjatë hulumtimeve dhe zhvillimit të analizave të ndryshme, Autoriteti Qeveritar për Migracion ka identifikuar mungesën e qasjes strukturore në raport me migrimin e brendshëm, sidomos në raport me lëvizjen e qytetarëve nga një qytet në qytetin tjetër apo nga vendet⁸³ rurale në ato urbane, duke shkaktuar vështirësi në planifikimet adekuate buxhetore të komunave në Kosovë. Për të ofruar një qasje më strukturore në adresimin e kësaj problematike, ishte rekomanduar që në kuadër të Strategjisë për Migrim 2021-2025 të këtë një objektivë strategjike lidhur me migrimin e brendshëm. Në këtë kontekst, Strategjia për Migrim 2021-2025 është dokumenti i parë strategjik në nivel vendi e cila adreson problematikën e migrimit të brendshëm. Në kuadër të këtij dokumenti strategjik, janë paraparë masa të cilat fillimisht kanë synuar identifikimin e zbrazëtirave ligjore, institucionale dhe kapaciteve në menaxhimin e lëvizjeve të brendshme për të pasuar pastaj me veprime konkrete të cilat fokusohen në plotësim ndryshimin e kornizës ligjore (Ligji për Vendbanim dhe Vendqëndrim 02/L-121), avancimin e bazës së të dhënave për migrimin e brendshëm, si dhe aktivitete konkrete në drejtim të informimit të qytetarëve mbi domosdoshmërinë e regjistrimit të ndryshimit të vendbanimit dhe vendqëndrimit.

Ligji Nr. 05/L -077 për Regjistrimin dhe Ofrimin e Shërbimeve për të Papunët, Punëkërkuesit dhe Punëdhënësit⁸⁴ - Qëllimi i këtij ligji është që të rregullohen kushtet dhe procedurat e regjistrimit të të papunësuarve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve, ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësim nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës. Gjatë periudhës 2018-2022 është miratuar:

- Rregullorja Nr. 01/2018 për Masat Aktive të Tregut të Punës.

Ligji Nr.04/L-095 për Diasporën dhe Mërgatën⁸⁵ - ka për qëllim ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të pjesëtarëve të diasporës dhe mërgatës, dhe lidhshmërinë e tyre me institucionet e Republikës së Kosovës. Ky ligj, po ashtu ka për qëllim që të ndihmojë në organizimin e mërgimtarëve në shtetet e ndryshme ku jetojnë ata, si dhe të ndihmoj, nxis dhe zhvilloj marrëdhënie ndërkulturore në mes të Republikës së Kosovës me shtetet ku mërgimtarët janë prezent.

⁸³ <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/378/Strategjia-e-Migrimit-2021-2025.pdf>

⁸⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12743>

⁸⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2831>

Ligji Nr.03/L-125 për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës⁸⁶ - Rregullon veprimtarinë konsullore, mbështet bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve pranuese në fushën e shërbimeve konsullore, si dhe promovon forcimin e marrëdhënieve miqësore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve pranuese.

Vendimi Nr. 14/96⁸⁷ për themelimin e Autoritetit Qeveritar për Migracion i miratuar në mbledhjen e 96-të me rradhë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të mbajtur me 14 shtator 2022.

Vendimin Nr.12/108⁸⁸, për vendosjen e Regjimit të Vizave për të huajt në Republikën e Kosovës, të datës 14.12.2012. Ky vendim është plotësuar dhe ndryshuar në vazhdimësi varësisht nga vlerësimet dhe rekomandimet e MPJD.

C.3. KORNIZA INSTITUCIONALE

Sistemi për menaxhimin e migrimit në Kosovë është i rregulluar përmes kornizës ligjore dhe asaj institucionale e cila përshkruhet në kuadër të Kapitullit të Qeverisjes së Migrimit. Migrimi si fushë horizontale përfshin një numër të konsiderueshëm të institucioneve publike të cilat kanë për mandat planifikimin, hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e migrimit. Mekanizmat kryesor institucional në fushën e migrimit janë:

Koordinatori Shtetëror për Migrim (KSHM) - Koordinon, monitoron dhe raporton për zbatimin e politikave, aktiviteteve dhe veprimeve të parapara në fushën e migrimit. Inicion dhe koordinon hartimin e politikave shtetërore në lidhje me migrimin, adreson rekomandimet e propozuara nga Autoriteti Qeveritar për Migrim të institucioneve përkatëse, monitoron punën dhe funksionimin e Autoritetit Qeveritar për Migrim, përfaqëson shtetin në iniciativa të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e migrimit.

⁸⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2618>

⁸⁷ <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2022/09/Vendimet-e-Mbledhjes-se-96-te-te-Qeverise.pdf>

⁸⁸ Vendimin Nr. 15/158, të datës 29.11.2013; Vendimin Nr. 08/167, të datës 22.01.2014; Vendim nr.07/21, dt.28/7/2021.Ndryshim dhe plotësim i Vendimit të Qeverisë nr.15/158, të dt.29.11.2013, për vendet e BE-së, Zona Schengen,BM dhe Irlanda e Veriut, Selia e Shenjët,Pric. Andora, Monako, Repub.San Marinos, Shqipëris, M. Të Zi dhe Serbisë.

Vendim nr. 14/67, dt. 09.03.2022. Sipas pikës 6 të Vendimit të Qeverisë nr.15/158 të dt. 29.11.2013 i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin e Qeverisë nr. 08/167, të dt. 22.01.2014 dhe Vendimin e Qeverisë nr.14/55, të dt. 06.07.2018,(për shtetasit e Ukrainës). Vendim nr.10/99, dt.30.09.2022.Pezullohet përkohësisht zbatimi i pikës 2 dhe 5, të vendimit të Qeverisë së republikës së Kosovës nr.13/158, të dt.29 nëntor 2013 për shtetasit Federatën Ruse.

Autoriteti Qeveritar për Migrim (AQM) - është themeluar me vendimin e Qeverisë 08-158 të datës 29.11.2013, plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin nr. 14 -96 të datës 14.09.2022, i cili funksionon si mekanizëm këshillëdhënës në fushën e migrimit, përmes hartimit të politikave dhe analizave bazuar në të dhëna AQM, po ashtu është përgjegjës për monitorimin e lëvizjeve migratore dhe funksionon si mekanizëm ndër-institucional duke përfshirë të gjithë akterët relevantë në fushën e migrimit. AQM-ja është përgjegjëse për hartimin e profileve të migrimit dhe u jep rekomandime autoriteteve shtetërore në fushën e migrimit, si dhe propozon politika strategjike dhe rekomandime për Qeverinë në fushën e menaxhimit të migrimit sipas Vendimit të Qeverisë për përcaktimin e përgjegjësisë dhe detyrave dhe Udhëzuesit të Punës të AQM-së, përveç nivelit strategjik dhe sekretariatit, në kuadër të AQM-së funksionojnë edhe gjashtë (6) grupe tematike të cilat adresojnë çështjet si në vijim: migrimin e rregullt dhe mobilitetin, migrimin e parregullt, migrimin e brendshëm, komunikimin, riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve, si dhe të dhënat në fushën e migrimit.

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) - si institucion kyç në këtë fushë, është përgjegjës për politikën e migrimit, përfshirë lidhjen e marrëveshjeve bilaterale për ripranim, kryesisht përmes DSHAM-së, i cili departament mes tjerash, vendos mbi kërkesat për shtetësi, lejeqëndrim, azil, mbrojtje ndërkombëtare, e ripranim, si dhe ka nën mbikëqyrje Qendrën e Mbajtjes për të Huaj, Qendrën e Pritjes së Përkoshme dhe Qendrën e Azilkërkuesve. Një tjetër aspekt të rëndësishëm që MPB trajton në këtë fushë është riintegrimi i personave të riatdhesuar, nëpërmjet programeve të riintegrimit të cilat hartohen, zbatohen dhe monitorohen nga Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve dhe Qendrën për Akomodimin e Përkohshëm të Personave të Riatdhesuar, në bashkëpunim me institucionet relevante të linjës, si dhe koordinimin e politikave për integrimin e të huajve me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Kosovës.

Policia e Kosovës (PK) - është përgjegjëse për kontrollin dhe mbikëqyrjen e lëvizjeve migratore në pikat e kalimit të kufirit dhe në brendi të territorit, monitorimi i të huajve me qëndrim të parregullt, hetimi dhe ndërkjoja e personave të dyshuar për kontrabandim me migrantë dhe trafikim me qenie njerëzore etj.

Ministria e Shëndetësisë- Ligji bazë për shëndetësinë është Ligji Nr. 04/L-125 - për Shëndetësi, i cili është në fuqi nga maji i vitit 2013, dhe nga i cili ligj burojnë aktet e tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë fushëveprimtarinë e shëndetësisë.

Një ndër ligjet më të rëndësishme të aprovuara në Kuvendin e Kosovës është Ligji Nr. 04/L - 249 për Sigurimin Shëndetësor, por që ende nuk ka gjetur zbatim politik, kjo që luajnë rol të madh në mirëqenien dhe shëndetin e qytetarëve.

Ligjet e tjera në fuqi për sektorin e shëndetësisë: Ligji Nr. 05/L-024 për Shërbimin Mjekësor Emergjent; Ligji Nr.04/L-156 për Kontrollin e Duhanit; Ligji Nr. 03/L- 110 për Ndërprerjen e Shtatëzanië; Ligji Nr. 06/L-042 për Gjak dhe Përbërës të Gjakut; Ligji Nr. 04/L-192 për Transplantimin e Indeve dhe Qelizave; Ligji Nr. 05/L- 023 Për Mbrojtjen e të Ushqyerit me Qumësht Gjiri; Ligji Nr. 04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale; Ligji Nr. 02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor; Ligji Nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike; Ligji Nr. 02/L-76 për Shëndetin Riprodhues; Ligji Nr. 2004/38 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Banorëve në Sistemin Shëndetësor; Ligji Nr. 2003/22 për Inspektoratin Sanitar të Kosovës; Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe Ligji Nr. 08-L-220 për Çmimin e Produkteve Medicinale⁸⁹.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) - zhvillon dhe bashkërendon politikat në punët e jashtme, duke shprehur dhe mbrojtur interesat e Kosovës në raport me vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare, në bashkërendim të plotë me ministritë e tjera, ndërsa veprimtaria e këtij institucioni në fushën e migrimit përfshin, ndërlidhjen e migrimit dhe zhvillimit përmes përfshirjes së Diasporës, nënshkrimin e marrëveshjeve në kuadër të kësaj fushe (p.sh. marrëveshjet bilaterale për ripranim), nxjerrjen e udhëzimeve për Sistemin Informativ të Vizave të Kosovës (SIVK), udhëzimeve për procedurat e lëshimit të vizave në misionet diplomatike/konsullore dhe pikat kufitare, formën dhe përmbajtjen e Afishes së Vizës, si dhe vendimin mbi lëshimin e vizave, përmes misioneve diplomatike/konsullore të Republikës së Kosovës, për qytetarët e vendeve për të cilat Kosova aplikon regjimin e vizave.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve është autoriteti kompetent që bën vlerësimet mbi implikimet financiare sa i përket politikave të migrimit dhe zbatimit të tyre. Po ashtu, MFPT është përgjegjëse për hartimin e politikave të punësimit dhe të aftësimit profesional, ndërsa **Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës APRK**, organizon dhe koordinon planifikimin vjetor të aktiviteteve dhe iniciativave për implementim të politikave vjetore të punësimit dhe të aftësimit profesional të hartuara nga MFPT-ja. Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës, lëshon

⁸⁹ (Gazeta Zyrtare, RKS).

leje afatshkurtër për Shtetasit e Huajt, deri në 90 ditë brenda 180 ditëve bazuar në Ligjin Nr.06/L-036 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MSHTI)- aktivitetet e kësaj ministrie që lidhen drejtpërdrejt me fushën e migrimit janë ofrimi i shërbimeve për riintegrimin e personave të riatdhesuar në sistemin shkollor. MASHTI po ashtu është përgjegjës për regjistrimin e të huajve në sistemin arsimor të Kosovës, si dhe zbatimin e programeve për mobilitetin e studentëve kosovarë.

Ministria e Ekonomisë (ME) - në përgjithësi zhvillon dhe zbaton politika të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthortë ndikojnë në trendet e migrimit në vend, duke e pasur parasysh që zhvillimi ekonomik trajtohet si një nga elementet më kryesore të lëvizjeve migratore.

Ministria e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë (MINT) - përmes Agjencisë për Përkrahjen e Investimeve dhe Ndërmarrjeve (KIESA) zbaton programe që kanë për qëllim trajtimin e veçantë të investitorëve nga Diaspora, si dhe promovimin e investimeve, eksportit dhe turizmit me fokus në vendet ku Diaspora kosovare është e koncentruar.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) - mbledh, analizon dhe ofron statistika lidhur me lëvizjet migratore, përfshirë edhe migrimin e brendshëm.

Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) - rregullon themelimin organizimin, strukturimin, detyrat, përgjegjësitë dhe financimin e Agjencisë së Regjistrimit Civil. Po ashtu, përgjigjet për të gjitha proceset në lidhje me aplikimin, personalizimin dhe lëshimin e dokumenteve për shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit e huaj.

Banka Qendrore e Kosovës (BQK) - mbledh, analizon dhe ofron statistika relevante në fushën e migrimit, përkatësisht të dhëna lidhur me remitencat, investimet e huaja direkte, shërbimet e udhëtimit të Diasporës (vizitorët nga Diaspora).

C.4. BASHKËPUNIMI RAJONAL DHE NDËRKOMBËTAR

C.4.1. Marrëveshjet ndërkombëtare bilaterale dhe multilaterale

Një ndër instrumentet kryesore përmes së cilave Republika e Kosovës ka arritur të fuqizoj bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e migrimit përmes nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale:

- Në fushën e ripranimit Republika e Kosovës ka nënshkruar marrëveshje me këto shtete: Shqipërinë, Francën, Zvicrën, Gjermaninë, Danimarkën, Austrinë, Norvegjinë, Slloveninë, Belgjikën, Holandën, Luksemburgun, Republikën e Çekisë, Malin e Zi, Suedinë, Finlandën, Hungarinë, Bullgarinë, Maltën, Estoninë, Principatën e Lihtenshtajnit, Kroacinë, Italinë, Turqinë dhe Maqedoninë e Veriut;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës, në Tetor të vitit 2020, ka arritur Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë për Mobilitetin në Punë, mbi çështjet e punësimit dhe aftësimeve profesionale bazuar mbi orientimet e BE-së, zotimet që dalin nga procesi i Berlinit, bashkëveprimet ndërkufitare në kuadër të përafrimit të masave në lidhje me mobilitetin për punë dhe politikat e përbashkëta;
- Memorandumi i Mirëkuptimit (MM) ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM) në fushën e menaxhimit të migrimit përkatësisht “Kthimi i asistuar vullnetar”, është nënshkruar më datën: 27.05.2019;
- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për lehtësimin e procedurave dhe kushteve për marrjen e lejeqëndrimit të përkohshëm për shtetasit e Shqipërisë, ka hyrë në fuqi më datë 10.02.2022, dhe nga data 11.02.2022 ka filluar zbatimin e kësaj Marrëveshje;
- Marrëveshje Financiare Trepalëshe në mes të Bashkimit Evropian, Kosovës dhe Shqipërisë, për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II, e ratifikuar me dekretin Presidential DMN-026-2018, të datës 20.12.2018;
- Marrëveshje Financiare Trepalëshe në mes Bashkimit Evropian, Kosovës dhe Malit të Zi, për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II, e ratifikuar me dekretin presidencial DMN-025-2018, të datës 20.12.2018;
- Marrëveshje Financiare Trepalëshe në mes Bashkimit Evropian, Kosovës dhe Maqedonisë, për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II, e ratifikuar me dekretin presidencial DMN-024-2018, të datës 20.12.2018;
- Marrëveshje Financiare Trepalëshe në mes të Bashkimit Evropian, Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për vitin 2018, për programin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, e ratifikuar me dekretin presidencial DMN-281-2019, të datës 31.12.2019;

- Marrëveshje Financiare Trepalëshe në mes të Bashkimit Evropian, Kosovës dhe Malit të Zi për vitin 2018, për programin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, e ratifikuar me dekretin presidencial DMN-280/2019, të datës 31.12.2019;
- Marrëveshje Financiare Trepalëshe në mes të Bashkimit Evropian, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut për vitin 2018, për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II, e ratifikuar me dekretin presidencial DMN-257/2019, të datës 19.12.2019;
- Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për Njohjen Reciproke të Patentë Shoferëve, e ratifikuar me dekretin presidencial DMN-85/2019, te datës 29.03.2019;
- Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Njohjen e Ndërsjelltë të Patentë Shoferëve/lejeve të drejtimit, e ratifikuar me dekretin presidencial 45-2019, te datës 21.01.2019;
- Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar, e ratifikuar me dekretin presidencial 46/2019, të datës 31.01.2019;
- Marrëveshje Financiare Trepalëshe në mes të Bashkimit Evropian, Kosovës dhe Shqipërisë për vitin 2019, për programin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA II mes Kosovës dhe Shqipërisë, e ratifikuar me dekretin presidencial 174/2020, të datës 14.12.2020;
- Marrëveshje ndryshuese e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Krushevë (Dragash) - Shishtavec (Kukës) midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, e ratifikuar me dekretin presidencial 184/2021, të datës 07.12.2021;
- Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rregullat e regjimit të trafikut lokal të kufirit, e ratifikuar me dekretin presidencial 182/2021, të datës 07.12.2021;
- Marrëveshja Financiare Trepalëshe në mes të Bashkimit Evropian, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut për vitin 2020, për programin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA

II, mes Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, e ratifikuar me dekretin presidencial 105/2021, të datës 13.07.2021;

- Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Italiane mbi Bashkëpunimin Policor, e ratifikuar me dekretin presidencial 31/2021, të datës 29.01.2021.
- Udhëzues për Bashkëpunim ndërmjet Agjencisë së BE-së për Azil (EUAA) dhe Kosovës “Forcimi i sistemit të azilit dhe pritjes në përputhje me Sistemin e Përbashkët Evropian të Azilit dhe standardet e BE-së” (2022).

C.4.2. Iniciativat rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e migrimit

Institucionet e Republikës së Kosovës kanë zhvilluar forma të ndryshme të bashkëpunimit me organizata dhe iniciativa të veçanta ndërkombëtare dhe rajonale në fushën e migrimit. Kosova gjithashtu ka vendosur bashkëpunim bilateral në fushën e migrimit me një numër të konsideruar të shteteve të cilat konsiderohen me interes. Në lidhje me bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në iniciativat ndërkombëtare dhe rajonale në fushën e migrimit, gjatë kësaj periudhe Republika e Kosovës ka marrë pjesë vazhdimisht në aktivitetet në kuadër të Organizatës Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë MARRI, Procesit të Pragës, si në takimet e zyrtarëve të lartë, ashtu edhe në trajnime.

Po ashtu, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të Autoritetit Qeveritar për Migrim dhe për të mbështetur Koordinatorin Kombëtar për Migrim, MPB është mbështetur nga Programi Global i GIZ dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, në kuadër të Marrëveshjes së Partneritetit për Migrim në mes të Kosovës dhe Zvicrës, aktivitetet e së cilit projekt kanë përfshirë trajnime tematike të ndryshme, zhvillimin e hulumtimit për migrimin, si dhe organizimin e fushatës për informimin e qytetarëve mbi rregullat e lëvizjes pa viza në zonën Schengen.

Po ashtu, në kuadër të Procesit të Berlinit, më datë 3 nëntor 2022, Republika e Kosovës ka nënshkruar marrëveshjen për lëvizjen e lirë me letërnjoftime për qytetarët e gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor.

C.4.3. PROGRAMET/PROJEKTET NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E MIGRIMIT

Përgjatë periudhës referuese 2018-2022, Republika e Kosovës ka vazhduar bashkëpunimin me organizatat rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e migrimit. Në këtë kontekst, Republika e Kosovës ka përfituar mbështetje përmes programeve dhe projekteve të financuara apo implementuara nga organizatat si në vijim:

- Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM);
- Koorporata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ);
- Zyra Zvicrane për Bashkëpunim (SDC);
- Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë;
- Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR);
- Qendra Ndërkombëtare për Përgatitjen e Politikave të Migrimit (ICMPD);
- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF);
- Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (ZBE);
- Nisma Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI);
- Këshilli Danez për Refugjatë (DRC);
- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Misioni në Kosovë;
- CARITAS Zvicran.
- Agjencioni Evropian për Azil – EUAA.

D: TË GJETURAT KRYESORE, IMPLIKIMET NË POLITIKAT PUBLIKE / SEKTORIALE DHE REKOMANDIMET

D.1. Të gjeturat kryesore lidhur me trendet aktuale të migrimit, politikave të migrimit, si dhe ndikimit të migrimit

Trendet migratore në 5 vitet e raportuara në këtë dokument karakterizohen me rritje të emigrimit të shtetasve të Republikës së Kosovës, si dhe rritje të imigrimit të huajve në Republikën e Kosovës. Trendet e emigrimit dhe imigrimit për qëllime punësimi janë në rritje në veçanti në dy vitet e fundit (2021-2022). Kjo ndikon në ndryshimet demografike dhe në kërkesat e tregut të punës, duke afektuar sektorin privat dhe komunitetin e biznesit dhe duke rritur kërkesat për fuqi punëtore nga jashtë, si dhe në përmirësimin e kushteve të punës si për qytetarët e Republikës së Kosovës, ashtu edhe për të huajt që punësohen në tregun vendor të punës.

Këto lëvizje migratore ndikohen nga faktorë të ndryshëm shtytës dhe tërheqës, në veçanti në lehtësimin e politikave dhe procedurave të imigrimit nga vendet e ndryshme e në veçanti nga shtetet e BE-së. Në anën tjetër, bizneset e ndryshme në sektorë të prodhimit dhe shërbimeve, do të mund të ballafaqohen me mungesë të fuqisë së kualifikuar punëtore për ata sektorë specifik të cilët do të kërkojnë zhvillim të politikave që kanë për qëllim t'i përgjigjen kërkesave të komunitetit të biznesit për ofrim të kësaj kategorie të fuqisë punëtore.

Në anën tjetër, si rezultat i rritjes së emigrimit të shtetasve të Kosovës për qëllime punësimi është rritur edhe kontributi i diasporës qoftë përmes remitancave, vizitave të turizimit të diasporës dhe investimeve nga diaspora, duke kontribuar afërsisht 40% të BPV-së në vitin 2022.

Të dhënat e prezantuara në këtë dokument dëshmojnë se, pandemia Covid-19 kishte ndikim në trendet migratore duke zvogëluar dukshëm lëvizjet migratore brenda dhe jashtë vendit. Në këtë kontekst, gjatë interpretimit dhe analizimit të të dhënave për periudhën 5-vjeçare duhet të merret parasysh shpërthimi i pandemisë gjatë vitit 2020, si dhe implikimet të cilat i ka sjellur, si në aspekt të lëvizjes, po ashtu edhe në aspektin socio-ekonomik që lidhet me migrimin.

D.2. Rekomandimet lidhur me kornizën e qeverisjes së migrimit

Në fushën e qeverisjes së migrimit, përgjatë periudhës referuese janë arritur rezultate inkurajuese sidomos me konsolidimin e bazës ligjore për funksionimit e Autoritetit Qeveritar për Migracion si mekanizëm këshillëdhënës në fushën e migrimit. Në anën tjetër sfidë mbetet gjenerimi, përpunimi dhe analizimi i të dhënave si bazë për të zhvilluar politika strategjike bazuara në të dhëna/evidencë. Në këtë drejtim disa nga rekomandimet e dala nga Profili i Migrimit 2018-2022, prezantohen në vijim:

- Të bëhet konsolidimi i bazës ligjore në fushën e qeverisjes së migrimit përmes përfshirjes së AQM-së në kuadër të Projektligjit të ri për të Huajt.
- Fuqizimi i kapaciteteve të AQM-së përmes programave të shkëmbimit të përvojave dhe trajnimeve të specializuara në fushën e migrimit, me theks të veçantë në: gjenerimin e statistikave në fushën e migrimit bazuar në metodologjinë e Eurostat-it, ngritjen e kapaciteteve specifike analitike, ndikimin e migrimit në politika socio-ekonomike, demografike, sektoriale, trajnime të specializuara në fushën e migrimit të rregullt dhe mobilitetit me fokus në zhvillimit e aftësive për të mbuluar nevojat e tregut vendor të punës, si dhe në kthimin e aftësive/dijës nga diaspora, migrimi dhe çështjet gjinore etj.
- Të ofrohet mbështetje për punën dhe funksionimin e AQM-së dhe Grupeve Tematike, duke përfshirë kushtet e punës dhe kompensimit financiar për angazhimin shtesë të antarëve të AQM-së, sipas legjislacionit në fuqi.
- Të fuqizohen kapacitetet e ASK-së lidhur më temat që kanë të bëjnë me migrim dhe demografi.

D.3. Rekomandimet lidhur më ndërlidhjen e migrimit me dokumentet strategjike zhvillimore (p.sh., Strategjia Kombëtare Zhvillimore)

Të dhënat e prezantuara në këtë dokument, konfirmojnë kontributin gjithnjë në rritje të diasporës në zhvillimin e vendit qoftë përmes remitencave, investimeve apo shërbimeve të turizmit. Me qëllim të ndërlidhjes së migrimit me politikat strategjike me synim të zhvillimit socio-ekonomik të vendit rekomandohen këto masa:

- Qeveria të hartoj politika që kanë për qëllim për promovimin e investimeve nga diaspora (Ligji për Investime Strategjike, Strategjia e re e Diasporës etj), duke përfshirë edhe ndërlidhjen me Strategjinë Kombëtare Zhvillimore.
- Rekomandohet të shqyrtohen mundësitë dhe modalitetet e themelimit të Fondit të Papunësisë.
- Të hartohet dhe miratohet Strategjia Nacionale e Punësimit, duke e integruar migrimin si politikë horizontale në zbatimin e masave të punësimit dhe kërkesave të tregut të punës.
- Të zhvillohen programe për rritje të aftësive (skills) që adresojnë kërkesat e sektorit privat për fuqi të kualifikuar punëtore.
- Të zhvillohen politika të punësimit që kanë për qëllim adresimin e mangësive në tregun vendor të punës dhe kërkesave të sektorit privat për fuqi të kualifikuar punëtore.
- Rekomandohet të bëhet një vlerësim i nevojave të tregut vendor të punës si rezultat i ndryshimit të trendeve të migrimit dhe rekomandimet eventuale të përfshihen në Ligjin e ri për të Huajt.
- Të inicohen marrëveshjeve dhe programe të mobilitetit në punë, duke përfshirë rritjen e aftësive/kualifikimeve dhe rikthimin e këtyre aftësive në tregun vendor të punës dhe për zhvillim ekonomik në përgjithësi.
- Të konsolidohet infrastruktura lidhur me sistemin e mbledhjes dhe analizimit të dhënave dhe ndikimit në fushën e mbrojtjes sociale në Republikën e Kosovës, në veçanti sa i përket të dhënave nga zbatimi i marrëveshjeve bilaterale në fushën e pensioneve dhe skemave sociale, pasi që këto të dhëna pasqyrojnë kontributin nga këto skema në mirëqenien sociale të përfituesve, si dhe aspektin ekonomik të vendit.
- Rekomandohet të bëhet një studim lidhur me shërbimet/trajtimet mjekësore të shtetasve të Kosovës jashtë vendit, qoftë përmes programeve që financohen nga buxheti i Kosovës apo me vetëfinancim.
- Të bëhet një analizë lidhur me mundësitë e krijimit të një fondi për zhvillim rajonal apo kohezion social.

D.4. Rekomandimet lidhur me përmirësimin e statistikave në fushën e migrimit, si dhe politikëbërjen bazuar në të dhëna

Përmes identifikimit të mangësive në mbledhjen, përpunimin, dhe shfrytëzimin e të dhënave në fushën e migrimit, rekomandohen masat në vijim, të cilat do të fuqizonin politikëbërjen e bazuar në të dhëna, duke përfshirë edhe strukturimin e mëtutjeshëm të procesit të hartimit të profileve të migrimit:

- Të avancohet sistemi i të dhënave në DSHAM dhe PK (BMS) lidhur me gjenerimin e statistikave për rastet: 1) Lëshimit të urdhër-largimeve vullnetare; 2) Urdhër-largimet vullnetare të shëndruar në Urdhër-largime me forcë, dhe 3) Urdhër-largimet me forcë.
- Gjatë procesit të avancimit dhe digjitalizimit të sistemeve për mbledhjen e të dhënave nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës, të parashihet edhe ndërlidhja e këyre sistemeve dhe të përfshihen edhe marrëveshjet për lëvizje të lirë, si ajo në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.
- Të avancohet mekanizmi i identifikimit të viktimave të trafikimit të shtetasve të Kosovës jashtë vendit.
- Të intensifikohet bashkëpunimi në mes të ASK dhe instituteve kombëtare statistikore të vendeve të BE-së, përmes formalizimit të marrëveshjeve bilaterale ndërshtetërore.
- Të avancohet bashkëpunimi në mes ASK dhe institucioneve vendore qendrore dhe lokale lidhur me çështjet e migrimit (të dhënat, statistikat).
- Të krijohet një modul në Sistemin për Menaxhimin e Kufirit BMS që mundëson regjistrimin e diasporës gjatë vizitave në Kosovë (për qëllime statistikore).
- Të funksionalizohet Sistemi Informativ për Menaxhimin e Arsimit të Lartë.
- Të funksionalizohet Sistemi Informativ Shëndetësor (SHISH), përfshirë edhe sektorin privat të shëndetësisë.
- Të sigurohen të dhëna specifike për investimet nga diaspora (bizneset e regjistruara me pronarë nga diaspora).
- Rekomandohet që të gjenerohen statistikat lidhur me bizneset me pronarë të huaj të regjistruar (sipas sektorëve).
- Të krijohet një sistem për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave për remitencat dalëse.

- Të avancohet Sistemi Informativ i Vizave të Kosovës, duke përfshirë edhe ndërlidhjen me bazën e të dhënave të DSHAM-së, respektivisht modulën për të huajt sa i përket vizës së tipit D.
- Të aplikohet viza elektronike e-viza.
- Të avancohet bazat e të dhënave të DSHAM dhe APRK, që mundësojnë ndarjen e profilit profesional dhe sektorëve në të cilët punojnë shtetasit e huaj të cilët pajisen me lejeqëndrim.
- Të mundësohet ndërlidhja e sistemit SIMP/APRK me sistemin e DSHAM.
- Të shikohen modalitetet për krijimin e një sistemi në kuadër të MPJD-së për regjistrimin e diasporës.

REKOMANDIMET STRATEGJIKE

Nga analizat e bëra në këtë dokument për fushat e ndryshme të ndërlidhur me migrim, rekomandohet që:

- Vazhdimi i reformave në fushën e migrimit në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes për Stabilizim Asociim në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian, përkatësisht nenet 85, 86, 87 dhe 88 të kësaj Marrëveshje.
- Avancimi i qeverisjes së migrimit përmes fuqizimit të AQM-së dhe konsolidimit të sistemit për mbledhjen, përpunimin, analizimin e të dhënave.
- Rishikimi funksional i kornizës strategjike në fushën e migrimit, me qëllim të krijimit të një qasje sektoriale dhe horizontale të politikave të migrimit bazuar në të dhëna.
- Promovimi i migrimit të rregullt, të sigurtë dhe lidhja e marrëveshjeve bilaterale në fushën e mobilitetit për punë.
- Vlerësimi i zbatimit të migrimit në nivel lokal dhe konsolidimi i sistemit të migrimit të brendshëm.
- Të zhvillohen programe inovative që orientojnë remitencat nga mbështetja për konsumin familjar në drejtim të investimeve kapitale që rezulton me hapjen e

vendeve të reja të punës dhe rritjen e eksportit si rezultat i prodhimit/shërbimit.

- Të zhvillohen politika strategjike që kanë për qëllim krijimin e kushteve për investime të diasporës kosovare. Investimet e diaporës duhet të orientohen në aspektin e zhvillimit ekonomik të vendit.
- Menaxhimi i procesit pas-liberalizimit të vizave, përmes ngritjes së kapaciteteve të autoriteteve për menaxhimin e procesit pas-liberalizimit të vizave, si dhe informimin e vazhdueshëm të qytetarëve lidhur me të drejtat dhe obligimet e lëvizjes së lirë pa viza.
- Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkufitar mes shteteve të rajonit, si dhe bashkëpunimi me vendet e origjinës, transitit dhe destinacionit.

ANEKSI A

IMIGRIMI

Tabela 23: Numri i vizave të aprovuara sipas vendit të origjinës, 2018/2022

Shtetet/ Viza të aprovuara	2018	2019	2020	2021	2022	Gjithsej
BOSNJË DHE HERCEGOVINË	538	514	166	219	515	1,952
UKRAINË	103	75	20	42	10	250
LIBI	64	33	7	17	13	134
GJEOGJI	67	34	7	11	45	164
MOLDAVI	54	5	2	20	19	100
PAKISTAN	17	95	7	16	38	173
INDI	30	59	25	11	61	186
KINË	17	69	31	52	32	201
FILIPINE	21	32	9	44	71	177
KAZAKISTAN	27	10	3	10	12	62
BANGLADESH	2	119	2	7	33	163
TË TJERA	288	402	216	258	476	1,640
Gjithsej	1,228	1,447	495	707	1,325	5,202

Burimi:MPJD

Tabela 24: Numri i vizave të refuzuara sipas vendit të origjinës,2018/2022

Shtetet/ Viza të refuzuara	2018	2019	2020	2021	2022	Gjithsej
PAKISTAN	40	19	22	0	43	124
BOSNJË DHE HERCEGOVINË	19	10	48	17	21	115
BANGLADESH	26	37	13	5	26	107
INDI	17	5	13	10	17	62
EGJIPT	0	2	1	6	33	42
SIRI	21	4	4	0	5	34
AFGANISTAN	0	0	2	4	21	27
RUSI	4	3	4	0	14	25
TUNIZI	0	1	0	0	20	21
SOMALI	0	0	0	0	12	12
TË TJERA	38	41	35	139	131	384
Gjithsej	165	122	142	181	343	953

Burimi:MPJD

Tabela 25: Fitimi i shtetësisë sipas shtetësisë 2018-2022

Vitet	2018	2019	2020	2021	2022	Gjithsej
SERBE	95	74	53	112	165	499
SHQIPTARE	53	51	42	66	44	256
MAQEDONASE	37	29	16	45	56	183
GJERMANE	31	18	5	38	62	154
MALAZEZE	6	13	6	8	30	63
NORVEGJEZE	2	2	4	13	33	54
ZVICRANE	5	3	2	9	34	53
KROATE	6	9	2	20	11	48
SUEDEZE	5	7	2	5	13	32
SLLOVENE	4	3	2	10	12	31
TURKE	11	1	5	6	8	31
BELGE	3	4	2	3	15	27
AUSTRIAKE	3	2	3	6	7	21
BOSHNJAKE	4	3	4	5	2	18
ANGLEZE	0	1	0	4	7	12
BRITANEZE	0	2	0	1	4	7
QEKE	1	0	0	1	4	6
FINLANDEZE	0	0	0	0	6	6
AMERIKANE	1	0	0	0	4	5
HOLANDEZE	0	4	0	0	1	5
MALAZIASE	0	0	0	2	1	3
FRANCZE	1	0	0	1	0	2
BULLGARE	0	0	0	1	0	1
SLLOVAKE	0	0	0	0	1	1
BELLURUSE	1	0	0	0	0	1
SIRIANE	0	0	0	0	1	1
POLAKE	0	0	0	0	1	1
PORTUGEZE	0	0	0	0	1	1
ITALIANE	0	0	0	1	0	1
RUSE	0	0	1	0	0	1
EGJIPTIASE	0	0	1	0	0	1
TUNIZIANE	0	0	0	0	1	1
UKRAINASE	1	0	0	0	0	1
JORDANEZE	0	1	0	0	0	1
IZRAELITE	0	1	0	0	0	1
MOLDAVE	0	1	0	0	0	1
RUMUNE	1	0	0	0	0	1
TË TJERA	78	61	27	64	63	293
Gjithsej	349	290	177	421	587	1,824

Burimi: DSHAM

IMIGRIMI PARREGULLT

Tabela 26: Migrantet e parregullt sipas shteteve 2018-2022

Shtetësia	2018	2019	2020	2021	2022	Gjithsej
SIRI	239	908	1330	708	381	3,566
MAROK	36	151	310	214	251	962
AFGANISTAN	7			81	73	161
PALESTINË	70	93	229	32	50	474
ALGJERI	41	119	107	86	34	387
EGJIPT	0	0	0	0	25	25
TURQI	0	0	0	0	20	20
IRAK	33	560	197	36	16	842
BANGLADESH	0	0	0	114	14	128
LIBI	34	0	139	59	11	243
PAKISTAN	19	0	0	0	11	30
VENDET E TJERA	26	196	252	75	53	602
Gjithsej	505	2027	2564	1405	939	7,440

Burimi: PK

Tabela 27: Numri i personave të akomoduar në QMH 2018-2022

Shteti	0-5	6-13	14-17	18-34	35-64	65	Mashkuj	Femra	Gjithsej
NEPALI	1	0	0	10	1	0	6	6	12
LIBI	0	0	0	9	0	0	9	0	9
MAROKO	0	1	0	12	0	0	13	0	13
TURKE	1	0	0	12	1	0	14	0	14
INDI	0	0	0	4	0	0	3	1	4
PALESTINË	0	0	0	3	0	0	3	0	3
JEMEN	0	0	0	3	0	0	3	0	3
SHQIPËRI	2	3		31	2	0	9	29	38
SERBI	0	0	0	5	0	0	1	4	5
KROACI	0	0	0	3	0	0	2	1	3
JORDANI	0	0	0	6	1	0	6	1	7
ALGJERI	0	0	0	8	0	0	8	0	8
FRANCË	0	0	0	2	0	0	1	1	2
GJERMANI	0	0	0	3	1	0	3	1	4
SIRI	0	0	0	3	0	0	3	0	3
KINË	0	0	0	2	0	0	2	0	2
SOMALI	0	0	0	0	1	0	1	0	1
IRAK	0	0	0	2	0	0	2	0	2
ANGLI	0	0	0	1	0	0	1	0	1
MALI I ZI	0	0	0	2	0	0	1	1	2
AUSTRI	0	0	0	1	0	0	1	0	1
TUNZI	0	0	0	2	0	0	0	2	2

BOSNJË DHE HERCEGOVINË	0	0	0	2	1	0	2	1	3
UKRAINË	0	0	0	1	0	0	1	0	1
BANGLADESH	0	0	0	1	0	0	1	0	1
Gjithsej	4	4	0	128	8	0	96	48	144

Burimi: DSHAM/QMH

MBROJTJA NDËRKOMBËTARE

Tabela 28: Azilkërkuesit në Republikën e Kosovës sipas shteteve, 2018/2022

Shteti	2018	2019	2020	2021	2022	Gjithsej
Gjithsej	597	2082	1410	578	549	5216
SIRI	238	911	649	179	176	2153
IRAK	31	559	119	23	10	742
MAROKO	36	152	183	147	186	704
PALESITNË	79	89	121	20	14	323
ALGJERI	41	120	69	66	23	319
LIBI	31	48	89	37	10	215
AFGANISTAN	7	53	61	34	49	204
TURQI	76	48	28	22	21	195
EGJIPT	0	7	23	7	20	57
IRAN	20	9	24	1	1	55
BANGLADESH	0	4	2	10	14	30
TUNIZI	2	8	12	13	7	42
PAKISTAN	19	12	0	4	0	35
JEMEN	0	24	8	2	0	34
LIBAN	1	13	9	0	0	23
JORDANI	0	0	8	1	2	11
UKRAINË	0	2	0	0	6	8
SERBI	3	1	1	1	2	8
SOMALI	0	4	1	0	1	6
AFRIKA E JUGUT	1	1	0	0	3	5
INDI	0	1	0	3	1	5
TUVALU	0	5	0	0	0	5
KONGO	0	2	0	1	1	4
SHQIPËRI	2	2	0	0	0	4
MAFQEDONI E V	2	0	0	1	0	3
TURKMENISTAN	0	3	0	0	0	3
TOGO	0	0	0	3	0	3
GJERMANI	2	0	0	0	0	2
SUDAN	0	1	0	1	0	2
NIGERI	0	0	2	0	0	2
ZIMBABVE	0	0	0	0	1	1
MONAKO	1	0	0	0	0	1
AFRIKAE JUGUT	1	0	0	0	0	1
ERITRE	1	0	0	0	0	1

MALI I ZI	0	1	0	0	0	1
MALAVI	0	1	0	0	0	1
KINË	0	0	1	0	0	1
BAHAMA	0	0	0	1	0	1
BOSNJË DHE HERCEGOVINË	0	0	0	1	0	1
TE TJERA	3	1	0	0	1	5

Burimi:DSHAM

Tabela 29: Të huajt që kanë shprehur qëllim për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare (72 orëshi) 2018-2022

Shtetësia	2020	2021	2022
SIRIANE	796	528	46
MAROKIENE	185	88	15
LIBIASE	105	30	1
PALESTINEZE	147	22	11
BANGLADESH	11	104	0
IRAKIANE	86	15	1
ALGJERIANE	62	25	0
AFGANE	19	51	2
TUNIZIANE	23	1	0
IRANIANE	21	4	1
JEMENASE	16	3	0
SOMALIASE	13	5	0
LIBANEZE	11	4	0
JORDANEZE	9	0	1
PAKISTANEZE	7	7	8
EGJIPTASE	7	8	0
AFRIKA E JUGUT	3	0	0
NIGERIANE	2	0	0
SUDANEZE	2	0	0
TURKMENISTANE	1	0	0
SIRILANKA	1	0	0
ÇAD	1	0	0
KAMERUNASE	1	0	3
MEKSIKANE	1	0	0
SINGAPOR	1	0	0
SENEGAL	1	0	0
Gjithsej	1,532	895	89

Burimi:DSHAM

EMIGRIMI

Tabela 30: Numri i lejeqëndrimeve të lëshuara për herë të parë për shtetasit kosovarë nga autoritetet e shteteve anëtare të BE-së dhe në zonën Schengen, 2018 – 2022

Shteti /viti	Gjithsej	2018	2019	2020	2021	2022
BELGJIKA	2,599	496	446	525	555	577
BULLGARIA	265	45	41	61	71	47
ÇEKIA	944	205	377	109	108	145
DANIMARKA	210	59	42	25	32	52
GJERMANIA	57,009	18,986	22,128	15,895	0	0
ESTONIA	13	4	1	0	4	4
IRLANDA	190	27	50	2	63	48
GREQIA	159	42	40	12	20	45
FRANCA	9,257	2,002	1,971	1,709	1,833	1,742
KROACIA	16,197	2,065	6,369	4,488	3,275	:
ITALIA	12,265	2,842	2,329	1,628	2,356	3,110
QIPRO	2	0	0	0	1	1
LETONIA	2	1	0	1	0	0
LITUANIA	10	3	1	5	0	1
LUKSEMBURGU	435	100	114	50	84	87
HUNGARIA	2,879	526	639	577	603	534
MALTA	15	2	3	4	1	5
HOLANDA	502	98	116	88	112	88
AUSTRIA	5,820	1,293	1,096	981	1,218	1,232
POLONIA	1,549	251	235	303	760	:
PORTUGALIA	17	7	1	4	3	2
SLLOVENIA	28,672	3,819	5,862	3,904	7,058	8,029
SLLOVAKIA	100	7	26	4	14	49
FINLANDA	4,221	376	671	513	1,163	1,498
SUEDIA	5,722	1,335	1,148	1,138	1,065	1,036
ISLANDA	38	15	23	:	:	:
LIHTENSHTAJNI	155	25	28	33	38	31
NORVEGJIA	571	191	135	109	136	:
ZVICRA	8,592	2,490	1,778	:	2,173	2,151
MBRETËRIA E BASHKUAR	136	136	:	:	:	:

Burimi: Eurostat

Tabela 31: Shkalla e punësimit

	2018	2019	2020	2021	2022
Papunësia	95,890	70,790	168,980	82,042	80,775
Vendet e lira të punës	14,847	15,647	11,160	10,747	12,291
Punësimet	6,764	8,771	6,961	6,252	6,472
Ndërmjetsime të rregullta	3,764	4,160	1,330	2,955	4,460
Ndërmjetsime në punësim nga MATP	3,000	4,611	5,631	3,297	2,012
SHPVL	46%	56%	62%	58%	53%
Shkalla e punësimit	7.05%	12.39%	4.12%	7.62%	8.01%

Tabela 32: Lirimi nga shtetësia sipas shteteve 2018-2022

Vitet	2018	2019	2020	2021	2022	Gjithsej
GJERMANI	4,718	4,602	3044	4,338	4,213	20,915
AUSTRI	508	562	422	431	419	2342
SLLOVENI	75	70	71	79	71	366
KROACI	22	47	28	29	29	155
HOLANDË	29	25	27	14	22	117
MALI I ZI	37	36	15	20	18	126
LIHTËNSHTAJN	19	12	10	6	2	49
NORVEGJI	29	13	1	0	1	44
ZVICËR	10	13	3	9	5	40
MAQEDONIA E VERIUT	2	2	3	1	3	11
GJEORGJI	0	0	3	4	2	9
SUEDI	4	0	1	1	2	8
FRANCË	4	1	0	0	0	5
BOSNJË DHE HERCEGOVINË	1	1	1	1	0	4
ITALI	0	3	0	0	0	3
AUSTRALI	0	1	1	0	0	2
TURQI	0	0	0	0	2	2
LIBI	1	1	0	0	0	2
SIRI	0	0	0	1	1	2
SLLOVAKI	1	1	0	0	0	2
PORTUGALI	0	1	0	0	0	1
POLONI	0	0	1	0	0	1
LUKSEMBURG	1	0	0	0	0	1
SERBI	0	1	0	0	0	1
BELGJIKË	0	0	1	0	0	1
KORE	1	0	0	0	0	1
BRITANI E MADHE	0	0	0	1	0	1
SHBA	0	0	0	1	0	1
BULLGARI	0	0	0	1	0	1
SPANJË	0	0	0	1	0	1
DANIMARK	0	0	1	0	0	1

FINLANDË	1	0	0	0	0	1
HUNGARI	0	0	0	0	1	1
ESTONI	0	0	0	0	1	1
Gjithsej	5,463	5,392	3,633	4,938	4,792	24,218

Burimi: DSHAM

EMIGRIMI I PARREGULLT

Tabela 33: Refuzimi i hyrjes i shtetasve kosovarë në kufijtë e jashtëm të shteteve anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, sipas shteteve, 2018 – 2022

Viti/shtetet	Gjithsej	2018	2019	2020	2021	2022
KROACIA	2,585	430	555	355	530	715
SLLOVENIA	1,600	175	300	310	410	405
HUNGARIA	1,240	175	250	260	325	230
FRANCA	745	505	25	60	85	70
GJERMANIA	400	60	65	40	95	140
BULLGARIA	280	30	50	60	80	60
ZVICRA	210	40	50	25	40	55
ITALIA	205	15	20	85	35	50
MBRETËRIA E BASHKUAR	115	50	65	:	:	:
GREQIA	95	10	25	10	25	25
AUSTRIA	70	10	5	10	5	40
SUEDIA	70	5	15	20	10	20
BELGJIKA	55	10	5	5	15	20
RUMANIA	35	5	5	10	10	5
FINLANDA	30	5	0	0	15	10
NORVEGJIA	30	5	5	0	10	10
IRLANDA	15	5	10	0	0	0
HOLANDA	15	0	0	5	10	0
POLONIA	15	0	0	0	10	5
QIPRO	5	0	5	0	0	0
SLLOVAKIA	5	0	5	0	0	0
Gjithsej	7,820	1535	1460	1255	1710	1860

Burimi: Eurostat

Tabela 34: Shtetasit kosovarë u gjetën të jenë të pranishëm me qëndrim të parregullt në shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, 2018 – 2022

Viti/shtetet	Gjithsej	2018	2019	2020	2021	2022
BELGIKA	255	70	80	25	40	40
BULLGARIA	25	5	0	0	15	5
ÇEKIA	70	20	15	10	15	10
DANIMARKA	35	20	5	5	0	5
GJERMANIA	9,240	2,460	2,165	1,690	1,265	1,660
ESTONIA	5	5	0	0	0	0
GREQIA	110	55	25	5	15	10
SPANJA	0	0	0	0	0	0
FRANCA	2,840	770	620	545	480	425
KROACIA	2,285	390	465	375	515	540
ITALIA	1,015	195	215	145	155	305
LUKSEMBURGU	35	5	5	15	5	5
HUNGARIA	1,635	285	330	325	415	280
HOLANDA	65	10	10	5	20	20
AUSTRIA	1,750	335	280	460	335	340
POLONIA	25	5	5	5	5	5
SLLOVENIA	595	40	40	25	240	250
FINLANDA	45	5	10	10	10	10
SUEDIA	160	55	0	35	20	50
LIHTENSHTAJNI	10	0	0	10	0	0
NORVEGJIA	145	50	35	15	15	30
ZVICRA	4,805	1,095	1,020	815	840	1,035

Burimi: Eurostat

Tabela 35: Shtetasit kosovarë të urdhëruar të largohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe zonës Schengen, 2018 – 2022

Viti/shtetet	Gjithsej	2018	2019	2020	2021	2022
BELGIKA	1,240	365	280	225	195	175
BULLGARIA	30	5	5	5	10	5
ÇEKIA	60	15	15	10	10	10
DANIMARKA	95	40	15	10	15	15
GJERMANIA	2,975	890	765	585	510	225
ESTONIA	5	5	0	0	0	0
IRLANDA	15	0	5	5	0	5

GREQIA	155	70	30	10	25	20
FRANCA	8,650	2,325	2,255	1,540	1,355	1,175
KROACIA	2,680	460	575	485	600	560
ITALIA	940	195	215	145	115	270
LUKSEMBURGU	105	45	15	20	10	15
HUNGARIA	535	280	65	60	75	55
HOLANDA	255	60	70	65	35	25
AUSTRIA	730	145	135	175	155	120
POLONIA	15	0	5	5	0	5
SLLOVENIA	2,400	150	540	340	435	935
FINLANDA	310	40	85	55	55	75
SUEDIA	1,065	270	215	195	145	240
NORVEGJIA	165	:	:	45	85	35
ZVICRA	1,760	450	450	310	260	290
MBRETËRIA E BASHUAR	120	55	65	:	:	:

Burimi: Eurostat

Tabela 36: Shtetasit kosovarë të larguar nga shtetet anëtare të BE-së dhe të zonës Schengen në bazë të urdhrorit për largim, 2018 – 2022

Viti/Shtetet	Gjithsej	2018	2019	2020	2021	2022
BELGJIKA	215	75	50	30	30	30
BULLGARIA	25	5	5	5	10	0
ÇEKIA	5	0	0	0	5	0
DANIMARKA	45	15	5	5	10	10
GJERMANIA	3,545	1,700	865	340	380	260
IRLANDA	5	0	0	5	0	0
GREQIA	70	25	25	5	5	10
FRANCA	1,020	300	290	100	190	140
KROACIA	1,805	300	400	275	385	445
ITALIA	190	50	65	30	10	35
LUKSEMBURGU	90	40	15	5	20	10
HUNGARIA	180	60	20	35	35	30
HOLANDA	75	25	20	10	15	5
AUSTRIA	790	190	210	125	135	130
POLONIA	5	0	0	5	0	0
SLLOVENIA	140	20	30	20	25	45

FINLANDA	125	25	30	20	25	25
SUEDIA	885	260	155	145	120	205
NORVEGJIA	45	:	:	15	15	15
MBRETËRIA E BASHKUAR	50	25	25	:	:	:

Burimi: Eurostat

Tabela 37: Numri i shtetasve kosovarë, azilkërkues të regjistruar për herë të parë në vendet e BE-së dhe zonës Schengen, 2018 - 2022

Viti/Shtetet	Gjithsej	2018	2019	2020	2021	2022
BELGJIKA	465	150	115	45	70	85
ÇEKIA	20	10	5	5	0	0
DANIMARKA	35	15	5	5	5	5
GREQIA	10	5	5	0	0	0
GJERMANIA	1,685	565	415	260	215	230
IRLANDA	75	10	20	15	5	25
FRANCA	7,295	2,160	2,000	865	855	1,415
KROACIA	20	5	5	5	0	5
ITALIA	950	0	0	140	280	530
LUKSEMBURGU	105	65	20	0	5	15
HOLANDA	160	35	55	40	20	10
AUSTRIA	185	50	40	25	40	30
SLLOVENIA	155	25	5	20	65	40
FINLANDA	30	10	10	0	10	0
SUEDIA	435	150	120	85	25	55
ISLANDA	10	5	5	0	0	0
LIHTENSHTAJNI	10	0	10	0	0	0
NORVEGJIA	35	5	15	5	5	5
ZVICRA	330	90	95	60	40	45
MBRETËRIA E BASHKUAR	45	20	25	:	:	:

Burimi: Eurostat

RIPRANIMI DHE RIINTEGRIMI I PERSONAVE TË RIPRANUAR

Tabela 38: Numri i personave të ripranuar me forcë, vullnetarë dhe vullnetarë të asistuar nga IOM, 2018/2022

Shtetet	ME FORCË	VULLNETAR	VULLNETARË IOM	Gjithsej
GJERMANI	2,755	166	881	3,802
FRANCË	619	44	0	663
ZVICËR	448	29	64	541
AUSTRI	145	14	225	384
SUEDI	213	2	0	215
BELGJIKË	91	10	71	172
LUXEMBURG	20	11	66	97
FINLANDË	24	3	21	48
NORVEGJI	41	1	4	46
KROACI	30	0	4	34
SHBA	30	2	0	32
GREQI	26	0	4	30
HOLANDË	5	6	18	29
ITALI	23	0	2	25
SLLOVENI	16	2	0	18
HUNGARI	14	0	4	18
MALI I ZI	17	0	0	17
BRITANI	11	2	0	13
DANIMARKË	10	0	0	10
MAQEDONI E VERIUT	9	0	0	9
RUMANI	6	0	2	8
ISLANDË	6	1	0	7
AUSTRALI	6	0	0	6
KANADË	5	1	0	6
NN	6	0	0	6
BEH	5	0	1	6
IRLANDË	0	0	4	4
SHQIPËRI	1	3	0	4
SPANJË	3	0	0	3
BULLGARI	0	3	0	3
REP. QEKE	2	0	0	2
TURQI	1	0	0	1
AZERBAJGJAN	0	1	0	1
ARUBA	1	0	0	1
KONGO	0	1	0	1
Gjithsej	4,589	302	1,371	6,262

Burimi: DSHAM

ANEKSI B - EMIGRIMI I SHETASVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË SHBA, 2008 - 2021

ABSTRAKT

Emigrimi gjatë historisë ka qenë një fenomen i vazhdueshëm për popullin shqiptarë e veçanërisht pas Luftës në Kosovë në fund të viteve të nëntëdhjeta. Arsyet e emigrimit ishin të natyrës ekonomike, politiko-ekonomike, lufte dhe socio-ekonomike. Pas luftës në Kosovë (1998-1999), emigrimi në pjesën më të madhe ka ndodhur për arsye socio-ekonomike, kryesisht drejt vendeve të BE-së dhe një pjesë në vendet jashtë kontinentit tonë, por një numër shkoi në SHBA. Gjatë hartimit të profileve të migrimit (të zgjeruar dhe të lehtë), asnjëherë nuk u trajtua tema e migrimit të kosovarëve në SHBA.

Qëllimi i kësaj analize është të paraqes një pasqyrë të të dhënave dhe statistikave për emigrimin e shtetasve kosovarë në SHBA. Emigrimi i shtetasve kosovarë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka qenë kryesisht përmes rrugëve të rregullta, duke përfshirë: bazën familjare, bazën e punësimit, lotarinë e vizave të diversitetit, statusin e refugjatit dhe azilit, vizave të përkohshme joemigruese dhe përmes programeve speciale.

Përkundër rrugëve të rregullta të migrimit, një numër i shtetasve kosovarë i janë nënshtruar zbatimit të Ligjit të Imigrimit në SHBA dhe janë përfshirë në kalime të paautorizuara kufitare tokësore, janë konsideruar të papranueshëm në kufi dhe janë deportuar.

Analiza bazohet në të dhënat dhe burimet e publikuara nga Departamenti i Sigurisë Kombëtare, Zyra e Statistikave të Imigrimit (shih referencën).

Fjalë kyçe: migrim, imigrim, emigrim, pranim i përkohshëm, pranime jo-imigruese, lejeqëndrimi të përhershme qëndrimi, natyralizim, emigrim i parregullt, azilkërkues.

SHKURTESAT

COVID-19 - CO për koronën, VI për virusin, D për sëmundjen dhe 19 për vitin që u njoh për herë të parë shpërthimi, në fund të vitit 2019

LPR - Leje e përhershme qëndrimi (lawful permanent resident)

INA - Immigration and Nationality Act - Ligji Kombëtar i Imigrimit

PKK – Pikat e Kalimit Kufitar

SHBA - Shtetet e Bashkuara të Amerikës

USCIS - Shërbimet e Shtetësisë dhe Imigrimit të SHBA

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
LISTA E TABELAVE	6
LISTA E FIGURAVE	8
SHKURTESAT	10
PARATHËNIE	12
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	14
STRUKTURA E AQM-SË	15
INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR SHTETIN	18
A POPULLSIA, MADHËSIA, VENDET FQINJE DHE GJATËSIA E KUFIJVE	18
IMIGRIMI I RREGULLT	20
IMIGRIMI I PARREGULLT	20
TRAFIKIMI ME QENIE NJERËZORE	21
AZILI DHE PËRCAKTIMI I STATUSIT TË MBROJTJES NDËRKOMBËTARE	21
EMIGRIMI I RREGULLT	21
EMIGRIMI I PARREGULLT	22
AZILKËRKUESIT KOSOVARË NË SHTETET E BE-SË DHE ZONËS SCHENGEN	22
RIPRANIMI DHE RIINTEGRIMI	23
MIGRIMI DHE ZHVILLIMI	23
MIGRIMI I BRENDSHËM	23
PERSONAT E ZHVENDOSUR BRENDIA VENDIT DHE JASHTË VENDIT (PZHBJV)	24
A.1. IMIGRIMI	24
A.1.1. IMIGRIMI I RREGULLT	24
A.1.2. POLITIKA / REGJIMI I VIZAVE	24
A.1.3. TË HUAJT ME QËNDRIM TË RREGULLT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS	26
LEJEQËNDRIMET E PËRKOSSHME	27
LEJEQËNDRIMET E PËRHERSHME	29
LEJE PUNE AFATSHKURTA	30
SHËRBBIMET E MIGRIMIT PËR ÇËSHTJE TË PUNËSIMIT	30
MIGRIMI I BRENDSHËM (LËVIZJA E QYTETARËVE BRENDIA TERRITORIT)	34
A.2. EMIGRIMI	50
A.2.1. KËRKESAT PËR VIZË NGA SHTETASIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS	50
A.2.2. LEJEQËNDRIMET E LËSHUARA PËR SHTETASIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS	52
A.2.3. LIRIMI I SHTETËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	54
A.2.4. EMIGRIMI I PARREGULLT	55
A.2.5. AZILKËRKUESIT KOSOVARË NË SHTETET E BE-SË DHE ZONËS SCHENGEN	63
KËRKESAT PËR AZIL NË MBRETERINË E BASHKUAR	67
A.3. RIPRANIMI DHE RIINTEGRIMI I PERSONAVE TË RIPRANUAR	69
B.1. NDIKIMI I MIGRIMIT NË ASPEKTIN DEMOGRAFIK	78
B.1.1. TREGUESIT BAZIK DEMOGRAFIK	78
B.1.2. RRJEDHAT DHE STOQET E MIGRIMIT	78
B.1.2. STOQET E MIGRIMIT	80

B.2. NDIKIMI I MIGRIMIT NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË VENDIT	81
B.2.1. SISTEMI FINANCIAR.....	83
B.2.2. TREGTIA	84
B.2.3. INVESTIMET E HUAJA DIREKTE	85
B.2.4. DËRGESAT E EMIGRANTËVE – REMITENCAT	86
B.3. NDIKIMI I MIGRIMIT NË ARSIM DHE ZHVILLIMIN E KAPITALIT NJERËZOR	88
B.4. NDIKIMI I MIGRIMIT NË PUNËSIM DHE TREGUN E PUNËS	89
B.5. NDIKIMI I MIGRIMIT NË NGRITJEN E MIRËQENIES SOCIALE	91
B.6. NDIKIMI I MIGRIMIT NË SISTEMIN SHËNDETËSOR	92
TRENDI EMIGRIMIT TË PERSONELIT MJEKËSOR.....	94
NUMRI I SHËRBIMEVE MJEKËSORE TË OFRUAR PËR SHTETASIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS JASHTË VENDIT	95
B.7. NDIKIMI I MIGRIMIT NË FUSHËN E MJEDISIT	95
C.1. KORNIZA E POLITIKAVE	97
C.2. KORNIZA LEGJISLATIVE DHE RREGULLATIVE	100
C.3. KORNIZA INSTITUCIONALE	108
C.4. BASHKËPUNIMI RAJONAL DHE NDËRKOMBËTAR	111
C.4.1. MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE BILATERALE DHE MULTILATERALE.....	111
C.4.2. INICIATIVAT RAJONALE DHE NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E MIGRIMIT	114
C.4.3. PROGRAMET/PROJEKTET NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E MIGRIMIT	115
D.1. TË GJETURAT KRYESORE LIDHUR ME TRENDET AKTUALE TË MIGRIMIT, POLITIKAVE TË MIGRIMIT, SI DHE NDIKIMIT TË MIGRIMIT	116
D.2. REKOMANDIMET LIDHUR ME KORNIZËN E QEVERISJES SË MIGRIMIT	117
D.3. REKOMANDIMET LIDHUR MË NDËRLIDHJEN E MIGRIMIT ME DOKUMENTET STRATEGJIKE ZHVILLIMORE (P.SH., STRATEGJIA KOMBËTARE ZHVILLIMORE)	117
D.4. REKOMANDIMET LIDHUR ME PËRMIRËSIMIN E STATISTIKAVE NË FUSHËN E MIGRIMIT, SI DHE POLITIKËBËRJEN BAZUAR NË TË DHËNA	119
REKOMANDIMET STRATEGJIKE	120
IMIGRIMI	122
IMIGRIMI PARREGULLT	124
MBROJTJA NDËRKOMBËTARE	125
EMIGRIMI	127
EMIGRIMI I PARREGULLT	129
RIPRANIMI DHE RIINTEGRIMI I PERSONAVE TË RIPRANUAR	133
ABSTRAKT	134
SHKURTESAT	135
PËRMBAJTJA	136
1. EMIGRIMI I RREGULLT I SHTETASVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË SHBA, 2008 – 2020	139

1.1 PRANIMI I PËRKOSSHËM I SHTETASVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË SHBA.....	140
1.2 NUMRI I SHTETASVE KOSOVARË ME PRANIM TË PËRKOSSHËM NË SHBA, 2014 – 2021	141
1.3 KATEGORITË E PRANIMIT TË PËRKOSSHËM TË SHTETASVE KOSOVARË NË SHBA.....	142
2. LEJEQËNDRIMI I PËRHERSHËM I LËSHUAR PËR SHTETASIT KOSOVARË NË SHBA 143	
2.1 LEJEQËNDRIMI I PËRHERSHËM "REZIDENT I PËRHERSHËM I LIGJSHËM"	144
2.2 STRUKTURA SIPAS MOSHËS, GJINISË DHE STATUSIT MARTESOR TË SHTETASVE KOSOVARË ME LEJEQËNDRIMI TË PËRHERSHËM ..	145
2.3 STRUKTURA SIPAS PROFESIONIT	146
2.4 LEJEQËNDRIMI I PËRHERSHËM I LËSHUAR SIPAS ARSYES.....	146
2.5 PREFERENCAT E SPONSORIZUARA NGA FAMILJA	147
2.6 PREFERENCAT E BAZUARA NË PUNËSIM.....	149
2.7 FAMILJAR I NGUSHTË I NJË SHTETASI AMERIKAN.....	149
2.8 DIVERSITETI	150
2.9 REFUGJATËT DHE AZILANTËT.....	150
2.10 TË TJERËT	151
2.11 LEJEQËNDRIMI I PËRHERSHËM I LËSHUAR SIPAS SHTETEVE TË SHBA-VE	151
3. NATYRALIZIMI I SHTETASVE KOSOVARË NË SHBA 152	
3.1 NUMRI I SHTETASVE KOSOVARË TË NATYRALIZUAR NË SHBA, 2008 - 2020	153
3.2 STRUKTURA SIPAS MOSHËS, GJINISË DHE STATUSIT MARTESOR.....	153
3.3 STRUKTURA SIPAS PROFESIONIT	155
3.4 NATYRALIZIMI PËR SHTETASIT KOSOVARË, SIPAS SHTETEVE TË SHBA-SË	155
4. EMIGRIMI I PARREGULLT I SHTETASVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË SHBA, 2009 – 2021 156	
4.1 NUMRI I SHTETASVE KOSOVARË SUBJEKT I ZBATIMIT TË LIGJIT TË IMIGRIMIT NË SHBA	156
4.2 SHTETASIT KOSOVARË TË CILËT JANË KAPUR NË KUFIT E SHBA-VE	157
4.3 SHTETASIT KOSOVARË TË CILËT JANË KONSIDERUAR SI TË PAPANUESHËM NË KUFIT E SHBA-VE	157
4.4 SHTETASIT KOSOVARË TË CILËT JANË LARGUAR NGA SHBA	158
5. AZILKËRKUESIT KOSOVARË NË SHBA, 2009 –2021 159	
5.1 NUMRI I AZILKËRKUESVE KOSOVARË NË SHBA, 2009 –2021	159
REFERENCAT E ANEKSIT A	162
REFERENCAT E ANEKSIT B	162

1. EMIGRIMI I RREGULLT I SHTETASVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË SHBA, 2008 - 2020

Emigrimi i rregullt i shtetasve kosovarë në Shtetet e Bashkuara i referohet, pranimit jo-imigrues ose pranimit të përkohshëm, procesit të marrjes së qëndrimit të përhershëm ose shtetësisë në Shtetet e Bashkuara për individët që dëshirojnë të jetojnë dhe punojnë përgjithmonë në Shtetet e Bashkuara. Qeveria e SHBA ofron disa rrugë drejt imigrimit të rregullt, duke përfshirë imigrimin me bazë familjare, imigrimin me bazë punësimi dhe vizat e lotarisë së diversitetit.

Imigrimi me bazë familjare u mundëson shtetasve amerikanë dhe atyre me qëndrim të përhershëm të sponsorizojnë anëtarët e ngushtë të familjes, duke përfshirë bashkëshortët, fëmijët, prindërit dhe vëllezërit e motrat, për të marrë qëndrimin e përhershëm në Shtetet e Bashkuara. Procesi zakonisht përfshin paraqitjen e një peticioni dhe dokumentacioni mbështetës, pjesëmarrjen në një intervistë dhe përmbushjen e disa kërkesave të përshtatshmërisë.

Imigrimi i bazuar në punësim i lejon punëdhënësit amerikanë të sponsorizojnë punëtorë të huaj për viza të përhershme qëndrimi ose pune të përkohshme, në varësi të aftësive dhe kualifikimeve të tyre. Procesi zakonisht përfshin marrjen e certifikatës së punës nga Departamenti i Punës i SHBA-së, paraqitjen e një peticioni në Shërbimet e Shtetësisë dhe Imigrimit të SHBA (USCIS) dhe përmbushjen e kërkesave të tjera të përshtatshmërisë.

Programi i Vizave Imigruese të Shumëllojshmërisë, i njohur gjithashtu si lotaria e kartës së gjelbër, ofron një numër të kufizuar vizash çdo vit për individët nga vendet me shkallë të ulët imigrimi në Shtetet e Bashkuara. Programi administrohet nga Departamenti Amerikan i Shtetit dhe kërkon që aplikantët të plotësojnë disa kërkesa të përshtatshmërisë dhe t'i nënshtrohen një procesi përzgjedhjeje të rastësishme.

Procesi i rregullt i imigrimit mund të jetë kompleks dhe kërkon kohë, dhe mund të përfshijë tarifa të konsiderueshme dhe kohë pritjeje. Pasi individët të marrin lejqëndrim të përhershëm, ata mund të jetojnë dhe punojnë përgjithmonë në Shtetet e Bashkuara dhe mund të kenë të drejtë të aplikojnë për shtetësi amerikane pas një periudhe të caktuar kohore.

Në përgjithësi, imigrimi i rregullt është një pjesë e rëndësishme e historisë dhe identitetit të Shteteve të Bashkuara, pasi ka mirëpritur miliona emigrantë nga e gjithë bota, të cilët kanë kontribuar në diversitetin social, kulturor dhe ekonomik të vendit.

1.1 Pranimi i përkohshëm i shtetasve të Republikës së Kosovës në SHBA

Pranimet jo-imigruese⁹⁰ në SHBA i referohen procesit të lejit të shtetasve të huaj që të hyjnë në Shtetet e Bashkuara në baza të përkohshme për një qëllim specifik si: turizmi, biznesi, arsimi ose puna. Pranimet jo-imigrante rregullohen nga ligjet dhe politikat e imigrimit të SHBA-së dhe jepen nga Departamenti i Shtetit i SHBA-së dhe Departamenti i Sigurisë Kombëtare të SHBA-së.

Për t'u kualifikuar për pranim jo-imigrues, shtetasit e huaj në përgjithësi duhet të plotësojnë disa kërkesa, duke përfshirë pasaportë valide të vlefshme, vizë (nëse kërkohet) dhe qëllim të miratuar për vizitën e tyre. Kërkesat specifike mund të ndryshojnë në varësi të llojit të kategorisë së vizës jo-imigruese. Ka shumë kategori të ndryshme të vizave jo-imigruese, duke përfshirë:

B-1/B-2 Vizat e Vizitorëve: për udhëtime të përkohshme biznesi ose turistike.

Viza (E1 deri në E3) - për tregtarët dhe investitorët e traktatit janë krijuar për të lehtësuar dhe përmirësuar ndërveprimin ekonomik midis Shteteve të Bashkuara dhe vendeve të tjera të traktatit.

Viza studentore F-1: për studime akademike në një institucion të akredituar të SHBA.

Vizat e profesionit të specialitetit H-1B: për punëtorë të kualifikuar në profesione të specializuara.

Vizat e vizitorëve të shkëmbimit J-1: për individët që marrin pjesë në programe shkëmbimi, të tilla si programe kërkimi, mësimdhënie ose trajnimi.

L-1 Viza për të transferuar brenda kompanive: për punonjësit e kompanive shumëkombëshe që transferohen për të punuar në SHBA.

⁹⁰ Çdo person në Shtetet e Bashkuara që nuk është shtetas ose shtetas i SHBA-së, i cili pranohet përkohësisht në Shtetet e Bashkuara për një qëllim specifik sipas një kategorie jo-emigruese siç përcaktohet nga seksioni 101 (a) (15) i Ligjit Kombëtar të Imigrimit (INA).

Procesi i marrjes së një vize jo-imigruese, mund të jetë komplekse dhe kërkon kohë. Zakonisht përfshin paraqitjen e një aplikacioni, sigurimin e dokumentacionit mbështetës dhe pjesëmarrjen në një intervistë në një ambasadë ose konsullatë të SHBA-së jashtë vendit.


Pas mbërritjes në SHBA, mbajtësit e vizave jo-imigruese duhet të respektojnë kushtet e pranimi të tyre, duke përfshirë kohëzgjatjen e qëndrimit, qëllimin e vizitës së tyre dhe çdo kufizim ose kusht tjetër të vendosur nga ligjet dhe politikat e imigrimit të SHBA-së.

Në përgjithësi, pranimet e jo-imigrantëve në SHBA, luajnë një rol kritik në lehtësimin e udhëtimit dhe tregtisë midis Shteteve të Bashkuara dhe vendeve të tjera, duke mbrojtur gjithashtu sigurinë dhe interesat kombëtare të SHBA.

1.2 Numri i shtetasve kosovarë me pranim të përkohshëm në SHBA, 2014 - 2021

Të dhënat për shtetasit kosovarë me pranim të përkohshëm në SHBA, janë të disponueshme që nga viti 2014. Gjatë periudhës së cekur sipas vendit të nënshtetësisë, rreth **36,894**, kosovarëve iu dha pranimi i përkohshëm apo u pranuan si jo-imigrues me një mesatare vjetore prej 4,600, persona në vit. Në periudhën 2014 - 2019, mesatarja e pranimi të përkohshëm të shtetasve kosovarë, ishte **5,367** persona, kurse gjatë 2 viteve të fundit u përgjysmua apo u zvoglua për 101% (shih Fig. 1). Arsyeja e rënies ishte situata mbarë botërore e pandemisë COVID-19, duke krijuar vështirësi të tilla si kufizimet e udhëtimit masat e ndërmarra në aspektin e kushteve shëndetësore dhe faktorëve tjerë.

Fig. 1. Pranimi i përkohshëm i shtetasve kosovarë, sipas viteve, 2014 - 2021




Burimi: Departamenti i Sigurisë Kombëtare, Zyra e Statistikave të Imigrimit.

1.3 Kategoritë e pranimit të përkohshëm të shtetasve kosovarë në SHBA

Kategoria më e përfaqësuar e pranimeve të përkohshëm të shtetasve kosovarë gjatë periudhës 2014 – 2021, ishin **vizitorë të përkohshëm** (turistë) të cilët përfaqësonin rreth dy të tretat ose 64% të pranimeve të përkohshëm dhe **vizitorë biznesi** që përbënin 8%. Të dy këto kategori të pranimit të përkohshëm i përkasin vizës (B1 dhe B2)⁹¹ dhe përfaqësonin 72%, të të gjitha pranimeve të përkohshme. **Studentët dhe shkëmbimi i vizitorëve**⁹² përbënin 15% të pranimeve të përkohshme. **Diplomatët dhe përfaqësuesit tjerë** përfaqësonin 8% të pranimeve kurse **punëtorët e përkohshëm dhe familjarët e tyre** përfaqësonin vetëm 3.5%, ndërsa të gjitha **kategoritë tjera** përbënin 1.5%, të pranimeve.

Fig. 2. Pranimi i përkohshëm i shtetasve kosovarë, sipas kategorive, 2014 – 2021



Burimi: Departamenti i Sigurisë Kombëtare, Zyra e Statistikave të Imigrimit.

1.4 Punëtorët e përkohshëm dhe familjet e tyre

Pranimet e punëtorëve të përkohshëm jo-imigrues i referohen hyrjes së punëtorëve të huaj në një vend mbi baza të përkohshme për qëllime punësimi. Këta punëtorë zakonisht mbajnë viza jo-emigruese që janë specifike për kategorinë e tyre të punësimit. SHBA ofron disa kategori vizash për punëtorët e përkohshëm, secila me kërkesat dhe kufizimet e veta specifike. Vizat e përkohshme të punëtorëve në SHBA zakonisht kanë periudha të veçanta vlefshmërie dhe

⁹¹ Vizat e vizitorëve, janë viza jo-emigruese për personat që duan të hyjnë përkohësisht në Shtetet e Bashkuara (kategoria e vizave B-1), për turizëm (kategoria e vizave B-2) ose për një kombinim të të dy qëllimeve (B-1/B-2).

⁹² Student dhe shkëmbimi i vizitorëve - janë të huaj që pranohen përkohësisht në SHBA përmes Programit të Shkëmbimit të Vizitorëve për të marrë pjesë në programet e përcaktuara nga Departamenti i Shtetit. Viza e shkëmbimit të vizitorëve J-1, është për programet e shkëmbimit arsimor dhe kulturor të përcaktuara nga Departamenti i Shtetit, Byroja e Çështjeve Arsimore dhe Kulturore. Shembuj të shkëmbimit të vizitorëve janë: trajnerët, profesorë apo studiuesit e ndryshëm, si dhe studentët.

zgatjet ose rinovimet mund të jenë të mundshme në varësi të kategorisë së vizave. Është e rëndësishme të theksohet se punëtorët e përkohshëm duhet t'u përmbahen kushteve dhe kufizimeve të kategorisë së tyre specifike të vizave, duke përfshirë ruajtjen e punësimit dhe statusit të vlefshëm gjatë qëndrimit të tyre.

Nga kategoria e punëtorëve të përkohshëm dhe familjet e tyre me origjinë kosovare, gjatë periudhës 2014 – 2021, sipas përqindjes kishte: **punëtorët me profesione të specializuara**⁹³ përfaqësonin 27%, **atletët, artistët dhe argëtuesit** përbënin 26%, **të transferuarit brenda kompanisë** 7%, **punëtorë me aftësi/arritje të jashtëzakonshme** 6%, **tregtarë apo investitorë të traktatit** 4% dhe më të përfaqësuarit ishin **nën të tjera** që përbënin rreth 30% e të gjithë punëtorëve të përkohshëm dhe familjet e tyre.

2. LEJEQËNDRIMI I PËRHERSHËM I LËSHUAR PËR SHTETASIT KOSOVARË NË SHBA

Lejeqëndrimi i përhershëm i lëshuar **nga autoritetet amerikane ose LPR** (lawful permanent resident) do të thotë "Rezident i përhershëm i ligjshëm" (në tekstin e mëtutjeshëm lejeqëndrimi i përhershëm ose LPR) dhe i referohet një shtetasi të huaj, të cilit i është dhënë e drejta për të qëndruar dhe punuar në mënyrë të përhershme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Statusi LPR njihet gjithashtu si mbajtës të "kartonit të gjelbër (green card)", pasi karta e gjelbër fizike është dëshmi e statusit të një personi që ka qëndrimin e përhershëm.

Për të marrë statusin LPR, një individ zakonisht duhet të kualifikohet sipas njëres prej kategorive të imigrimit të njohura nga ligjet e SHBA-së, si imigrimi me bazë familjare, imigrimi i bazuar në punësim ose statusi i refugjatit apo azilit. Procesi i aplikimit për marrjen e statusit LPR mund të jetë kompleks dhe përfshin dokumentacion të gjerë, kontrolle të historisë dhe intervista me autoritetet amerikane të imigrimit. Pasi një individ të marrë statusin LPR, ai ka të drejtë të qëndrojë dhe të punojë në Shtetet e Bashkuara në mënyrë të përhershme dhe mund të udhëtojë brenda dhe jashtë vendit për sa kohë që ata ruajnë statusin e tyre të qëndrimit të përhershëm. Mbajtësit e LPR-së, gjithashtu kanë të drejtë të aplikojnë për përfitime të caktuara federale, të tilla si Sigurimet Sociale dhe Shëndetësore, dhe mund të sponsorizojnë anëtarët e familjes për imigrim në Shtetet e Bashkuara. Ndërsa mbajtësit e LPR-

⁹³ Programi H-1B lejon kompanitë dhe punëdhënësit e tjerë në Shtetet e Bashkuara të punësojnë përkohësisht punëtorë të huaj në profesione që kërkojnë aplikimin teorik dhe praktik të një grupi njohurish shumë të specializuara dhe një diplomë bachelor ose më të lartë në specialitetin specifik, ose ekuivalentin e tij.

ve kanë shumicën e të drejtave të njëjta si shtetasit amerikanë, ka disa kufizime në të drejtat e tyre, të tilla si pamundësia për të votuar në zgjedhjet federale dhe mundësia e dëbimit për dënime të caktuara penale ose shkelje të tjera të ligjeve të imigrimit të SHBA.


Për ilustrim, autoritetet e SHBA-së në periudhën kohore 2012 – 2021, kanë lëshuar rreth **10 milionë** lejeqëndrimi të përhershme (LPR). 65% morën statusin e LPR si imigrantë të sponsorizuar nga familja dhe 15% nën preferencat e bazuara në punësim. Familjarë i menjëhershëm i një shtetasi amerikan gjatë periudhës së cekur përbënin kategorinë më të madhe të LPR-ve, duke përbërë 46% e numrit të përgjithshëm të LPR-ve. Numri më i lartë i lëshimeve të LPR-ve të reja për këtë periudhë ishin për shtetasit Meksikanë (14.5 %), Kinezë (6.8 %) dhe Indian nga India (6.6 %).

2.1 Lejeqëndrimi i përhershëm "Rezident i përhershëm i ligjshëm"

Të dhënat e regjistruara për periudhën 2010 – 2021, tregojnë se gjithsej **9,398**, lejeqëndrime të përhershme janë lëshuar për shtetasit kosovarë nga autoritetet e SHBA-ve, që i lejonin ata të qëndronin në mënyrë të përhershme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Numri i lejeqëndrimeve të përhershme përgjatë kësaj periudhe, vazhdoi me rënie dhe ngritje (Fig 3).

Gjatë kësaj periudhe mundë të veçojmë tri vite më të theksuara të numrit të fitimit të lejeve të ligjshme qëndrimi të përhershëm për shtetasit kosovarë, në vitin 2016 (ngritje prej rreth 20.2%, krahasuar me vitin 2015), 2017 dhe 2019, kurse kishte rënie në dy vitet e fundit, prej rreth - 45%, krahasuar viti 2021 me vitin 2019.

Fig.3. Lejeqëndrimi i përhershëm i lëshuar për shtetasit kosovarë, sipas vitit, 2010 - 2021




Burimi: Departamenti i Sigurisë Kombëtare, Zyra e Statistikave të Imigrimit.

2.2 Struktura sipas moshës, gjinisë dhe statusit martesor të shtetasve kosovarë me lejeqëndrimi të përhershëm

Të dhënat sipas moshës, gjinisë dhe statusit martesor janë të disponueshme nga viti 2014. Shpërndarja sipas gjinisë gjatë periudhës 2014 - 2021, tregon një mbizotërim të lehtë të gjinisë femrore (53 %, krahasuar me 47 % të gjinisë mashkullore), (Fig.4).

Fig.4. Shpërndarja sipas moshës dhe gjinisë të lejeqëndrimit të përhershëm lëshuara për shtetasit kosovarë, 2014 - 2021



Burimi: Departamenti i Sigurisë Kombëtare, Zyra e Statistikave të Imigrimit

Më shumë se gjysma e lejeqëndrimit të përhershëm për shtetasit kosovarë u lëshuan për grupmoshën 18 deri në 34 vjeç e cila përbënte 54.3%, grupmosha nën 18 vjeç ishte e përfaqësuar me 13%, grup mosha 35 deri në 44 vjeç me 12%, grupmoshat mbi 45 deri në 65 vjeç ishin të përfaqësuar nën 8%. Kryesisht emigruan të rinjtë e grupmoshave 25 deri në 44 vjeç të cilët përbënin 45%, (mosha kryesore riprodhuese në aspektin e fertilitetit dhe asaj të fuqisë punëtore) derisa, dominonte grupmosha 25 deri në 34 vjeç me 32.9%. (Tab.1)

Tab.1. Shpërndarja sipas moshës dhe gjinisë të lejeqëndrimit të përhershëm të lëshuara për shtetasit kosovarë, 2014 - 2021

Gjinia/nr. Përqindja	F		M	
	Numri	%	Numri	%
Gjithsej	3,626	100	3,124	100
Nën 18 vjeç	432	11.9	476	15.2
18 deri në 24 vjet	902	24.9	537	17.2
25 deri në 34 vjeç	1,139	31.4	1,081	34.6
35 deri në 44 vjeç	400	11	416	13.3
45 deri në 54 vjeç	281	7.7	226	7.3
55 deri në 64 vjeç	312	8.6	234	7.4
65 vjeç e lart	160	4.5	154	5


Burimi: Departamenti i Sigurisë Kombëtare, Zyra e Statistikave të Imigrimit

Sipas statusit martesor, rreth dy të tretave ose 64%, e të gjitha lejeve të qëndrimit të përhershëm për shtetasit kosovarë u lëshuan për të martuar, 31%, për beqarë, 4%, përfshin personat që janë të divorcuar ose për arsye të ndryshme kanë mbetur pa njërin partner, kurse 1%, janë të panjohur.

2.3 Struktura sipas profesionit

Sipas të dhënave të regjistruara nga viti 2014 e deri në vitin 2021, lejqëndrimi i përhershëm për shtetasit kosovarë sipas profesionit u lëshuan për profesione të panjohura në 37%, nuk ka profesion/nuk punon jashtë shtëpisë⁹⁴ në 26%, nxënës apo fëmijë 14%, të papunë 8%, profesionet menaxheriale, profesionale dhe të ngjashme 6%, profesione shërbimi 3%, shitjet dhe profesionet lidhur me punën nëpër zyra 2%, si dhe tjera me nga 4%, (Fig.5).

Fig.5. Shpërndarja sipas profesionit të lejqëndrimit të përhershëm të lëshuara për shtetasit kosovarë, 2014 - 2021




Burimi: Departamenti i Sigurisë Kombëtare, Zyra e Statistikave të Imigrimit.

2.4 Lejqëndrimi i përhershëm i lëshuar sipas arsyes

Të dhënat e lejqëndrimit të përhershëm të lëshuar për shtetasit kosovarë të paraqitura në (Fig.6), tregojnë arsyen kryesore pse është dhënë një lejqëndrimi i përhershëm. Klasifikimi sipas arsyeve përbëhet nga gjashtë kategori kryesore: **preferencat e sponsorizuara nga familja, preferencat e bazuara në punësim, familjar i ngushtë i një shtetasi amerikan, diversiteti, refugjatët dhe azilantët, të tjerët.**

⁹⁴ Profesionit i referohet llojit të punës së kryer gjatë periudhës së referencës nga personi i punësuar (ose lloji i punës së kryer më parë, nëse personi është i papunë), pavarësisht nga statusi i punësimit në të cilin personi duhet të klasifikohet. Profesionit përcaktohet në terma të vendeve të punës ose posteve.


Fig.6. Lejeqëndrimi i përhershëm i lëshuar për shtetasit kosovarë, sipas arsyes, 2010 - 2021



Burimi: Departamenti i Sigurisë Kombëtare, Zyra e Statistikave të Imigrimit.

Figura 7, tregon përqindjen e lejeqëndrimit të përhershëm të lëshuara për shtetasit kosovarë sipas arsyes. Pothuajse dy të tretat apo 68% e LPR-ve, ishin të ndërlidhura me bazë familjare (familjarë i ngushtë i një shtetasi amerikan dhe imigrantët me preferencë familjare). Sipas arsyeje së diversitetit 17%, shtetas kosovarë e morën lejeqëndrim të përhershëm. Preferencat bazuar në punësim dhe azilantët përfaqësonin 20%.

Fig.7. Përqindja e lejeqëndrimit të përhershëm i lëshuar për shtetasit kosovarë në SHBA, sipas arsyes, 2010 - 2021



Burimi: Departamenti i Sigurisë Kombëtare, Zyra e Statistikave të Imigrimit

2.5 Preferencat e sponsorizuara nga familja

Termi preferencë përdoret në Ligjin Kombëtar të Imigrimit (SHBA) për të përcaktuar kategoritë prioritare të familjes dhe punësimin numerikisht të kufizuar për statusin e

lejeqëndrimit të përhershëm (LPR). Ligji Kombëtar i Imigrimit (INA - Immigration and Nationality Act) specifikon nivelin mbarëbotëror të imigrimit të preferencës në grupimet e mëposhtme.


Ligji Kombëtar i Imigrimit në SHBA për sponsorizimin familjar **lejon shtetasit e Shteteve të Bashkuara dhe personat me lejeqëndrim të përhershëm** të sponsorizojnë të afërm të caktuar për qëndrim të përhershëm në Shtetet e Bashkuara. Të afërmit që janë caktuar si të kualifikuar për qëndrim të përhershëm të sponsorizuar nga familja, janë grupuar në klasifikime të ndryshme⁹⁵. Kufiri vjetor për preferencat e sponsorizuara nga familja varet nga nivelet e imigrimit të vitit të kaluar dhe është vendosur në një minimum prej 226,000 persona.

Në periudhën 2010 - 2021, u lëshuan gjithsej **2,577**, lejeqëndrime të përhershme (LPR), me preferencat e sponsorizuara nga familja për shtetasit kosovarë që i lejonin ata të qëndronin në mënyrë të ligjshme në SHBA. Periudha 2017 - 2021, u ndikua me norma të larta të rritjes krahasuar me periudhën 2010 - 2016, ku normat me tendenca të rritjes ishin numerikisht pothuajse dyshifrore. Norma më e lartë e rritjes u regjistrua në vitin 2017, ku LPR - me preferencat e sponsorizuara nga familja u rritën për rreth katër herë (310,7 %), krahasuar me një vit më parë (Fig. 8). Viti 2019, shënoi rritjen e dytë më të lartë por nën nivelin e vitit 2017.

⁹⁵ Preferencat e sponsorizuara nga familja përbëhen nga katër kategori të afërmish:

- Preferenca e parë (F-1), djemtë dhe vajzat e pamartuara të një shtetasi amerikan (21 vjeç e lart) dhe fëmijët e tyre;
- Preferenca e dytë, bashkëshorti dhe fëmijët e një personi me lejeqëndrim të përhershme LPR (F-2A), ose djemtë dhe vajzat e pamartuara të personit në fjalë (21 vjeç e lart) dhe fëmijët e tyre (F-2B);
- Preferenca e tretë (F-3), djemtë dhe vajzat e martuara të një shtetasi amerikan dhe bashkëshortët dhe fëmijët e tyre;
- Preferenca e katërt (F-4), vëllezërit e motrat e një shtetasi amerikan (nëse shtetasi është 21 vjeç e lart) dhe bashkëshortët dhe fëmijët e tyre.

Fig.8. Lejeqëndrimi i përhershëm i lëshuar për shtetasit kosovarë në SHBA, sipas dy mënyrave të fitimitit, 2010 - 2021



Burimi: Departamenti i Sigurisë Kombëtare, Zyra e Statistikave të Imigrimit

2.6 Preferencat e bazuara në punësim

Në vitin 1990, Kongresi i SHBA-së, krijoi një sistem prioritar për dhënien e qëndrimit të përhershëm për të huajt bazuar në aftësitë e punësimit. Çdo vit, 140,000 viza imigrimi janë në dispozicion për të huajt që kualifikohen sipas pesë kategorive të preferencave të bazuara në punësim (EB)⁶.

Sipas preferencave të bazuara në punësim për shtetasit kosovarë, numri i përgjithshëm i lejeve të qëndrimit të përhershme (LPR), gjatë periudhës së cekur ishte gjithsej 900 persona. Të dhënat e regjistruara mund t'i ndajmë në dy periudha të dhënies së lejeve të qëndrimit të përhershme. Periudha 2010 - 2016, u ndikua me një numër dukshëm më të vogël e cila përbënte 9%, e të gjitha lejeve të qëndrimit të përhershme me preferencave bazuar në punësim, krahasuar me periudhën 2017 - 2021, e cila kishte një numër dukshëm më të madh dhe përbënte 91%. **Rritjet më të shpejta u regjistruan nga viti 2017 - 2019**, ku lejeqëndrimi të përhershme (LPR) - me preferencave të bazuara në punësim u rriten për rreth tetë fish, krahasuar me periudhën 2010 - 2016, (Fig. 7).

2.7 Familjar i ngushtë i një shtetasi amerikan

Kategoria më e përfaqësuar e lejeqëndrimit të përhershëm (LPR) në SHBA, përbëhet nga familjar i ngushtë i shtetasve amerikanë. Familjar i ngushtë i një shtetasi amerikan sipas Ligjit Kombëtar të Imigrimit (INA), konsiderohet një i huaj që është bashkëshorti ose fëmija i një

⁶ E1 - Punëtorët me përparësi; E2 - Profesionistë me Diploma të Avancuara dhe Persona me Aftësi të Jashtëzakonshme; E3 - Punëtorë të kualifikuar, profesionistë dhe punëtorë të pakualifikuar (punëtorë të tjerë).

shtetasi të Shteteve të Bashkuara ose një prind i një shtetasi amerikan i cili është i moshës të paktën 21 vjeç.

Familjarët e ngushtë të shtetasve amerikanë nuk i nënshtrohen kufizimeve numerike dhe zakonisht llogariten për mbi 40% të LPR-ve të reja në vit.

Gjatë periudhës së cekur më lartë autoritetet amerikane statusin e lejeqëndrimit të përhershëm (LPR), për arsye familjar i ngushtë i shtetasve amerikanë, i dhanë **3,279** personave me shtetësi kosovare, kjo përbënte rreth 35%-shin ose pjesën më të madhe të të gjitha lejeqëndrimeve të përhershme (LPR) apo "Rezident i përhershëm i ligjshëm". Periudha 2010 - 2016, u ndikua me një numër të konsiderueshëm e cila përfaqësonte 94%, e të gjitha lejeve të qëndrimit të përhershme për arsye familjar i ngushtë i shtetasve amerikanë, krahasuar me periudhën 2017 - 2021, e cila kishte një numër dukshëm më të vogël dhe përbënte 9%. Viti 2016, shënoi rritjen më të lartë, prej 605 lejeqëndrimi të përhershme (LPR), për arsye familjar i ngushtë i shtetasve amerikanë (shih Fig 7).

2.8 Diversiteti

Programi i vizave imigruese të diversitetit u ofron individëve nga vendet e ndryshme, mundësi për të aplikuar për vizë dhe qëndrim të përhershëm (fitimin e kartës së gjelbërt) në SHBA. Në SHBA çdo vit lëshohen, rreth 55,000 viza të diversitetit.

Sipas programit të vizave imigruese të diversitetit, që nga viti 2010 e deri në fund të vitit 2021, gjithsej 1 636 shtetas kosovarë morën statusin qëndrim të përhershëm apo kartonin e gjelbërt. Gjatë kësaj periudhe numri më i lartë i marrjes së statusit të qëndrimit të përhershëm në bazë të diversitetit ishte në vitin 2017 (303), në vitin 2013 u regjistruan (166), vitin 2011 (126) dhe në vitin 2012 (116), (Fig. 7).

2.9 Refugjatët dhe azilantët

Kjo pjesë është paraqitur nën "Azilkërkuesit kosovarë në SHBA, 2009 - 2021" dhe paraqet numrin e azilkërkuesve kosovarë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të gjithë atyre që iu

është konfirmuar dhënia e azilit afirmativ, si dhe u është dhënë azili mbrojtës⁹⁷. Të dhënat për refugjat⁹⁸ me origjinë nga Republika e Kosovës nuk janë gjetur.

2.10 Të tjerët


Ligji i Imigrimit në SHBA, parashikon një sërë kategorish tjera të huajsh që kanë të drejtë të marrin vizën për të hyrë ligjërisht në Shtetet e Bashkuara për një periudhë të kufizuar kohore. Këta mbajtës të vizave klasifikohen si jo-imigrantë dhe mund të jenë: pushues, studentë, punëtorë të klasifikuar të përkohshëm dhe një sërë kategorish të specializuara, viktimat të trafikimit, të huaj pa dokumente. Disa nga këta të huaj mund të ndërmarrin veprime të caktuara për të fituar statusine LPR-ve, në bazë të Ligjit të Imigrimit.

Në bazë të kësaj kategorie, gjatë periudhës 2010 - 2021, gjithsej 9 shtetas kosovarë morën statusin e qëndrimit të përhershëm, (Fig. 7).

2.11 Lejeqëndrimi i përhershëm i lëshuar sipas shteteve të SHBA-ve

Ndër dhjetë shtetet e SHBA-ve, që regjistruan numrin më të lartë të lëshimit të lejeqëndrimeve të përhershme ishin: Nju Jork - 3,606, New Jersey - 556, Teksas - 546, Illinois - 540, Michigan - 469, Konektikat - 426, Florida - 411, Pensilvani - 291, Massachusetts - 244, Kaliforni - 200, Shtetet e tjera - 1 897.

Fig.9. Përqindja e lejeve të qëndrimit të përhershme të lëshuara për shtetasit kosovarë, sipas shteteve, 2010 - 2021



⁹⁷ Një kërkesë mbrojtëse për azil, bëhet për moslargimin nga Shtetet e Bashkuara. Që procesi i kërkesës për azil të jetë mbrojtës, personi duhet të jetë në procedurat e largimit në gjykatën e imigrimit me Zyrën Ekzekutive për Imigrim.

⁹⁸ Refugjatët janë individë që janë detyruar të largohen nga vendet e tyre për shkak të persekutimit, luftës ose dhunës për shkak të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një vend të caktuar, grup shoqëror, apo për shkak të pikëpamjeve politike dhe u është dhënë statusi i refugjatit nga Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR). Më pas ata kanë të drejtë të aplikojnë për rivendosje në një vend tjetër, ku mund të jetojnë dhe punojnë si banorë të ligjshëm.

Në përgjithësi, një i huaj duhet të kalojë të paktën 5 vjet si rezident i përhershëm i ligjshëm për t'u kualifikuar për natyralizim, ndërsa bashkëshorti i një shtetasi amerikan duhet të kalojë të paktën 3 vjet si rezident i përhershëm i ligjshëm³. Personat e natyralizuar në përgjithësi në periudhën kohore 2008 – 2021, kalojnë një mesatare prej shtatë vitesh në statusin LPR ,përpara se të bëhen shtetas amerikanë.

3. NATYRALIZIMI I SHTETASVE KOSOVARË NË SHBA

Natyralizimi në SHBA është procesi me të cilin një shtetas i huaj bëhet shtetas i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Me natyralizimin shtetasit e huaj përfitojnë të njëjtat të drejta dhe privilegje si shtetasit e lindur në SHBA, duke përfshirë të drejtën e votës dhe mundësinë për të udhëtuar me pasaportë amerikane.

Për t'u kualifikuar për natyralizim në SHBA, një individ duhet të plotësojë disa kërkesa, duke përfshirë:


- Të jetë të paktën 18 vjeç;
- Të ketë qëndrim të ligjshëm të përhershëm (mbajtës i kartonit të gjelbërt) për të paktën 5 vjet (ose 3 vjet nëse është i martuar me një shtetas amerikan);
- Të jetë fizikisht i pranishëm në Shtetet e Bashkuara për të paktën gjysmën e periudhës së kërkuar të qëndrimit;
- Demonstrimi i karakterit të mirë moral;
- Kalimi i testit të gjuhës angleze dhe qytetarisë;
- Procesi i natyralizimit përfshin plotësimin e një aplikimi, dorëzimin e dokumentacionit mbështetës, pjesëmarrjen në një intervistë dhe dhënien e një betimi për besnikëri ndaj Shteteve të Bashkuara.

Natyralizimi në SHBA është një proces i rëndësishëm që u lejon shtetasve të huaj të integrohen plotësisht në shoqërinë amerikane dhe të marrin pjesë në institutet demokratike të vendit. Numri i personave të natyralizuar në SHBA, mesatarashisht për çdo vit gjatë periudhës 2008 – 2020, ka qenë rreth 800,000.00.

3.1 Numri i shtetasve kosovarë të natyralizuar në SHBA, 2008 - 2020

Gjatë periudhës 2008 - 2021, gjithsej **6,569** persona me origjinë kosovare, morën shtetësinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Gjatë kësaj periudhe numri më i madh i marrjes së shtetësisë amerikane u regjistrua në vitin 2021 (622), vitin 2019 (597) dhe në vitin 2010 (590), (Fig. 10). Numri mesatar vjetor i personave të natyralizuar me origjinë kosovare ishte 469.2, persona.

Fig.10. Personat e natyralizuar me origjinë kosovare, sipas viteve, 2008 – 2021



Burimi: Departamenti i Sigurisë Kombëtare, Zyra e Statistikave të Imigrimit

3.2 Struktura sipas moshës, gjinisë dhe statusit martesor

Struktura e shtetasve kosovarë të natyralizuar mund të ndryshojë për sa i përket moshës, gjinisë dhe statusit martesor. Grupmosha 25 deri në 44 vjeç ishte më e përfaqësuar pasi që kërkojnë të forcojnë lidhjet e tyre me vendin dhe të gëzojnë përfitimet dhe të drejtat e nënshtetësisë, të tilla si votimi dhe kualifikimi për disa programe qeveritare. Një numër i të moshuarve të grupmoshës 55 vjeç e më lartë janë individë të cilët kanë banuar në SHBA për një periudhë të konsiderueshme kohore dhe dëshirojnë të sigurojnë statusin e tyre si shtetas. Gjinia e shtetasve kosovarë të natyralizuar ishte relativisht e ekuilibruar, me meshkuj dhe femra. Sa i përket statusit martesor në disa raste, njëri bashkëshort mund të ketë qenë tashmë shtetas, ndërsa bashkëshorti tjetër zgjedh të bëhet shtetas i natyralizuar për të forcuar statusin e tij ligjor ose për arsye personale.

Mosha

Në periudhën kohore 2008 - 2021, të dhënat sipas moshës (për dy gjinitë) tregojnë se rreth 42% e personave me origjinë kosovare që fituan shtetësinë e SHBA-ve, ishin të moshës 25 deri në 34 vjeç, rreth 26% ishin 35 deri në 44 vjeç, rreth 11% të moshës 18 deri në 24 vjeç, rreth 10% të moshës 45 deri në 54 vjeç , rreth 6% të moshës 55 deri në 64 vjeç dhe rreth 5% të moshës 65 vjeç e lart.

Tab. 2. Numri i personave të natyralizuar me origjinë kosovare sipas gjinisë dhe moshës: 2008-2021

Gjinia/nr. Perqindja	F		M	
	Numri	%	Numri	%
Gjithsej	3,249	100	3,303	100
18 deri në 24 vjet	392	12.1	347	10.5
25 deri në 34 vjeç	1,389	42.7	1,364	41.3
35 deri në 44 vjeç	795	24.5	897	27.2
45 deri në 54 vjeç	289	8.8	345	10.4
55 deri në 64 vjeç	230	7.1	194	5.8
65 vjeç e lart	154	4.8	156	4.8

Burimi: Departamenti i Sigurisë Kombëtare, Zyra e Statistikave të Imigrimit.

Gjinia

Sipas gjinisë, natyralizimit i personat me origjinë kosovare në SHBA, tregon një mbizotërim të lehtë të gjinisë femrore (52 %, krahasuar me 48 % të gjinisë mashkullore), veçanërisht për grupmoshat 25 - 34 vjeç (41% meshkuj) dhe 25-34 vjeç (42 % femra). Ky dominim i gjinisë femrore u përcoll në të gjitha vitet që nga viti 2008, përveç në vitet 2013 kur meshkujt kishin një rritje të lehtë prej 3.8% dhe në vitin 2018, ku meshkujt dominonin me një rritje prej 6.6%, krahasuar me gjininë femrore.

Statusi martesor

Sipas statusi martesor, më shumë se gjysma (57 % ose 3,395) e personave të natyralizuar ishin të martuar, kurse të pa martuar (beqarë) ishin (41% ose 2532) dhe 5% të tjera (Tab 3).

Tab. 3. Numri i personave të natyralizuar me origjinë kosovare, sipas gjendjes martesore, 2019-2021

Gjendja martesore	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Gjithsej	397	590	465	510	487	392	547	530	410	410	451	597	482	622
I/e martuar	120	177	130	122	107	89	426	399	322	322	351	450	380	467

Beqar/e	263	381	317	358	361	282	95	102	68	68	62	105	70	98
Të tjera	13	29	17	29	19	21	26	29	19	19	36	37	31	51
E panjohur	1	3	1	1	0	0	0	0	1	1	2	5	1	6

Burimi: Departamenti i Sigurisë Kombëtare, Zyra e Statistikave të Imigrimit.


3.3 Struktura sipas profesionit

Nga numri i përgjithshëm i të gjithë personave të natyralizuar me origjinë kosovare, 27% nuk kishin asnjë profesion dhe nuk punon jashtë shtëpisë (punë në fabrikë, restorant, ndërtesë zyre etj), 17% kishin profesione të shërbimit të cilat janë të pranishme në të gjithë sektorët e ekonomisë (punë që përfshin ofrimin e një shërbimi për një person ose kompani), 13% kishin profesione të prodhimit, transportit dhe lëvizjes së materialit⁹⁹, 11% ishin të pa punë, 9% kishin profesione menaxheriale, profesionale dhe të ngjashme, 23% ishin të tjera.

3.4 Natyralizimi për shtetasit kosovarë, sipas shteteve të SHBA-së

Nga numri i përgjithshëm i të gjithë personave të natyralizuar me origjinë nga Republika e Kosovës, më shumë se gjysma (3 677 ose 54%), qëndronin në katër shtete të SHBA-ve: Nju Jork - 2 453, Teksas - 429, Michigan - 406, Illinois - 348, Nju Xhersi - 389, kurse (3 113 ose 46%) në shtetet tjera të SHBA-ve.

Fig. 11. Përqindja e marrjes së shtetësisë, sipas shteteve të SHBA-së, 2010 - 2021



Burimi: Departamenti i Sigurisë Kombëtare, Zyra e Statistikave të Imigrimit

⁹⁹ Profesionet e lëvizjes së materialeve përfshijnë operatorët e transportuesit, operatorët industrialë të kamionëve dhe traktorëve dhe profesionet e lidhura me logjistikën. Këta punëtorë janë të punësuar në një shumëllojshmëri të gjerë industrish. Ata kanë një rol integral në shpërndarjen e materialeve ose furnizimeve për prodhuesit ose tregjet me pakicë. Puna e tyre mund të klasifikohet si e operatorëve ose e punëtorëve. Operatorët janë të përfshirë në trajtimin dhe manovrimin e makinerive specifike. Punëtorët, nga ana tjetër, ndihmojnë në transportimin manual të materialeve ose pajisjeve të pastrimit.

4. EMIGRIMI I PARREGULLT I SHTETASVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË SHBA, 2009 - 2021

Imigrimi i parregullt në këtë analizë i referohet migrimit të personave që hyjnë në SHBA, pa autorizimin e duhur ose skadimit të vizave të tyre.


Migrimi i parregullt në Shtetet e Bashkuara paraqet sfida komplekse. Adresimi i këtyre sfidave kërkon një qasje të shumanshme që merr parasysh faktorët ekonomik, social, politik dhe të sigurisë.

Një nga sfidat kryesore të migrimit të parregullt është mungesa e statusit ligjor, gjë që e bën të vështirë për migrantët aksesin e shërbimeve bazë si kujdesi shëndetësor dhe arsimit. Kjo mund të çojë në shfrytëzim nga punëdhënësit dhe akses të kufizuar në shërbimet sociale, duke kontribuar në varfëri dhe marginalizim. Imigrimi i parregullt gjithashtu ngre shqetësime për sigurinë kombëtare dhe sigurinë publike. Kritikët argumentojnë se lejimi i migrantëve pa dokumente për të hyrë në vend pa verifikimin e duhur përbën një rrezik për sigurinë e shtetit.

4.1 Numri i shtetasve kosovarë subjekt i zbatimit të Ligjit të Imigrimit në SHBA

Të dhënat e regjistruara tregojnë se gjatë periudhës 2009 - 2021, gjithsej 467 - shtetas kosovarë janë kapur në kufit e SHBA-ve, gjatë periudhës 2012 - 2021, gjithsej 220 - shtetas kosovarë janë konsideruar si të papranueshëm në kufit e SHBA-ve dhe gjatë periudhës 2009 - 2021, gjithsej 222 - shtetas kosovarë janë larguar nga SHBA.

Fig.12. Shtetasit kosovarë të cilët kanë qenë subjekt i zbatimit të ligjit të imigrimit, 2009 - 2021



Burimi: Departamenti i Sigurisë Kombëtare, Zyra e Statistikave të Imigrimit.

Figura 12, ofron një përmbledhje të dhënave të disponueshme për shtetasit kosovarë të cilët kanë qenë subjekt i zbatimit të Ligjit të Imigrimit në SHBA ndër vite: shtetasit kosovarë të cilët janë kapur në kufit, janë konsideruar si të papranueshëm në kufi apo janë larguar nga SHBA.

4.2 Shtetasit kosovarë të cilët janë kapur në kufit e SHBA-ve

Gjatë periudhës 2009 – 2021, përqindja e shtetasve kosovarë të cilët janë kapur¹⁰⁰ për shkak se nuk mund të justifikonin hyrjen e ligjshme në kufijtë e Shtetet e Bashkuara apo në brendi të vendit, si dhe në vende të caktuara jashtë Shteteve të Bashkuara, në periudhën 2009 - 2021, përbënte më shumë se gjysmën apo 51%, e shtetasve kosovarë të cilët kanë qenë subjekt i zbatimit të Ligjit të Imigrimit në SHBA.

Në këtë periudhë kohore, numri maksimal i kapur ndodhi në vitin 2017 (67) përpara se të binte në mënyrë progresive në vitet 2018 (63), 2019 (47) dhe 2020 (41). Numër më të ulët se mesatarja (35.7 persona), pati gjatë gjithë viteve tjera.


4.3 Shtetasit kosovarë të cilët janë konsideruar si të papranueshëm në kufit e SHBA-ve

Një person është i papranueshëm kur nuk është në gjendje të justifikoj hyrjen, pranimin ose status të rregullt në SHBA, për shkak të një veprim joligjor ose të ndonjë keqbërje të mëparshme. Individët që i nënshtrohen rregullave të papranueshmërisë përfshijnë të huajt, të cilët: hynë në vend në formë të parregullt, individë të liruar me kusht në SHBA ose shtetas të huaj që kanë mbërritur në kufirin ose portin e hyrjes dhe të cilët kërkojnë hyrje.

Disa nga arsyet e papranueshmërisë përfshijnë: kërcënim për shëndetin publik, arsyet penale dhe të ngjashme, kërcënim për sigurinë publike, shkeljet e certifikimit të punës/punësimit, hyrjet e paligjshëm dhe shkeljet e rregullave të imigrimit, shkeljet lidhur me dokumentacionin dhe kategori të tjera individësh si poligamistët, rrëmbyesit ndërkombëtarë të fëmijëve etj.

¹⁰⁰ Doganat dhe Mbrojtja e Kufirit (CBP) të SHBA-ve, përkufizojnë kapjen si “kontroll fizik ose ndalim i përkohshëm i një personi që nuk është ligjërisht në SHBA dhe i cili mund ose nuk mund të rezultojë në një arrestim” shih <https://www.cbp.gov/newsroom/stats/cbp-enforcement-statistics>.

Fig.13. Përqindja e shtetasve kosovarë të cilët kanë qenë subjekt i zbatimit të ligjit të imigrimit, 2009 – 2021



Burimi: Departamenti i Sigurisë Kombëtare, Zyra e Statistikave të Imigrimit.

Për shtetasit kosovarë të cilët janë konsideruar si të papranueshëm në kufit e SHBA-ve, të dhënat e disponueshme figurojnë nga viti 2012. Shtetasit kosovarë të cilët u konsideruan si të papranueshëm në kufit e SHBA-ve, gjatë kësaj periudhe përbënin 24%, të gjithë shtetasve kosovarë të cilët kanë qenë subjekt i zbatimit të Ligjit të Imigrimit në SHBA, (Fig. 13).

Numri i paraqitur i shtetasve kosovarë të cilët u konsideruar si të papranueshëm në kufijtë e SHBA -ve, u rrit në vitet 2014 (26), 2015 (28) dhe 2017 (28) për të arritur kulmin në vitin 2018 (30) dhe më pas ra ndjeshëm në 2019, dhe vazhdoi të bjerë në 2021 (13). Çdo shtetas i huaj që rezulton i papranueshëm ose klasifikohet për deportim sipas arsyeve të përcaktuara me Ligjin Kombëtar të Imigrimit (INA), mund të urdhërohet që të largohet. Ligji në fjalë përcakton procedurat e largimit apo të moslargimit.

4.4 Shtetasit kosovarë të cilët janë larguar nga SHBA

Ligji Kombëtar i Imigrimit (INA), lejon largimin të shtetasve të huaj nga Shtetet e Bashkuara të cilët kanë hyrë në mënyrë të parregullt, dokumente të falsifikuara apo të huaj që hyjnë në mënyrë të rregullt por i kalojnë afatet e vizave të tyre të përkohshme, si dhe veprime tjera që nuk janë të lejuara me ligjet e SHBA-ve.

Pas një urdhri për largim, një i huaj është i papranueshëm për të paktën pesë vjet pas datës të largimit dhe nuk ka të drejtë të kthehet në Shtetet e Bashkuara gjatë kësaj periudhe.

Shtetasit kosovarë të cilët janë larguar nga SHBA, përbënin 25%, të gjithë shtetasve kosovarë të cilët kanë qenë subjekt i zbatimit të ligjit të imigrimit në SHBA. Pesëdhjetë e tre për qind e largimeve të kësaj kategorie gjatë periudhës (Fig.12), ishin me dënime të mëparshme penale, krahasuar me katërdhjetë e shtatë për qind të largimeve të cilat nuk kishin ndonjë prapavijë kriminale.

Më shumë se gjysma e të gjitha largimeve (51%), u bënë në periudhën 2009 – 2013, (numri më i madh i të larguarve ishte në vitin 2011 (29) dhe në vitin 2012 (27)). Pas kësaj perudhe numri i të larguarve pësoi rënje për tu ngritur më pas për mbi mesatren (17.07), në vitin 2020 (19).

5. AZILKËRKUESIT KOSOVARË NË SHBA, 2009 –2021

Dhënia e të drejtës së azilit në SHBA, mundëson disa kategori personash të kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare. Zakonisht, kjo mundësi shtrihet tek personat që kanë lënë vendet e tyre të origjinës dhe kërkojnë mbrojtje në një vend tjetër, por nuk u është dhënë ende statusi i refugjatit ose azilit. Ata mund të jenë persona që ikin nga lufta, dhuna në vendet e tyre ose persekutimi për shkak të përkatësisë së tyre etnike, anëtarësimi në një grup të caktuar shoqëror apo pikëpamjeve politike, kombësisë, racës ose fesë¹⁰¹.

Azilkërkuesit shpesh paraqiten në PKK ose aplikojnë për azil pasi të kenë hyrë në një vend. Procesi i kërkimit të azilit mund të jetë kompleks dhe i gjatë, dhe mund të ketë ndryshime të konsiderueshme në procedurat dhe kërkesat e vendeve të ndryshme. Disa vende kanë kritere strikte pranueshmërie dhe mund të refuzojnë aplikimet nga individë që nuk plotësojnë kërkesat specifike ligjore.

Në përgjithësi, azilkërkuesit kanë të drejtën e mbrojtjes sipas Ligjit Ndërkombëtar dhe duhet të trajtohen me dinjitet dhe respekt, pavarësisht nga rezultati i aplikimit të tyre për azil.

5.1 Numri i azilkërkuesve kosovarë në SHBA, 2009 –2021

Në SHBA, ekzistojnë dy mundësi të përgjithshme për kualifikimin e azilit – azili afirmativ dhe azili mbrojtës. **Azili afirmativ**, është procesi përmes të cilit një i huaj që ndodhet fizikisht në Shtetet e Bashkuara dhe aktualisht nuk është në procedurat e largimit, aplikon për azil përmes

¹⁰¹ Azilkërkuesi është një person që plotëson përkufizimin e refugjatit dhe është tashmë i pranishëm në Shtetet e Bashkuara ose po kërkon praninë në një port hyrje. Refugjatëve u kërkohet të aplikojnë për statusin e qëndrimit të përhershëm të ligjshëm ("kartën e gjelbërt") një vit pas pranimit kurse azilantët mund të aplikojnë për statusin e kartës së gjelbërt një vit pas dhënies së azilit.

Shërbimit të Shtetësisë dhe Imigrimit (USCIS). Kjo vlenë, vetëm për ata persona të cilët ende nuk janë deportuar nga vendi.


Azili mbrojtës, është procesi përmes të cilit një i huaj në procedurat e largimit aplikon për azil te një gjyqtar imigrimi (immigration judge) në gjykatën e imigrimit si mbrojtje kundër largimit nga Shtetet e Bashkuara. Kjo i referohet personave të cilët do të duhen të mbrohen nga dëbimi nga SHBA, persona të tillë duhet të mbrohen në gjykatën e imigrimit në Zyrën Ekzekutive të Imigrimit (Executive Office for Immigration) të SHBA-së.

Shtetet e Bashkuara ofrojnë mbrojtje për persona të caktuar që janë persekutuar ose kanë një frikë të bazuar nga persekutimi përmes dy programeve: një program refugjatësh për personat jashtë Shteteve të Bashkuara dhe të afërmit e tyre dhe një program azili për personat fizikisht të pranishëm ose që mbërrijnë në Shtetet e Bashkuara dhe të afërmit e tyre.

Gjatë periudhës 2009 – 2021, numri i përgjithshëm i personave me shtetas kosovarë të cilëve u është dhënë azil për të dy kategoritë (azil afirmativ dhe azil mbrojtës) në Shtetet e Bashkuara, ishte gjithsej 576.

Shkalla më e lartë e personave të cilëve u është dhënë azil për të dy kategoritë u regjistrua në vitin 2015 (70) dhe 2019 (70), kurse shkalla më e ulët u regjistrua në vitin 2009 (12) dhe në vitin 2021, (Fig 14). Në vitin 2021 (20), pati një rënie të konsiderushme prej 74.4%, të këtyre personave në krahasim me vitin 2019 (70).

Fig.14. Numri i përgjithshëm i personave me shtetësi kosovare të cilëve u është dhënë azil (afirmativ dhe mbrojtës), 2009 - 2021.



Burimi: Departamenti i Sigurisë Kombëtare, Zyra e Statistikave të Imigrimit.

Numri i përgjithshëm i personave me shtetësi kosovare të cilëve iu është dhënë azil afirmativ ishte 286 persona, kurse azil mbrojtës u është dhënë 290 personave. Azil mbrojtës ishte për 1.39% më i lartë se sa i personave të cilëve iu është dhënë azili afirmativ. Shkalla më e lartë e personave të cilëve iu është dhënë azil mbrojtës u regjistrua në vitin 2019 (43), kurse për persona të cilëve iu është dhënë azili afirmativ në vitin 2015 (52).

Mosha, gjinia dhe statusi martesor

Të dhënat e publikuara nga Departamenti i Sigurisë Kombëtare/Zyra e Statistikave të Imigrimit nuk japin konkretisht për shtete në mënyrë individuale moshën, gjininë dhe statusin martesor por në formë të agregume. Në bazë të këtyre të dhënave për tri vitete e fundit, 61%-shit që iu është dhënë azili afirmativ dhe azil mbrojtës ishin të grupmoshës 18 - 48 vjeç, me një mesatare të moshës prej 29 vjeç. Sipas gjinisë 52% ishin të gjinisë mashkullore kurse 48% të gjinisë femrore. Sipas statutit martesor 58% nga të rriturit ishin të martuar.

REFERENCAT E ANEKSIT A

REGULATION (EU) 2016/399 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL, of 9 March 2016, on a Union Code on the rules governing the movement of persons across borders (Schengen Borders Code)

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32016R0399>

E Drejta Migratore Ndërkombëtare, Fjalorth i Terminologjisë Migratore, Nr.10, Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) 2007

REFERENCAT E ANEKSIT B

Immigration and Nationality Act (INA), USCIS › legislation › immigration-and-nationality-act
[https://www.uscis.gov/search?query=Immigration%20and%20Nationality%20Act%20\(INA\)](https://www.uscis.gov/search?query=Immigration%20and%20Nationality%20Act%20(INA))

Yearbook of Immigration Statistics 2021, 23.02.2023,
https://www.dhs.gov/sites/default/files/2023-03/2022_1114_plcy_yearbook_immigration_statistics_fy2021_v2_1.pdf

Nonimmigrant Admissions 2021 Data Tables, 26.09.2022
<https://www.dhs.gov/immigration-statistics/yearbook/2021>

Nonimmigrant Admissions 2021 Supplementary Data Tables, 26.09.2022
<https://www.dhs.gov/immigration-statistics/yearbook/2021>

Lawful Permanent Residents 2021 Data Tables, 26.09.2022,
<https://www.dhs.gov/immigration-statistics/yearbook/2021>

Lawful Permanent Residents 2021 Supplementary Data Tables, 26.09.2022
<https://www.dhs.gov/immigration-statistics/yearbook/2021>

U.S. Naturalizations 2021 Data Tables, 26.09.2022
<https://www.dhs.gov/immigration-statistics/yearbook/2021>

U.S. Naturalizations 2021 Supplementary Data Tables, 26.09.2022
<https://www.dhs.gov/immigration-statistics/yearbook/2021>

Immigration Enforcement Actions 2021 Data Tables 22.12.2022
<https://www.dhs.gov/immigration-statistics/yearbook/2021>

Immigration: Recent Apprehension Trends at the U.S. Southwest Border, November 19, 2019,
<https://sgp.fas.org/crs/homesec/R46012.pdf>

Refugees and Asylees 2021 Data Tables, 26.09.2022
<https://www.dhs.gov/immigration-statistics/yearbook/2021>